



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVES
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2009

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2009

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit Drejtues -----	11
Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	13
Bordi Drejtues, Menaxhmenti dhe Komiteti i Auditimit -----	15
Struktura organizative e BQK-së -----	17
1. Përmbledhje ekzekutive-----	19
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik-----	21
2.1. Ekonomia botërore-----	21
2.2. Evropa Juglindore-----	24
3. Ekonomia e Kosovës-----	27
3.1. Sektori real-----	27
3.1.1. Produkti i brendshëm bruto-----	27
3.1.2. Çmimet-----	28
3.1.3. Tregu i punës-----	30
3.1.4. Privatizimi-----	31
3.2. Sektori fiskal-----	32
3.2.1. Të hyrat buxhetore-----	33
3.2.2. Shpenzimet buxhetore-----	35
3.3. Sektori financiar-----	36
3.3.1. Karakteristikat e përgjithshme-----	36
3.3.2. Struktura dhe aktiviteti i sektorit bankar-----	38
3.3.3. Kompanitë e sigurimit-----	46
3.3.4. Fondet pensionale-----	47
3.3.5. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar-----	48
3.4. Sektori i jashtëm-----	50
3.4.1. Llogaria rrjedhëse-----	50
3.4.2. Llogaria kapitale dhe financiare-----	56
4. Mbikëqyrja e institucioneve financiare-----	61
4.1. Veprimtaria rregullative e sektorit financiar-----	61
4.2. Licencimi dhe struktura-----	63
4.3. Veprimtaria e mbikëqyrjes financiare-----	65
4.3.1. Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes bankare-----	65
4.3.2. Mbikëqyrja e sigurimeve dhe pensioneve-----	70
4.3.3. Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes së pensioneve-----	73
4.4. Veprimet ndëshkuese-----	75
4.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e mbikëqyrjes financiare-----	75
4.6. Komitetet e mbikëqyrjes financiare-----	76

5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun-----	78
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme-----	78
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive-----	83
5.3. Menaxhimi i mjeteve-----	87
5.4. Sistemi ndërbankar i pagesave-----	88
5.5. Regjistri i kredive -----	91
5.6. Aktivitetet në fushën e statistikave dhe analizave ekonomike -----	92
6. Zhvillimet e brendshme -----	94
6.1. Qeverisja dhe kontrolli i brendshëm -----	94
6.1.1 Kontrolli, implementimi i buxhetit dhe analizat operacionale-----	95
6.2. Burimet Njerëzore-----	96
6.3. Aktiviteti Ligjor i BQK-së-----	98
7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar -----	99
7.1. Marrëveshjet ndërkombëtare-----	100
8. Pasqyrat financiare të BQK-së-----	101
9. Shtojca statistikore -----	141
Referencat -----	155

LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e jashtme neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë kryesore ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e tregtisë së lirë e vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EJL	Evropa Juglindore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)
IHD	Investimet e huaja direkte
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat tjera depozituese
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i auto-përgjegjësish
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PCB	Procredit Bank
POS	Pikë e shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë-përqindje
PPI	Indeksi i çmimeve të prodhimit (angl. Producer Price Index)
PPT	Përgjegjësitë ndaj palës së tretë

PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
SEKN	Sistemi elektronik i kliringut ndërbankar
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

LISTA E FIGURAVE

1. Rritja reale e PBB-së	28
2. Indeksi i çmimeve të konsumit, prodhimit dhe çmimet globale të ushqimit	29
3. Kontributi i komponentëve kryesor të CPI në inflacionin vjetor	29
4. Tregu i punës	30
5. Ndryshimet në pagat reale dhe nominale të sektorit privat dhe publik	31
6. Bilanci buxhetor	32
7. Buxheti i planifikuar dhe i realizuar	33
8. Struktura e të hyrave buxhetore	34
9. Struktura e shpenzimeve buxhetore	35
10. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve	37
11. Sektori financiar ndaj sektorëve të tjerë	38
12. HHI për asete, kredi dhe depozita	39
13. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit	41
14. Struktura e depozitave	43
15. Normat e interesit	43
16. Treguesit e performancës	44
17. Kreditë joperformuese dhe provizionet	46
18. Çmimi i aksionit të TKPK-së dhe indeksi DJI dhe FTSE	48
19. Struktura e investimeve e fondeve pensionale	48
20. Bilanci i llogarisë rrjedhëse	50
21. Importet sipas kategorive kryesore ekonomike (BEC)	52
22. Struktura e tregtisë sipas partnerëve tregtarë	53
23. Indeksi REER bazuar në CPI	54
24. Transferet rrjedhëse	55
25. Papunësia në vendet e BE-së dhe dërgesat e emigrantëve në Kosovë	56
26. Llogaria financiare neto	57
27. Investimet e huaja direkte në Kosovë dhe rritja ekonomike në eurozonë	57
28. Struktura e IHD-ve sipas llojit të investimeve	58
29. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik	59
30. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës	59
31. Struktura e investimeve tjera	60
32. Vlera e aseteve në sektorin bankar	68
33. Trendi i kredive në sektorin bankar	68
34. Trendi i depozitave në sektorin bankar	69
35. Trendi i mjeteve të TKPK-së nga themelimi	74
36. Çmimi i aksionit të TKPK-së	74
37. Furnizimi me para të gatshme	78
38. Pranimi i parave të gatshme	78
39. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)	79
40. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)	79

41. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve) -----	80
42. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve) -----	80
43. Eksporti i parave të gatshme -----	81
44. Importi i parave të gatshme -----	81
45. Numri i kartëmonedhave të vjetra të tërhequra nga qarkullimi -----	81
46. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar -----	82
47. Furnizimi me kartëmonedha të reja -----	82
48. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara -----	83
49. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse -----	84
50. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse -----	84
51. Vëllimi i transaksioneve vendore të shkuara -----	85
52. Vlera e transaksioneve vendore të shkuara -----	85
53. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	85
54. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	85
55. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare të shkuara -----	86
56. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare të shkuara -----	86
57. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së -----	86
58. Numri vjetor i transaksioneve të SEKN-së -----	89
59. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së -----	89
60. Vlera mesatare ditore e transaksioneve të SEKN-së -----	89
61. Vlera mesatare ditore e transaksioneve të SEKN-së -----	89
62. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	90
63. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	90
64. Numri i shënimeve kreditore në RKK në fund të vitit -----	92
65. Numri i kërkimeve në RKK gjatë vitit -----	92

LISTA E TABELAVE

1. Norma e rritjes së PBB-së -----	21
2. Bilanci i llogarisë rrjedhëse dhe bilanci buxhetor në vendet e EJM-së -----	24
3. Numri i institucioneve financiare -----	37
4. Rrjeti i sektorit bankar -----	39
5. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	40
6. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	42
7. Bilanci i suksesit -----	45
8. Bilanci tregtar i Kosovës -----	51
9. Aktiviteti i licencimit të bankave, 2005-2009 -----	64
10. Aktiviteti i licencimit të sigurimit -----	64
11. Aktiviteti i licencimit të fondeve pensionale -----	64
12. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare financiare -----	64

13. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit, 2005-2009 -----	64
14. Aktiviteti i regjistrimit të agjensioneve të transferit të parave, 2005-----	65
15. Aktivitetet e regjistrimit të zyrave të këmbimit të valutave, 2005-2009-----	65
16. Ekzaminimet e institucioneve financiare gjatë vitit 2009 -----	67
17. Ekzaminimet e zhvilluara gjatë vitit 2009-----	71
18. Bruto primi i shkruar 2008-2009 -----	72
19. Raporti i dëmeve të paguara dhe të ndodhura 2009-2008 -----	72
20. Kthimi mesatar në asete (ROA) dhe kthimi mesatar në ekuitet (ROE) -----	72
21. Aktivitetet e industrisë së sigurimeve 2008-2009 -----	73
22. Vlera e mjeteve të THPK-së -----	73
23. Çmimet për aksion nga themelimi i TKPK-së -----	74
24. Gjendja e mjeteve pensionale në FSKP në vitin 2009 -----	74
25. Struktura kualifikuese e të punësuarve në BQK në fund të vitit 2009-----	83
26. Niveli i depozitave të klientëve të BQK-së -----	97

LISTA E KUTIVE

1. Anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar-----	33
2. Papunësia në BE dhe dërgesat e emigrantëve në Kosovë-----	56

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit Drejtues

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që t'jua prezantoj Raportin Vjetor të vitit 2009, një raport ky gjithpërfshirës, që përfshin zhvillimet më të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, duke përfshirë sektorin real, fiskal, financiar dhe të jashtëm. Në krahasim me raportet e viteve të mëparshme, ky raport ka një vlerë të shtuar, pasi që në të janë shtjelluar edhe disa aktivitete të tjera të rëndësishme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me qëllim të informimit të plotë të opinionit të gjerë mbi të gjitha funksionet e Bankës Qendrore.

Edhe në vitin 2009 vazhduan të ndihen efektet e krizës financiare globale, që konsiderohet si një nga krizat më të mëdha botërore. Ekonomia botërore shënoi rënie prej 0.8%, si dhe ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore, me përjashtim të Kosovës dhe Shqipërisë. Ekonomia e Kosovës shënoi rritje reale të Produktit të Brendshëm Bruto prej 3.8%, kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike dhe rënies së çmimeve. Ky vit u karakterizua me një deflacion prej 2.4% (një vit më parë u shënua inflacioni prej 9.3%).

Kriza financiare globale nuk e ka goditur direkt Kosovën, mirëpo ekonomia e saj i ka ndier efektet e krizës në mënyrë indirekte. Donatorët kryesorë të Kosovës kanë hezitur ta rrisin ndihmën për Kosovën, pasi që kanë probleme të brendshme. Rritja e papunësisë si në Evropë, ashtu edhe në Amerikën Veriore ka ndikuar në diasporën e Kosovës. Në vitin 2009 është shënuar rënia e dërgesave të kosovarëve prej 5.6%.

Gjatë viti 2009 u shënua edhe rënia e investimeve të huaja direkte prej mbi 20%, si dhe rënia e eksporteve prej 18% dhe importeve për 1.5%.

Problem serioz për Kosovën vazhdon të mbetet niveli i lartë i papunësisë, që vlerësohet rreth 45%, natyrisht këtu duhet marr parasysh edhe faktin se një përqindje e popullsisë në moshë të punës nuk hyn fare në tregun e punës. Këtë problem e vështirëson edhe më tepër struktura e re e moshës së popullsisë së Kosovës, pasi që një numër i punëkërkuesve të rinj për çdo vit i shtohet Kosovës.

Sektori financiar i Kosovës edhe në vitin 2009 vazhdoi me rritje, duke shënuar rritje të aseteve prej mbi 24%, ku pjesëmarrjen kryesore e kanë bankat. Vërehet një ngadalësim i kredihënies nga ana e bankave si rezultat i krizës dhe ky ngadalësim ndikoi që bankat komerciale ta orientojnë një pjesë të investimeve në kategori të tjera të aseteve, kryesisht në letra me vlerë. Në strukturën e kredive dominuan kreditë për ndërmarrjet (mbi 70%), kurse në kuadër të ndërmarrjeve pjesa më e madhe e kredive u shfrytëzua nga ndërmarrjet tregtare (mbi 56%). Gjatë vitit 2009 pati poashtu një rritje mjaft të lartë të depozitave (rreth 21%), por megjithatë më të ngadalshme se në vitin paraprak. Në strukturën e depozitave dominojnë depozitat e ekonomive familjare me mbi 60%.

Banka Qendrore e Kosovës ishte proaktive në marrjen e masave të shumta për të siguruar stabilitetin financiar. Si rezultat i krizës është rritur shpeshtësia e raportimit në vend (on-site) dhe jashtë (off-site), është rritur bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve prej nga vijnë institucionet financiare që operojnë në Kosovë, si dhe është promovuar një politikë më aktive e komunikimit me publikun.

Banka Qendrore e Kosovës është duke e reviduar kornizën rregullatore dhe mbikëqyrëse, duke e bërë evoluimin e qasjes së mbikëqyrjes së institucioneve financiare nga mbikëqyrja e bazuar në rregulla në mbikëqyrjen e bazuar në rrezik.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Bordit Drejtues

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Viti që lamë pas ka qenë një vit i sfidave të reja për BQK-në, ashtu siç ishte thuajse për të gjitha institucionet simotra dhe autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të ndryshme, si rezultat i përballjes me krizën financiare ndërkombëtare. Roli i BQK-së gjatë kësaj periudhe ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe vendimtar në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe sigurimin e një sistemi efikas të pagesave. Përveç që ishte vit i sfidave për BQK-në, njëherit ka qenë edhe vit në të cilin BQK-ja ka mbushur 10 vite të funksionimit të saj të suksesshëm në Republikën e Kosovës.

Zhvillimet në ekonominë botërore në përgjithësi dhe ato në ekonominë e Ballkanit Perëndimor në veçanti, gjatë vitit 2009 bënë që ekonomia e vendit tonë të mos jetë immune ndaj efekteve të këtyre zhvillimeve e cila u reflektua në rënien e investimeve të jashtme, dërgesave të emigrantëve dhe të eksporteve. Përkundër efektit negativ të këtyre zhvillimeve si pasojë e krizës globale financiare, ekonomia e vendit edhe në vitin 2009 ka shënuar rritje pozitive, gjë që e dallon nga ekonominë e rajonit dhe me gjerë. Aktiviteti i Bankës Qendrore karshi këtyre proceseve ka qenë mjaft aktiv dhe i theksuar si në kuptim të marrjes së veprimeve konkrete (themelimi i Komitetit të Krizës në kuadër të BQK-së dhe mbikëqyrja shumë efektive i të gjitha institucioneve financiare në vend) ashtu edhe në iniciativa për veprime në nivel vendi përmes themelimit të Komitetit Kombëtarë për parandalimin e efekteve të krizës financiare i përbërë nga Guvernatori, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa.

Në vazhden e realizimit me sukses të përgjegjësisë së saj, me aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra BQK-ja ka arritur që me sukses të parandalojë apo të zvogëlojë efektet e mundshme të krizës financiare. Kjo është arritur në sajë të rritjes dhe ruajtjes së besimit të qytetarëve të vendit në institucionet financiare që operojnë në Republikën e Kosovës, vazhdimësisë së mbikëqyrjes efikase të institucioneve financiare, transparencës së plotë ndaj publikut dhe rritjes në vazhdimësi të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe mekanizmat ndërkombëtarë për t'i kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

BQK-ja ka kontribuar fuqishëm edhe në: procesin e anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, në hartimin e strategjisë kombëtare të pagesave, zhvillimin e vazhdueshëm dhe përsosjen e sistemit të pagesave, avancimin cilësorë të statistikave monetare dhe financiare (të cilat u publikuan nga FMN-ja menjëherë pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës), në përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe bashkëpunimin intensiv ndërkombëtar me institucionet simotra dhe rregullatorët e ndryshëm financiar të rajonit, BE-së dhe më gjerë.

Plani i Biznesit 2007-2009 për BQK-në ishte një dokument i karakterit strategjik dhe ka shërbyer si udhërrëfyes i aktivitetit të BQK-së deri në fund të vitit 2009. Përbushja e këtij plani me sukses, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka paraqitur nevojën për përcaktimin e strategjisë zhvillimore të BQK-së për të ardhmen, e që rezultoi me hartimin e Planit Strategjik 2010-2015, i cili parasheh objektivat themelore të BQK-së në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera juridike që lidhen me funksionin e saj.

Plani Strategjik i BQK-së është një dokument që përcakton orientimin strategjik të BQK-së për pesë vitet e ardhshme dhe ka këto qëllime strategjike: 1. Promovimin dhe sforcimin e stabilitetit financiar në Republikën e Kosovës; 2. Mbështetjen e politikave të përgjithshme ekonomike për të arritur rritje të qëndrueshme ekonomike në Republikën e Kosovës; 3. Sigurimin e zhvillimit të sistemeve ndërbankare bashkëkohore dhe ofrimin e

shërbimeve bankare efektive për klientët; 4. Promovimin e zhvillimit të shëndoshë të sektorit financiar në Republikën e Kosovës; 5. Kontribuimi në proceset për integrim në Bashkimin Evropian dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

Realizimi i këtyre qëllimeve strategjike behët përmes planit të veprimit ku janë përcaktuar qartë të gjitha aktivitetet e BQK-së për përmbushjen e Planit Strategjik 2010-2015.

Viti 2009 ishte vit i suksesshëm edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. BQK-ja ka marrë pjesë në mënyrë aktive në përmbushjen e standardeve dhe sfidave të dalura nga Raporti i Progresit 2008 të Komisionit Evropian të parapara si sfida për vitin 2009 dhe kjo bëri që raporti i Progresit të Komisionit Evropian i vitit 2009 ta vlerësojë mjaftë lartë punën e bërë nga institucioni ynë.

BQK ka shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të programeve për asistencë teknike nga FMN dhe Banka Botërore e në veçanti në sferën legjislativë (dëftimi i ligjit mbi BQK-në, ligjit mbi sigurimet, ligjit mbi pensionet, ligjit mbi bankat, etj.).

BQK-ja në vitin 2009 ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me institucionet simotra të vendeve të regjionit dhe të BE-së (me Shqipërinë, Turqinë, Slloveninë, Luksemburgun, etj.).

Përveç objektivave të përcaktuara me ligj dhe akte tjera juridike BQK-ja, ka përcaktuar për vitin 2010 objektiva të rëndësishme dhe në harmoni me planin strategjik 2010-2015, që janë: standardizimi dhe harmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së, përpjekjet për anëtarësim në SWIFT (*Shoqëria për Telekomunikacion Botëror Financiar Ndërbankar*) dhe në Byronë e Kartonit të Gjellbër, bashkëpunimi profesional me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Lëvizja drejt implementimit të Bazel II (për bankat) dhe Solvencës II (për sigurimet), ngritja e skemës së sigurimit të depozitave, implementimi i projektit për strategjinë kombëtare të pagesave, lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe të vendeve të regjionit dhe të BE-së, ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve dhe aftësimin të stafit të BQK-së, vazhdimësia e informimit të publikut të gjerë lidhur zhvillimet në sektorin financiar të Republikës së Kosovës.

Të gjitha këto objektiva janë arritur duke iu falënderuar punës efektive dhe mbështetjes së vazhdueshme të Bordit të BQK-së, punës efektive të menaxhmentit të lartë dhe stafit shumë profesional dhe të motivuar të BQK-së.

Hashim Rexhepi

Guvernator

Bordi Drejtues, Menaxhmenti dhe Komiteti i Auditimit

Bordi Drejtues i BQK-së

Me qëllim të përmbushjes së suksesshme të politikave dhe kompetencave të përcaktuara sipas legjislacioneve në fuqi, Bordi drejtues, gjatë vitit 2009, ka mbajtur 15 mbledhje.

Për përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësi që ka Bordi për ndërtimin e një sistemi bankar dhe financiar efikas dhe të shëndosh edhe gjatë këtij viti aktiviteti i Bordit drejtues është përqendruar në vazhdimësi në: miratimin e politikave për përmbushjen e kompetencave të BQK-së duke e mbikëqyrë zbatimin e tyre nga menaxhmenti dhe stafi; miratimin e rregullave, urdhëresave dhe udhëzimeve të nxjerra nga BQK-ja; miratimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve që BQK-ja ua paraqet autoriteteve kompetente në Kosovë; miratimin e organizimit të BQK-së; miratimin e buxhetit vjetor të BQK-së; miratimin e raporteve periodike bashkë me gjendjen financiare të BQK-së; miratimin dhe refuzimin e kërkesave për licencë apo regjistrim të institucioneve financiare dhe të anulimit të licencave ose regjistrimin e institucioneve financiare; miratimin të gjitha masave detyruese të përgatitura nga stafi i BQK-së para zbatimit të tyre, me përjashtim të atyre që veçanërisht janë në kompetencë të Guvernatorit; dhe çështje të tjera që janë në kompetencën e Bordit drejtues.

Me 31 dhjetor 2009 Bordi drejtues i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

- Z. Gazmend Luboteni, Kryetar i Bordit drejtues;
- Z. Hashim Rexhepi, Guvernator dhe anëtar i Bordit drejtues;
- Z. Lulzim Ismajli, Drejtor i Thesarit (anëtar i Bordit drejtues);
- Z. Sejdi Rexhepi, anëtar i Bordit drejtues;
- Z. Mejdi Bektashi, anëtar i Bordit drejtues.

Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore janë Bordi Drejtues dhe Guvernatori. Bordi drejtues formulon politikat për operacionet e BQK-së dhe mbikëqyr implementimin e objektivave të zhvillimit dhe arritjes së sistemit financiar stabil në bazë të sistemit të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave duke u mbështetur në parimin të një ekonomie të tregut të hapur me konkurrencë të lirë. Guvernatori dhe menaxhmenti i raporton Bordit Drejtues për implementimin e politikave mbi realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin e BQK-së.

Në bazë të Ligjit mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi drejtues i BQK-së përbëhet nga pesë anëtarë. Anëtarët e Bordit emërohen në bazë të nenit 18 të Ligjit për BQK-në. Drejtori i Thesarit është një nga katër anëtarët joekzekutiv të Bordit, ndërsa tre anëtarë tjerë joekzekutiv dhe Guvernatori emërohen ashtu siç parashihet nga neni 18.2 të këtij ligji.

Menaxhmenti i BQK-së

Menaxhmenti i BQK-së përbëhet nga Guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorë: Zëvendësguvernatori për funksione bankare qendrore dhe Zëvendësguvernatori për mbikëqyrje të institucioneve financiare, të cilët me propozim të Guvernatorit emërohen nga ana e Bordit Drejtues.


Inspektori i përgjithshëm

Shtyllë tjetër me rëndësi në strukturën organizative të BQK-së paraqet sigurimi i qeverisjes së mirë dhe transparente, e cila realizohet përmes funksionit të Inspektorit të përgjithshëm të BQK-së, në bazë të nenit 30 të Ligjit mbi BQK-në. Me propozim të Guvernatorit, Inspektori i përgjithshëm emërohet nga ana e Bordit Drejtues.

Komiteti i Auditimit

Në kuadër të sigurimit të qeverisjes transparente, në strukturën organizative të BQK-së, vepron edhe Komiteti i Auditimit i përbërë nga dy drejtorët joekzekutiv - anëtarë të Bordit drejtues të BQK-së. Ky komitet ka për objektiva që të asistojë Bordin drejtues të BQK-së në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm, etikën në punë dhe qeverisjen transparente si dhe raportin financiar të BQK-së.

Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2009



1. Përmbledhje ekzekutive

Efektet e krizës vazhduan të jenë prezente në ekonominë botërore edhe gjatë vitit 2009, duke shkaktuar një rënie ekonomike prej 0.8 përqind. Efektet kryesore të krizës u reflektuan në rënien e prodhimit industrial, investimeve, vëllimit të tregtisë botërore dhe rritjen e papunësisë. Për t'i sanuar pasojat e krizës, shumë vende reagueshan me masa të politikës monetare dhe fiskale, masa këto të cilat rezultuan mjaft të suksesshme. Kriza financiare, e cila kishte origjinën në vendet e zhvilluara, u transmetua edhe në ekonominë e Evropës Juglindore (EJL), duke u shoqëruar me rënie ekonomike në shumicën e këtyre vendeve (me përjashtim të Kosovës dhe Shqipërisë). Rritja e papunësisë në vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe zvogëlimi i kërkesës agregate ndikoi drejtpërsëdrejti në zvogëlimin e eksporteve drejtë BE-së dhe dërgesave të emigrantëve drejtë vendeve të EJL-së. Në disa vende të EJL-së kishte tërheqje të depozitave, mirëpo masat e ndërmarra nga shteti arritën të stabilizojnë situatën dhe të kthejnë besimin në sektorin bankar. Sidoqoftë, rënia e aktivitetit ekonomik bëri që bankat në këto vende të aplikojnë politika më të shtrënguara kreditore.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2009 shënoi rritje reale të PBB-së (3.8 përqind sipas vlerësimeve të FMN-së dhe 4.4 përqind sipas MEF-it), kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike dhe rënies së çmimeve. Viti 2009 u shoqërua me deflacion prej 2.4 përqind i ndikuar kryesisht nga rënia e çmimeve të importeve. Sfiduese për ekonominë e Kosovës vazhdon të mbetet gjendja në tregun e punës, që karakterizohet me nivel të lartë të papunësisë. Bilanci buxhetor në vitin 2009 u përmyll me deficit prej 85.6 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 8.1 milionë euro në vitin 2008, i ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve kapitale dhe transfereve. Në fund të vitit 2009 u aprovua projekt buxheti për vitin 2010, sipas të cilit Buxheti i Kosovës në vitin 2010 është rreth 1.4 miliardë euro, apo 19.1 përqind më i lartë se në vitin 2009.

Duke shënuar rritje vjetore prej rreth 24 përqind, asetet e sektorit financiar në vitin 2009 arritën vlerën prej 2.8 miliardë euro. I dominuar nga bankat me pronësi të huaj, tregu bankar vazhdon të ketë shkallë të lartë të koncentrimin, përkundër trendit rënës gjatë periudhave të fundit. Gjatë vitit 2009 norma e rritjes së kredive ishte 8.9 përqind ndërsa norma e rritjes së depozitave ishte 20.8 përqind. Si rezultat i performancës më të dobët të sektorit real të ekonomisë, sektori bankar gjatë vitit 2009 aplikoi një politikë më të shtrënguar të kreditimit. Këto politika u reflektuan edhe në performancën e sektorit bankar, duke bërë që fitimi i realizuar nga bankat komerciale gjatë vitit 2009 të jetë për 31 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2008. Sidoqoftë, sektori bankar edhe gjatë vitit 2009 tregoi nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë dhe vazhdoi të përkrahë ekonominë përmes kreditimit, megjithëse me një ritëm të ngadalësuar.

Në bilancin e pagesave të Kosovës është regjistruar një rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 7.2 përqind. Duke përfshirë asistencën e jashtme, deficitin e llogarisë rrjedhëse është 16 përqind e PBB-së. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse rezultoi nga rënia e dërgesave të emigrantëve dhe të ardhurave, ndërsa deficitin tregtar, si komponentë kryesore e llogarisë rrjedhëse, shënoi rritje modeste. Llogaria kapitale dhe financiare, përkundër rënies së IHD-ve, shënoi rritje për 15.3 përqind, rritje kjo e cila i atribuohet zvogëlimin të aseteve rezervë.

Ngjarja që karakterizoi vitin 2009 ishte anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, që paraqet një mundësi të veçantë për perspektivat dhe sfidat e reja të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Në anën tjetër, evoluimi i krizës financiare në nivel ndërkombëtar nënkuptoi angazhime shtesë për BQK-në në funksion të ndërmarrjes së masave të cilat kishin për qëllim parandalimin e efekteve të krizës në

sektorin financiar. Në këtë kontekst, BQK-ja ndoqi një qasje më konzervative të vlerësimit të rrezikut në sektorin financiar, posaçërisht në atë bankar, dhe ngriti frekuencën e raportimit dhe ekzaminimeve të institucioneve financiare. Po ashtu, u implementua një politikë aktive e komunikimit me publikun dhe një bashkëpunim aktiv me institucionet rregullative jashtë vendit. Për më tepër, u formua edhe Komiteti Kombëtar për Përgatitje ndaj Krizës, komitet ndërinstytucional i përbërë nga BQK-ja, MEF-i dhe Parlamenti i Kosovës, ndërkohë që BQK-ja dhe MEF-i nënshkruan një marrëveshje mirëkuptimi, marrëveshje kjo që ka për qëllim vëzhgimin e rregullt të zhvillimeve në sektorin financiar dhe hartimin e masave për reagim ndaj zhvillimeve të mundshme negative në sektorin financiar.

Në bazë të Ligjit mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja ka autoritet rregullativ dhe mbikëqyrës për të gjitha institucionet financiare në Kosovë. Qasja e mbikëqyrjes së institucioneve financiare është zhvilluar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke filluar me qasjen e 'bazuar në rregulla' dhe duke lëvizur në drejtim të qasjes së 'bazuar në rrezik', e cila është formuluar sipas Principeve Themelore të Basel-it dhe Shtyllës së Dytë të Basel-it II për bankat, dhe një regjim të aftësisë paguese bazuar në rrezikun, i cili është duke u adoptuar ndërkombëtarisht për kompanitë e sigurimeve. Gjatë vitit 2009 pati disa zhvillime në plotësimin e politikave dhe procedurave të mbikëqyrjes financiare që kanë të bëjë me aprovimin e letrave këshilluese të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut të likuiditetit. Po ashtu, gjatë vitit 2009, është aprovuar politika mbi shqyrtimin e historikut të personave dhe kompanive të caktuara që janë të interesuara të hyjnë në sistemin bankar dhe financiar. Me qëllim që të amortizohen efektet potenciale të krizës nga sektori real i ekonomisë, është shpeshtuar mbikëqyrja në vend dhe nga jashtë.

BQK-ja u siguron institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë shërbimet që ofrohen nga një bankë qendrore. Zhvillim me rëndësi në lëmin e sistemit të pagesave ishte përgatitja e Strategjisë së zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave dhe fillimi i zbatimit të saj. Përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) gjatë vitit 2009 u shënuar rritje në vëllim dhe në vlerë të transaksioneve të SEKN-së dhe u bë avancimi i tij i mëtejshëm, ku duhet theksuar sidomos lansimin e skemës së debitimit direkt. Po ashtu, gjatë vitit 2009, BQK-ja vazhdoi me furnizimin e ekonomisë me para të gatshme, që përbën një ndër funksionet në lëmin e sistemit të pagesave. Në kuadër të shërbimeve që BQK-ja u siguron institucioneve financiare, hyn edhe regjistri i kredive, që paraqet një aset në kontekst të informatave të mbledhura lidhur me kredimarrësit në Kosovë.

Politika e Investimeve e BQK-së bazohet në sigurinë e mjeteve, likuiditetin dhe normën e kthimit nga investimet. Menaxhimi i mjeteve kryhet përmes vlerësimit mujor të bankave me të cilat bashkëpunon BQK-ja dhe të cilat i përmbushin kriteret e caktuara. Kjo politikë i mundëson BQK-së t'i plotësojë me kohë të gjitha kërkesat ligjore të secilit depozitar të saj. Edhe përkundër krizës financiare, të gjitha bankat me të cilat bashkëpunon BQK-ja i përmbushin kriteret e politikës së investimeve me kategoritë kryesore të vlerësimit (*Aaa* dhe *Aa*).

Auditimi i brendshëm gjatë vitit 2009 ka vepruar në bazë të planit vjetor të propozuar nga Inspektori i përgjithshëm me aprovimin paraprak nga Komiteti i Auditimit dhe Bordi drejtues. Auditimi i brendshëm në BQK, sikurse edhe vitet e mëparshme, edhe për vitin 2009 ka përgatitur planin vjetor të auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe të reputacionit të institucionit, auditimet janë kryer në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik¹

2.1. Ekonomia botërore

Ekonomia botërore vazhdoi të ballafaqohet me efektet e krizës edhe në vitin 2009, duke shënuar rënie prej 0.8 përqind (Tabela 1). Norma negative e rritjes për ekonominë botërore kryesisht pasqyron ecuritë në ekonomitë e zhvilluara, të cilat shënuan një rënie ekonomike prej 3.2 përqind, përderisa vendet në zhvillim shënuan rritje ekonomike prej 2.1 përqind. Pjesa e parë e vitit u karakterizua me zvogëlim të vëllimit të tregtisë botërore, rënie të rrjedhës së kapitalit dhe nivel më të ulët të investimeve. Shumica e vendeve të zhvilluara u ballafaquan me recesion që u manifestua me rënie të prodhimit industrial, rënie të çmimeve dhe rritje të papunësisë. Në anën tjetër, efektet e krizës ishin më të kufizuara në disa nga vendet në zhvillim, siç janë Kina dhe India. Në nivel global, kjo paraqet krizën ekonomike me përmasat më të mëdha në 50 vitet e fundit.

Tabela1. Norma e rritjes së PBB-së, në përqindje

Përshkrimi	2008	2009	2010
PBB-ja botërore	3.0	-0.8	3.9
Vendet e zhvilluara	0.5	-3.2	2.1
SHBA	0.4	-2.5	2.7
Eurozona	0.6	-3.9	1.0
Japonia	-1.2	-5.3	1.7
Mbretëria e Bashkuar	0.5	-4.8	1.3
Vendet në zhvillim	6.1	2.1	6.0
Rusia	5.6	-9.0	3.6
Kina	9.6	8.7	10.0
India	7.3	5.6	7.7

Burimi: IMF (2010)

Gjysma e dytë e vitit 2009 u karakterizua me kushte më të favorshme ekonomike, si rezultat i masave të ndërmarra nga vendet e prekura nga kriza. Rrjedhimisht, disa vende raportuan dalje nga recesioni. Masat e ndërmarra ishin një kombinim i masave ekspansioniste monetare dhe fiskale dhe ishin efektive në zbutjen e krizës financiare dhe ekonomike duke stimuluar aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Në shumicën e vendeve u zvogëluan normat bazë të interesit dhe u rrit oferta e mjeteve likuide nga bankat qendrore, ndërsa, politika fiskale kryesisht u karakterizua me rritje të shpenzimeve kapitale dhe transfereve.

Parashikimet e FMN-së për vitin 2010 sugjerojnë një normë pozitive të rritjes së ekonomisë botërore prej 3.9 përqind. Përkundër parashikimeve për një rritje ekonomike prej 2.1 përqind në vendet e zhvilluara, pasiguria në tregjet globale pritet të vazhdojë. Me gjithë fillimin e rimëkëmbjes në disa ekonomi, ekziston një konsensus se rikthimi i punësimit dhe kapaciteteve prodhuese në nivelet e parakrizës do të zgjatë. Parashikimet janë më optimiste për performancën e ekonomive në zhvillim, të cilat në vitin 2010 pritet të shënojnë një normë mesatare të rritjes prej 6 përqind, me ç'rast pritet që ekonomia kineze të jetë lider me një rritje të PBB-së prej 10 përqind.

¹ Zhvillimet në ekonominë botërore dhe Evropën juglindore janë të bazuara në publikimet: Bank of England (2009), Business Monitor International (2009), ECB (2009), European Commission (2009), Eurostat (2009), IMF (2009), IMF (2010) dhe World Bank (2009).

Si përgjigje ndaj krizës financiare globale, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara ndërmorën hapa të koordinuar për të zbritur normat bazë të interesit, të cilat u zbritën në nivele rekorde. Në këtë kontekst, Rezerva Federale e SHBA-ve zbriti normat për financim në intervalin 0.00–0.25 përqind, ndërsa Banka e Anglisë dhe Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank: ECB) zbritën normën bazë të interesit në 0.5 përqind respektivisht 1.0 përqind. Zvogëlimi i normës bazë të interesit u reflektua në normat interesit në tregun ndërbanak, ku EURIBOR dhe LIBOR (12 muaj) shënuan rënie të vazhdueshme, duke zbritur në 1.25 përkatësisht 0.99 përqind. Zbritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore në nivele aq të ulëta kufizon mundësitë e autoriteteve për të ndërmarrë masa të mëtutjeshme përmes politikës monetare në rast të paraqitjes së komplikimeve të reja në sektorin financiar ose në ekonominë në përgjithësi. Sidoqoftë, prezenca e normave të larta të papunësisë dhe normat e ulëta të rritjes ekonomike do të shtyjnë bankat qendrore të mbajnë normat e interesit në nivele të ulëta, përderisa nuk paraqiten presionet inflacioniste.

Në pjesën e parë të vitit 2009, rënia e theksuar e aktivitetit ekonomik ndikoi në zvogëlimin e presioneve inflacioniste në shumicën e vendeve të zhvilluara (madje në disa vende u regjistrua deflacion), ndërsa në pjesën e dytë të vitit 2009, përmirësimi i klimës ekonomike stimuloi kërkesën agregate, gjë që ndikoi në rritjen e çmimeve të naftës dhe nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Përveç rritjes së kërkesës, rritja e çmimeve të naftës ishte rezultat edhe i zvogëlimit të prodhimit të naftës nga vendet e OPEC-ut. Sipas FMN-së, norma vjetore e inflacionit në vendet e zhvilluara gjatë vitit 2009 ishte 0.1 përqind, kurse në vendet në zhvillim ishte 5.2 përqind. Bazuar në projeksionet e FMN-së, në vitin 2010 pritet që norma e inflacionit për vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim të arrijë në 1.3 përkatësisht 6.2 përqind.

Dalja nga recesioni në shumë vende u shoqërua me probleme buxhetore si rezultat i rritjes së deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Këto probleme u shfaqën si rezultat i rritjes së madhe të shpenzimeve qeveritare. Sipas projeksioneve të FMN-së, deri në vitin 2014, borxhi publik në vendet e zhvilluara do të tejkalojë normën prej 110 përqind të PBB-së, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e para krizës kur kjo normë ishte 80 përqind. Konsolidimi fiskal paraqet një nga sfidat më të vështira për vendet e zhvilluara, posaçërisht për vendet e eurozonës, ku në tremujorin e tretë të vitit 2009 borxhi publik ishte 77.6 përqind e PBB-së (17.6pp mbi kriterin e Maastricht-it). Për më tepër, në fund të vitit 2009, deficitit buxhetor në vendet e eurozonës arriti në 6.3 përqind të PBB-së krahasuar me 2.3 përqind sa ishte në vitin 2008, duke e kaluar kështu pragun prej 3 përqind të PBB-së të përcaktuar me kriteret e Maastricht-it. Vendet me probleme më të theksuara buxhetore, si për shembull Greqia (12.3 përqind), po përballen me vështirësi serioze për t'i paguar borxhet. Në vendet si Greqia, Portugalia, Irlanda dhe Spanja, normat e larta të deficitit buxhetor kanë ndikuar negativisht në rangimin kreditor të këtyre vendeve, duke shkaktuar rritjen e primeve për fletëobligacionet e këtyre shteteve. Në vitin 2009, në disa raste primet në fletëobligacionet e këtyre shteteve ishin deri në 3 përqind më të larta sesa ato të Gjermanisë, të cilat konsiderohen të kenë nivel më të lartë të sigurisë. Për të reduktuar deficitin buxhetor, disa nga vendet e eurozonës duhet të ndërmarrin masa fiskale drastike, përmes zvogëlimit të shpenzimeve publike, rritjes së TVSH-së, rritjes së tatimeve indirekte dhe reforma në sistemet e pensioneve, masa këto jo të popullarizuara. Tendenca për ndërmarrjen e këtyre masave i ka vënë disa qeveri, siç është rasti i Greqisë, para presioneve të theksuara sindikaliste.

Si pasojë e krizës, zvogëlimi i aktivitetit ekonomik u reflektua në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e të ardhurave dhe të kërkesës agregate. Normat e papunësisë shënuan rritje substanciale. Në SHBA, niveli i papunësisë arriti në 10 përqind, që paraqet një rritje prej

5pp krahasuar me vitin 2008. Kjo njëherësh paraqet normën më të lartë të papunësisë të regjistruar në 26 vitet e fundit. Nivel të përafërt të papunësisë regjistroi edhe Mbretëria e Bashkuar, ku norma e papunësisë arriti në 7.8 përqind, që paraqet një rritje prej 2.6pp krahasuar me vitin 2008. Rritje e nivelit të papunësisë u shënuar edhe në ekonominë e eurozonës, ku norma e papunësisë në fund të vitit 2009 arriti në 9.7 përqind, që paraqet një rritje prej 2pp krahasuar me vitin 2008. Sipas të dhënave nga EUROSTAT, sektorët më të prekur në kuptim të shkurtimeve të vendeve të punës ishin sektori i industrisë dhe ndërtimitarisë. Norma e papunësisë në vendet e eurozonës ndoqi një trend më të ngadalshëm të rritjes krahasuar me vendet si SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar. Kjo për shkak se tregjet e punës në Eurozonë karakterizohen me një shkallë më të ulët të fleksibilitetit, për shkak të kostos së lartë që shoqëron largimin e punëtoreve nga puna dhe për shkak të organizatave të fuqishme sindikaliste. Në këtë kontekst, shumë firma, sidomos në Gjermani, kanë zbatuar politika të shkurtimeve të orarit të punës, politika këto që janë treguar mjaft efektive në parandalimin e rritjes së papunësisë.

Gjatë vitit 2009, kursi i këmbimit të euros me valutat kryesore ishte mjaft variabil. Në raport me dollarin amerikan, euro u vlerësua për 5.4 përqind, ndërsa në raport me funtën britanike shënoi një vlerësim rekord prej 11.4 përqind. Zhvlerësimi i dollarit dhe funtës kundrejt euros mund t'i atribuohet normave më të larta të interesit në eurozonë si dhe rritjes së deficitit tregtar në SHBA dhe Mbretëri të Bashkuar. Në anën tjetër, euro u zhvlerësua kundrejt frankës zvicerane dhe jenit japonez për 4.9 përkatësisht 14.9 përqind. Në fillim të vitit 2010, euro është në presion të vazhdueshëm të zhvlerësimit në raport me valutat kryesore globale. Këto presione janë duke u shfaqur si rezultat i problemeve të theksuara fiskale në disa vende anëtarë të eurozonës.

Në vitin 2009, bursat ndërkombëtare arritën të rikuperojnë pjesën më të madhe të humbjeve të shkaktuara nga kriza financiare. Lulatjet e bursave janë zvogëluar, duke kontribuar kështu në kthimin e besimit të investitorëve në tregje. Po ashtu, pritjet optimiste për të ardhurat e korporatave ndikuan mjaft në këtë këndellje. Performanca e bursave më të mëdha ishte mjaft pozitive, kështu për shembull DOW Jones (SHBA) dhe FTSE (Mbretëria e Bashkuar) shënuan kthim vjetor prej 18.8 përkatësisht 24.0 përqind. Ndër bursat e Eurozonës mund të veçohet performanca e DAX (Gjermani) dhe CAX (Francë), të cilat shënuan kthim vjetor prej 23.8 përkatësisht 22.3 përqind.

Edhe pse ekonomia botërore shënoi trende pozitive të rritjes, rreziqet akoma nuk janë tejkaluar. Derisa ekspansioni monetar dhe fiskal ka arritur kulmin, ende është e paqartë se sa këta stimuj do të kenë ndikim afatgjatë në rritjen e konsumit privat dhe investimeve. Përkundër injektimit të fondeve në ekonomi nga bankat qendrore si dhe aplikimit të normave të ulëta të interesit, bankat komerciale po hezitojnë të rrisin kreditimin e ekonomisë. Problemi më i madh do të paraqitet nëse deficitet e larta buxhetore do të shoqërohen me presione inflacioniste dhe, si rezultat, bankat qendrore do të duhej të aplikojnë politika monetare restriktive, si për shembull të rrisin normat e interesit. Rritja e normave të interesit do të dekurajonte investimet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikonte në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik. Një çështje tjetër që po adresohet fuqishëm është rregullimi i tregjeve financiare, ku pritet një rritje e kompetencave mbikëqyrëse për autoritet rregullative, kontroll më i ashpër dhe limitim i përdorimit të produkteve financiare si derivativët dhe zërat jashtëbilancor.

2.2. Evropa Juglindore

Efektet e krizës së gjeneruar në vendet e zhvilluara u reflektuan edhe në ekonomitë e Evropës Juglindore (EJL).² Pas një periudhe disavjeçare të rritjes, performanca e ekonomive të vendeve të EJL-së u ndikua negativisht nga kriza që filloi të shfaqet në tremujorin e katërt të vitit 2008. Në vitin 2009, shumica e vendeve të EJL-së shënuan rënie të PBB-së, gjë që rezultoi në një rënie mesatare prej 2.6 përqind për tërë rajonin. Përjashtim bëjnë Kosova dhe Shqipëria të cilat shënuan norma pozitive të rritjes së PBB-së (3.8 përkatësisht 2.5 përqind), por që janë më të ulëta në krahasim me vitet paraprake (Tabela 2).

Tabela 2. Bilanci i llogarisë rrjedhëse dhe bilanci buxhetor në vendet e EJL-së

Përshkrimi	Norma reale e rritjes së PBB-së		Deficiti buxhetor si % e PBB-së		Deficiti në llogarinë rrjedhëse si % e PBB-së	
	2008	2009	2008	2009	2008	2009
Bosnja dhe Hercegovina	5.5	-3.0	1.4	-4.6	-14.9	-6.9
Bullgaria	5.9	-5.3	3.0	-1.5	-26.1	-11.4
Kroacia	2.4	-5.1	-1.9	-2.4	-9.7	-5.1
Kosova	5.4	3.8	-0.2	-0.9	-16.0	-17.0
Mali i Zi	6.9	-5.3	1.2	-2.3	-29.0	-18
Maqedonia	5.0	-1.3	-1.0	-7.4	-13.1	-6.9
Rumania	7.1	-7.0	-4.9	-6.5	-11.8	-3.6
Serbia	5.4	-3.1	-2.1	-4.8	-18.4	-8.1
Shqipëria	8.0	2.5	-6.0	-7.0	-15.5	-15.8

Burimi: BMI (2010), IMF (2010) dhe European Commission (2010)

Periudha para krizës karakterizohet me norma të larta të rritjes ekonomike, nivel rekord në investimet e huaja direkte (IHD) dhe normë dyshifrore të rritjes së kredisë bankare. Prospektet për anëtarësim në BE inkurajuan vendet e EJL-së të ndërmarrin reforma të thella strukturore dhe makroekonomike të cilat kontribuuan në arritjen e një stabiliteti ekonomik. Gjatë kësaj periudhe, sfidë më serioze për ekonomitë e rajonit ishte deficiti në llogarinë rrjedhëse dhe papunësia të cilat paraqesin probleme afatgjata për tërë rajonin. Kriza financiare dhe ekonomike vuri vendet e EJL-së përballë sfidave të reja, që rrezikuan rritjen dhe qëndrueshmërinë afatgjate të ekonomisë. Efektet e krizës kryesisht u manifestuan me zvogëlim të eksporteve, nivel më të ulët të kreditimit nga sektori bankar, rënie të IHD-ve dhe dërgesave të emigrantëve.

Zvogëlimi i kërkesës së përgjithshme në vendet e prekura nga kriza, posaçërisht në BE si partneri kryesor tregtar i vendeve të rajonit, shkaktoi rënie të konsiderueshme të kërkesës për eksportet e këtyre vendeve. Në disa vende, eksportet shënuan rënie vjetore deri në 30 përqind. Ngadalësimi i aktivitetit të përgjithshëm ekonomik detyroi bankat të aplikojnë politika më të shtrënguara kreditore. Shtrëngimi i kredidhënies u kushtëzua edhe nga vështirësimi i qasjes në fonde në tregjet e jashtme financiare. E tërë kjo u reflektua në një vëllim më të ulët të kreditimit për sektorin real të ekonomisë që shkaktoi zvogëlim të mëturjes së konsumit dhe investimeve. Performanca më e dobët e sektorit real të ekonomisë ndikoi negativisht edhe performancën e vetë sektorit bankar, ku u shënuan rritje e kredive joperformuese dhe rënie e fitimit. Kanal tjetër i rëndësishëm i transmetimit të krizës në EJL ishte rënia e dërgesave të emigrantëve, të cilat paraqesin një burim shumë të

² Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Shqipëria.

rëndësishëm të financimit për ekonomitë e këtyre vendeve. Në kuadër të shteteve të EJJ-së, rënia më e theksuar e dërgesave të emigrantëve u regjistrua në Bosnje dhe Hercegovinë (11 përqind), Shqipëri (6 përqind) dhe Kosovë (5.5 përqind).

Ngjashëm me ekonomitë e zhvilluara, niveli i çmimeve edhe në ekonomitë e EJJ-së ndoqi trend rënës. Kjo si rezultat i rënies së çmimit të naftës, por edhe si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme. Përderisa, para fillimit të krizës, normat e larta të inflacionit ishin sfiduese për vendet e rajonit, gjatë vitit 2009, norma e inflacionit shënoi rënie të theksuar dhe në disa vende kishte deflacion si për shembull në Bosnje dhe Hercegovinë (0.4 përqind), Kosovë (2.4 përqind) dhe Maqedoni (1.6 përqind).

Rënia e kërkesës së brendshme në vendet e EJJ-së zvogëloi nivelin e importeve, gjë që shkaktoi zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse në shumicën e këtyre vendeve (Tabela 2). Përveç Shqipërisë dhe Kosovës, të gjitha vendet e EJJ-së shënuan rënie në deficitin e llogarisë rrjedhëse në krahasim me vitin paraprak. Si pasojë e krizës, pothuaj të gjitha vendet e EJJ-së (përveç Shqipërisë dhe Malit të Zi) kishin rënie të IHD-ve, të cilat paraqesin një burim shumë të rëndësishëm të financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vazhdimi i rënies së IHD-ve do të ketë implikime negative si për bilancin e pagesave, po ashtu edhe për sektorin real të ekonomisë.

Rënia e aktivitetit ekonomik kishte edhe implikime buxhetore për vendet e EJJ-së (Tabela 2). Për dallim nga vendet e zhvilluara, ku deficiti buxhetor u rrit si rezultat i shpenzimeve të destinuara për tejkalimin e krizës, rritja e deficitit buxhetor në vendet e EJJ-së më shumë i atribuohet performancës më të dobët të të hyrave buxhetore. Në shumicën e vendeve të EJJ-së, deficiti buxhetor ishte problematik edhe para fillimit të krizës, kështu që mundësitë për të rritur shpenzimet buxhetore në këto vende ishin mjaft të kufizuara. Gjatë kësaj periudhe, agjencitë për gradim zvogëluan klasifikimin kreditor për disa vende të EJJ-së, si për Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë, duke e bërë më të vështirë dhe më të shtrenjtë financimin e këtyre vendeve nga tregjet e kapitalit.

Gjatë vitit 2009, bankat qendrore të rajonit ishin mjaft aktive në menaxhimin e krizës duke shënuar sukses të veçantë në stabilizimin e sektorit financiar. Në asnjë vend të rajonit nuk ka bankrotuar ndonjë bankë e rëndësisë sistemore. Në disa raste (p.sh. Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë) kishte tërheqje të depozitave, mirëpo kjo tërheqje ishte e përkohshme. Bankat qendrore kryesisht u përqendruan në zvogëlimin e rezervës së detyrueshme me qëllim të rritjes së likuiditetit dhe kreditimit. Gjithashtu, në disa raste (p.sh. Serbi dhe Rumania) bankat qendrore intervenuan në tregjet valutore për të mbrojtur valutën vendore.

Menaxhimi i krizës në vendet e EJJ-së në masë të madhe u përkrah edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe, disa nga vendet e EJJ-së hynë në aranzhmane me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), ku mund të veçojmë Rumaninë (13 miliardë euro), Serbinë (3 miliardë euro) dhe Bosnje e Hercegovinën (1.1 miliardë euro). Gjithashtu, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bashkimi Evropian ndihmuan vendet e EJJ-së të tejkalojnë pasojat e krizës.

Me gjithë zhvlerësimin ndaj valutave kryesore botërore, valutat kombëtare të vendeve të EJJ-së ishin mjaft stabile gjatë gjithë vitit dhe nuk është paraqitur ndonjë zhvlerësim i pakontrolluar që do të mund të destabilizonte tregun valutor të këtyre vendeve. Vlera e lekut shqiptar u zhvlerësua për 11 përqind në raport me euron, ndërsa leu rumun dhe dinari serb u zhvlerësuan për 8 përkatësisht 5 përqind. Vendet të cilat aplikojnë politika më pak fleksibile të kursit të këmbimit, siç është Maqedonia, kishin valuta më stabile gjatë vitit 2009.

Një zhvillim mjaft inkurajues për vendet e EJJL-së gjatë vitit 2009 ishte performanca e mirë e tregjeve financiare, ku u vërejt rritje e aktivitetit të bursave si rezultat i kthimit të besimit të investitorëve. Gjatë kësaj periudhe disa nga bursat e vendeve të EJJL-së shënuan norma të kthimit të përafërta me normat e realizuara në bursat e vendeve të zhvilluara. Ndër bursat e EJJL-së me normë më të lartë të kthimit ishte bursa e Malit të Zi me 36 përqind dhe bursa e Maqedonisë me 31.3 përqind.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real

Përkundër zhvillimeve negative në ekonominë botërore, ekonomia e Kosovës në vitin 2009 u karakterizua me rritje pozitive ekonomike, edhe pse me një normë më të ulët se në vitin 2008. Për dallim nga vitet paraprake, sektori publik ishte gjeneruesi kryesor i kësaj rritjeje ekonomike. Kjo ndodhi si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve të këtij sektori. Edhe rënia e çmimeve prej 2.4 përqind mund të konsiderohet si një ndër faktorët që ka kontribuar pozitivisht në normën reale të rritjes ekonomike gjatë vitit 2009. Të ardhurat kombëtare bruto në dispozicion, të cilat përveç PBB-së përfshijnë edhe transferet dhe të ardhurat nga jashtë, shënuan rënie për rreth 2 përqind. Ky zhvillim kishte implikime negative për konsumin dhe investimet. Përkundër rënies së konsumit të sektori privat, kursimet e brendshme bruto vazhdojnë të jenë negative (-13 përqind e PBB-së).³ Sidoqoftë, kursimet kombëtare bruto ishin pozitive me një vlerë që ishte ekuivalente me 9.9 përqind të PBB-së. Kjo reflekton rëndësinë e transfereve dhe të ardhurave për ekonominë e Kosovës.⁴

Gjendja në tregun e punës, karakterizohet me një nivel të lartë të papunësisë, dhe vazhdon të jetë sfidë e rëndësishme për ekonominë e Kosovës. Sipas Entit të Statistikës së Kosovës (ESK), norma e papunësisë në Kosovë tejkalon shifrën prej 45 përqind të fuqisë punëtore, ndërsa vlerësohet se me nivelin aktual të rritjes ekonomike, kjo normë e papunësisë nuk pritët të zvogëlohet në periudhën afatmesme. Në kuadër të privatizimit, deri në fund të vitit 2009, shuma e përgjithshme e të hyrave nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore arriti në 451 milion euro ose rreth 12 përqind e PBB-së.

3.1.1 Produkti i brendshëm bruto⁵

Ekonomia e Kosovës në vitin 2009 shënoi normë pozitive të rritjes ekonomike. Vlerësimet e FMN-së për vitin 2009 tregojnë një rritje ekonomike prej 3.8 përqind, ndërsa vlerësimet e MEF-it tregojnë rritje prej 4.4 përqind. Në vitin 2009, norma reale e rritjes së PBB-së ishte më e lartë se sa norma nominale që reflekton rënien e çmimeve. Bartës kryesor i rritjes ekonomike për vitin 2009 ishte sektori publik, i cili rriti si konsumin po ashtu dhe investimet. Një rritje e lehtë u shënuar edhe në investimet e sektorit privat, përderisa konsumi i këtij sektori kishte nivel më të ulët krahasuar me vitin e kaluar.


Konsumi i përgjithshëm në Kosovë shënoi rritje të lehtë si rezultat i rritjes së konsumit të sektorit publik, përderisa konsumi i sektorit privat shënoi rënie të lehtë, kryesisht si rezultat i rënies së dërgesave të emigrantëve (për 5.5 përqind) dhe shtrëngimit të kredihënies nga bankat komerciale (kreditë e reja për ekonomitë familjare u zvogëluar për 7.1 përqind) Sidoqoftë, ndikimi i këtyre dy faktorëve është kompensuar deri në një masë nga rritja e pagave në sektorin publik dhe rritja e konsumit të këtij sektori për 13.1 përqind (përfshijë asistencën e jashtme).

³ Kursimet e brendshme bruto = Konsumi - PBB.

⁴ Kursimet kombëtare bruto = Konsumi - Të ardhurat kombëtare bruto në dispozicion.

⁵ Të dhënat mbi PBB-në janë projeksione të IMF (2009) dhe MEF (2009) dhe si të tilla mund të mos korrespondojnë me të dhënat e fundit në sektorë. Sipas IMF (2009), PBB nominale është 3,792 milionë euro, ndërsa, sipas MEF (2009), PBB nominale është 3,838 milionë euro.

Figura 1. Rritja reale e PBB-së



Burimi: IMF (2009) dhe MEF (2009)

Investimet e përgjithshme në vitin 2009 shënuan rritje pozitive, kjo si rezultat i rritjes së investimeve të sektorit publik për 15.4 përqind. Me rritje pozitive u karakterizuan edhe investimet e sektorit privat. Si pasojë e performancës më të dobët të sektorit real të ekonomisë, sektori bankar kishte kujdes të shtuar në kredidhënie me qëllim të evitimit të efekteve të mundshme negative në cilësinë e portofolit kreditor. Kjo rezultoi në një ngadalësim të kredidhënies, posaçërisht për ndërmarrjet, duke ndikuar kështu negativisht në investimet e sektorit privat. Investimet e sektorit privat u ndikuan negativisht edhe nga rënia e investimeve të huaja direkte (IHD) për rreth 20 përqind krahasuar me vitin paraprak.

Eksportet e Kosovës gjatë vitit 2009 vazhduan të mbesin në nivel mjaft të ulët (kryesisht si pasojë e mos implementimit të plotë të marrëveshjes CEFTA, ndërsa importet shënuan rënie të lehtë duke reflektuar çmimet më të ulëta në ekonominë botërore dhe rënien e kërkesës. Përkundër këtyre zhvillimeve, ndikimi i bilancit tregtar në PBB vazhdon të jetë negativ, pasi që deficitin tregtar vazhdon të mbetet mjaft i lartë.


Parashikimet fillestare të FMN-së për vitin 2010 sugjerojnë një normë reale të rritjes së PBB-së prej 4.3 përqind, ndërsa parashikimet e MEF-it sugjerojnë një normë reale të rritjes prej 6.0 përqind. Bazuar në këto parashikime, rritja ekonomike në vitin 2010 pritet të gjenerohet kryesisht nga investimet e sektorit privat dhe publik. Konsumi po ashtu pritet të jetë komponent i rëndësishëm, përkundër parashikimeve se konsumi i sektorit publik pritet të shënojë rënie.

3.1.2. Çmimet

Ecuritë e çmimeve në Kosovë në dy vitet e fundit ishin mjaft jostabile. Përderisa në vitin 2008 inflacioni arriti normën prej 9.3 përqind, viti 2009 u karakterizua me një normë mesatare të deflacionit prej 2.4 përqind. Indeksi i çmimeve të konsumit (angl. Consumer Price Index: CPI) vërehet se ka ndjekur trend të ngjashëm me indeksin e çmimeve të importit (që shënoi rënie për 4.7 përqind), duke reflektuar varësinë e ekonomisë së Kosovës në importe. Rënia e çmimeve të importit gjatë vitit 2009 më së tepërmi u ndikua nga rënia e çmimeve të produkteve minerale (kryesisht nafta), artikujve ushqimorë, makinerive dhe pajisjeve. Në anën tjetër, çmimet e prodhimit gjatë kësaj periudhe ishin mesatarisht më të larta se sa në vitin e kaluar për 3.8 përqind (Figura 2). Ngritja e çmimeve të prodhimit

ishite rezultat i ngritjes së çmimeve të energjisë elektrike me peshë të lartë në indeksin e çmimeve të prodhimit (mbi 50 përqind). Ndërsa, çmimet tjera që përbëjnë këtë indeks kryesisht shënuan rënie.


Figura 2. Indeksi i çmimit të konsumit, importit, prodhimit dhe çmimet globale të ushqimit



Burimi: ESK (2010b) dhe ESK (2010c)

Niveli i çmimeve të konsumit në Kosovë shënoi rënie të vazhdueshme gjatë vitit 2009. Çmimet e produkteve ushqimore, me peshën më të madhe në shportën e konsumit, kishin ndikimin më të madh në rënien e çmimeve të konsumit në Kosovë (figura 3). Rënia e çmimeve të produkteve ushqimore ishte rezultat i rënies së çmimeve të këtyre produkteve në nivel ndërkombëtar dhe në nivel vendi, si pasojë e rënies së kërkesës së përgjithshme. Rënies së nivelit të përgjithshëm të çmimeve i kontribuoi edhe rënia e çmimeve të transportit, ndërsa ndikim pozitiv në nivelin e përgjithshëm të çmimeve kishte rritja e çmimeve të ujit, ngrohjes dhe energjisë elektrike.

Figura 3. Kontributi i komponentëve kryesor të CPI në inflacion vjetor



Burimi: ESK (2010a)

Për vitin 2010, parashikohet që çmimet të jenë relativisht stabile krahasuar me dy vitet paraprake, si rezultat i stabilizimit ekonomik në shumë vende me të cilat Kosova ka marrëdhënie tregtare. Kjo është si rezultat i ndjeshmërisë së lartë të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë ndaj lëvizjeve të çmimeve të importit.


3.1.3 Tregu i punës

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK), nëpërmjet anketës së tregut të punës, vlerëson se norma e papunësisë në Kosovë tejkalon shifrën prej 45 përqind të fuqisë punëtore (për vitin 2008), ndërsa punësimi është rreth 25 përqind e gjithsej popullsisë në moshë të punës (16-64 vjeç). Duke pasur parasysh se mbi 20 përqind e gjithsej popullsisë në moshë të punës nuk hyjnë në tregun e punës, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë mund të konsiderohen si të papunë vullnetarë.

Të dhënat nga Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP) i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), tregojnë se numri i punëkërkuessve të regjistruar në Kosovë në fund të 2009-së ishte afër 339.000. Struktura e punëkërkuessve sipas kualifikimit ishte si vijon: të pakualifikuar (64.1 përqind), me kualifikim të mesëm (34.4 përqind) dhe 1.5 përqind me kualifikim universitar. Struktura e punëkërkuessve sipas gjinisë paraqitet e balancuar, ku rreth 47 përqind prej tyre i takojnë gjinisë femërore. Mbi 90 përqind e punëkërkuessve të regjistruar kanë qenë të papunësuar për një periudhë më të gjatë se 12 muaj, që tregon se papunësia në Kosovë është afatgjate.

DPP si ndërmjetësues në punësim ka arritur që për çdo vit të punësojë mesatarisht 6,400 punëkërkuess të regjistruar. Krahasuar me vitin 2008, punësimi nëpërmjet DPP-së është rritur dukshëm (nga 5842 punësime në 2008, në 7,239 punësime në vitin 2009). Si rezultat i strukturës së re të popullsisë së Kosovës, një numër i madh i të rinjve hyjnë në tregun e punës për çdo vit, ndërsa numri i vendeve të reja të punës që krijohen brenda një viti është i ulët.

Figura 4. Tregu i punës




Burimi: MPMS (2010)

Për shembull, vetëm në kuadër të DPP-së gjatë viteve 2004-2009 janë regjistruar si punëkërkuess të rinj mesatarisht 25 mijë persona brenda një viti, ndërsa numri mesatar i vendeve të reja të punës të lajmëruara në DPP për çdo vit ishte rreth 7,500. Punëkërkuessit

e regjistruar në Kosovë përfaqësojnë mbi 40 përqind të gjithsej fuqisë punëtore, mirëpo duhet pasur parasysh se kjo pasqyrë mund të mos reflektojë gjendjen reale, pasi që mund të ketë persona të papunësuar të cilët nuk janë regjistruar si punëkërkues dhe po ashtu mund të ketë persona të cilët janë punësuar në sektorë joformal, mirëpo me qëllim të përfitimit të asistencës sociale, vazhdojnë të figurojnë si punëkërkues në regjistrat e DPP-së.

Paga nominale mesatare në sektorin privat në Kosovë gjatë vitit 2009 ishte rreth 258 euro, ndërsa në sektorin publik 263 euro. Niveli i pagave në Kosovë gjatë vitit 2009 shënoi rritje si në terma nominalë, po ashtu edhe në terma realë. Pagat reale në sektorin privat shënuan rritje prej rreth 6 përqind, ndërsa rritja reale e pagave në sektorin publik ishte më e lartë se 20 përqind. Siç shihet në Figurën 5, rritja më e lartë e pagave ndodhi gjatë vitit 2009 si rezultat i deflacionit. Rritja e pagave reale mund të ndikojë negativisht në konkurrueshmëri duke i bërë produktet kosovare më të shtrenjta, si dhe duke zvogëluar joshjen e IHD-ve që kanë për shënjestër fuqinë e lirë punëtore.

Figura 5. Ndryshimet në pagat reale dhe nominale të sektorit privat dhe publik



Burimi: ESK (2010d), MPMS (2009)

3.1.4 Privatizimi


Deri në fund të vitit 2009, shuma e të hyrave nga procesi i privatizimi arriti në 451.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind. Gjatë vitit 2009, gjithsej 114 ndërmarrje shoqërore (NSH) të reja u shpallën për t'u privatizuar, duke ngritur kështu në 569 numrin e gjithsej NSH-ve të tenderuara për privatizim, deri në fund të vitit 2009. Nga këto, për 521 ndërmarrje janë nënshkruar kontratat e shitjes, ndërsa për 48 tjera pritjet të nënshkruhen. Që nga fillimi i këtij procesi, nga gjithsej 569 NSH të tenderuara për privatizim, 25 prej tyre janë privatizuar me spin-off special. Si rezultat, shuma e përgjithshme e investimeve të zotuar është 196.3 milion euro, kurse deri në fund të vitit 2009 janë realizuar rreth 73 përqind e investimeve të zotuar. Në kuadër të kontratave me spin-off special, numri i punëtorëve që kompanitë fituese janë zotuar se do të punësojnë është 8114, kurse deri në fund të 2009 janë punësuar 6577 punëtorë. Sa i përket shpërndarjes së pjesës së fondit të privatizimit e cila i takon punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara (20 përqind e vlerës së shitjes së ndërmarrjes), deri në fund të vitit 2009 janë shpërndarë afër 20 milionë euro apo rreth 4 përqind të gjithsej të hyrave nga privatizimi.

Vlera e mjeteve të grumbulluara përmes procesit të privatizimit në Kosovë deri në fund të vitit 2009 është ekuivalente me 11.7 përqind të PBB-së. Ky raport është më i ulët në krahasim me vendet e rajonit, ku mesatarisht pjesëmarrja e të hyrave nga privatizimi në PBB është rreth 18 përqind. Në mesin e vendeve të rajonit, Shqipëria është vendi i cili ka nivelin më të ulët të të hyrave nga privatizimi si përqindje e PBB-së (rreth 13 përqind), ndërsa të hyrat nga privatizimi në Kroaci dhe në Serbi janë më të larta se 20 përqind e PBB-së së këtyre vendeve. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh se shumë nga vendet e rajonit kanë privatizuar sektorët strategjikë të ekonomisë si p.sh. kompanitë e telekomunikacionit, energjetikës, etj., si dhe kanë filluar procesin e privatizimit pothuaj një dekadë më herët se Kosova.

3.2. Sektori fiskal

Në vitin 2009, Buxheti i Kosovës shënoi deficit prej 85.6 milionë euro ose rreth 2.2 përqind e PBB-së (Figura 6). Marrë në përgjithësi, politika fiskale në Kosovë në periudhën e pas luftës ka qenë mjaft konservative, e karakterizuar kryesisht me tepricë buxhetore ose nivele të ulëta të deficitit. Këto politika deri diku janë kushtëzuar nga mundësitë e kufizuara të Qeverisë së Kosovës për t'i financuar deficitet buxhetore, duke pasur si mundësi të vetme tepricat buxhetore të akumuluar nga vitet paraprake.

Figura 6. Bilanci buxhetor, në milionë euro



Burimi: MEF (2010)

Këto kufizime ishin pasojë e mungesës së ligjit për borxh publik si dhe statusit të pazgjidhur politik të Kosovës deri në vitin 2008, që pamundësonte huazimin eventual nga institucionet financiare ndërkombëtare. Në fund të vitit 2009, u miratua edhe Ligji për Borxhin Publik që i mundëson Qeverisë së Kosovës të hyjë në obligime kreditore për të financuar deficitin eventual buxhetor si dhe i bënë të mundur emetimin e letrave me vlerë. Në bazë të këtij ligji, borxhi publik i Kosovës nuk mund të kalojë shumë prej 40 përqind të PBB-së. Megjithatë, edhe para aprovimit të këtij ligji, Kosova ka trashëguar prej ish-Jugosllavisë borxh publik në vlerë prej 385.0 milionë euro. Në tremujorin e fundit të vitit 2009 është bërë pagesa e një pjese të borxhit publik në vlerë prej 43.8 milionë euro ndaj Bankës Botërore, për të cilën nuk është kërkuar pagesë interesi. Po në të njëjtën periudhë të vitit, Kosova është liruar nga pagesa e një pjese tjetër të këtij borxhi në vlerë prej 89.1 milionë euro, ku prej tyre, 84.1 milionë euro janë donacion nga Shtetet e Bashkuara të

Amerikës, ndërsa 5.0 milionë euro të tjera janë donacion nga Komisioni Evropian. Pjesa e mbetur e borxhit publik është 252.1 milionë euro ose 6.4 përqind e PBB-së.

Gjatë vitit 2009, Kosova u anëtarësua në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe në Bankën Botërore (BB), që paraqet një mundësi të veçantë për zhvillim ekonomik dhe ballafaqim me sfidat makroekonomike. Në rast se Kosova hyn në aranzhman financiar me FMN-në, ky institucion pritet që të mbështesë nevojat eventuale buxhetore dhe në të njëjtën kohë duke kushtëzuar implementimin e reformave në ekonomi, si për shembull reformën në administratën publike, përmirësimin e politikave makroekonomike, etj. (Kutia 1).


Kutia 1. Anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar

FMN-ja është organizatë ndërkombëtare, e cila përmes programeve financiare dhe asistencës teknike, ndihmon ekonomitë e vendeve anëtare që t'i arrijnë objektivat makroekonomike, siç janë rritja e qëndrueshme ekonomike, zbutja e problemeve në bilancin e pagesave, stabiliteti financiar dhe i çmimeve, etj. Kosova u anëtarësua në FMN në qershor të vitit 2009, duke u bërë anëtar i 189-të i këtij institucioni. Anëtarësimi në FMN paraqet një mundësi të veçantë për perspektivat dhe sfidat e reja të zhvillimit ekonomik. Fillimisht, Kosovës i është përcaktuar kuota prej 59 milionë SDR (94.6 milionë euro), që i jep të drejtën e 840 votave, ose 0.04 përqind të gjithsej votave në FMN. Prej tyre, 24 përqind e kuotës është paguar në euro, ndërsa 76 përqind janë obligime (Dëftesë Premtimi) në llogarinë e FMN-së të hapur në BQK, dhe në rast nevojë FMN-ja mund t'i tërheqë automatikisht. Aktualisht, Kosova mund të marrë hua deri në 100 përqind të kuotës në baza vjetore, ndërsa borxhi i akumuluar nuk mund të kalojë 300 përqind të kuotës. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme kreditimi nga FMN-ja mund të jetë edhe më i lartë.

3.2.1. Të hyrat buxhetore

Të hyrat buxhetore në vitin 2009 arritën vlerën prej 1,146.7 milionë euro apo rreth 30 përqind të PBB-së (24.5 përqind e PBB-së në vitin 2008). Raporti të hyra buxhetore–PBB në Kosovë qëndron nën mesataren e vendeve të rajonit që është rreth 36 përqind e PBB-së. Realizimi i të hyrave buxhetore (përfshirë dividendën e PTK-së) ishte afër nivelit të planifikuar, por me normë më të ulët krahasuar me vitin 2008, kur ky raport ishte 106.0 përqind (Figura 7).

Figura 7. Buxheti i planifikuar dhe i realizuar, në milionë euro




Burimi: MEF (2010)

Krahasuar me vitin 2008, të hyrat buxhetore shënuan rritje vjetore prej 21.7 përqind (Figura 8). Kësaj norme të rritjes i ka kontribuar rritja e theksuar e të hyrave jotatimore që rezultoi nga bartja e dividendës së PTK-së në vlerë prej 200.0 milionë euro. Rrjedhimisht, të hyrat jotatimore u trefishuan në krahasim me vitin 2008, duke arritur vlerën prej 282.7 milionë euro në fund të vitit 2009, me ç'rast pjesëmarrja e tyre në gjithsej të hyrat buxhetore arriti në 24.7 përqind (10.3 përqind në vitin 2008). Përveç dividendës, pjesa tjetër e të hyrave jotatimore përbëhet nga taksat, licencat, gjobat (rreth 47 milionë euro) dhe të hyrat tjera.

Burim kryesor i të hyrave buxhetore vazhdojnë të jenë të hyrat nga tatimet e mbledhura në kufi. Si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së të hyrave jotatimore në gjithsej të hyrat buxhetore, pjesëmarrja e të hyrave të mbledhura në kufi u zvogëlua në 55.3 përqind nga 64.1 përqind sa ishte në vitin 2008. Tatimet e mbledhura në kufi arritën vlerën prej 634.0 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 5 përqind, që kryesisht është rezultat i rritjes së normës së TVSH-së prej 15 në 16 përqind. Në vitin 2009, TVSH e mbledhur në kufi arriti vlerën prej 314.7 milionë euro, e cila është për 3.4 përqind më e lartë sesa në vitin 2008. Rritja e normës së TVSH-së kompensoi deri në një masë efektin negativ të rënies së importeve në nivelin e të hyrave të mbledhura në kufi. Një kategori tjetër e rëndësishme e të hyrave që mbledhen në kufi janë të hyrat nga akciza, të cilat në vitin 2009 shënuan një rritje prej 7.1 përqind (141.9 milionë euro në 2009), ku në masë të madhe ndikoi rritja e normës së akcizës për produktet si alkooli, duhani, kafja, karburantet, etj.

Një burim tjetër i rëndësishëm i të hyrave buxhetore janë tatimet vendore, pjesëmarrja e të cilave në gjithsej të hyrat u zvogëlua në 15.8 përqind (21.3 përqind në vitin 2008). Vlera e të hyrave të mbledhura përmes tatimeve vendore në vitin 2009 ishte për 9.5 përqind më e ulët se sa në vitin 2008. Zvogëlimi i nivelit të këtyre të hyrave reflekton normën më të ulët të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend që shpjegohet edhe nga norma më e ulët e rritjes ekonomike për këtë vit. Po ashtu, të hyrat nga tatimet vendore u zvogëluan edhe si pasojë e zvogëlimit të normave tatimore në të ardhurat personale dhe në fitimin e korporatave. Vlera e të hyrave buxhetore të mbledhura nga tatimet në të ardhurat personale në vitin 2009 ishte 38.0 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 12.6 përqind. Tatimi në fitimin e korporatave paraqet kategorinë më të rëndësishme të tatimeve vendore, duke gjeneruar 30.2 përqind të këtyre të hyrave.

Figura 8. Struktura e të hyrave buxhetore, në përqindje



Burimi: MEF (2010)

Sidoqoftë, vlera e të hyrave nga tatimi në fitimin e korporatave në vitin 2009 ishte 54.8 milionë euro, që është për 16.3 përqind më e ulët se sa në vitin paraprak. Vlen të ceket se në kuadër të sektorit privat ekziston një nivel i lartë i ekonomisë joformale për shkak të bizneseve dhe të punësuarve të paregjistruar. Kjo ndikon në zvogëlimin e bazës tatimore dhe po ashtu pamundëson marrjen e kredive prej individëve dhe bizneseve nga sektori bankar.


Përveç performancës më të dobët të ekonomisë dhe zvogëlimit të normave tatimore, rënia e të hyrave nga tatimi në fitim mund t'i atribuohet edhe rënies së nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Me qëllim të ngritjes së performancës në inkasimin e tatimeve vendore, në vitin 2010 do të implementohet projekti i arkave fiskale, gjë që pritet të ngritë edhe më tepër rëndësinë e këtij burimi të të hyrave për buxhetin e Kosovës. Kategoria e dytë më e rëndësishme e tatimeve vendore, për nga vëllimi i të hyrave të gjeneruara, është TVSH-ja e mbledhur brenda vendit, e cila në vitin 2009 gjeneroi 27.9 përqind të gjithsej tatimeve vendore. Të hyrat e gjeneruara nga kjo kategori e tatimeve në vitin 2009 shënuan një rritje vjetore prej 36.6 përqind, që është rezultat i rritjes së normës së TVSH-së.

Një kategori tjetër e tatimeve vendore me bazë relativisht të ulët është edhe tatimi i paragjykuar dhe tatimi në fitim. Të hyrat buxhetore të gjeneruara nga tatimi i paragjykuar ishin 2.1 milionë euro (1.3 milionë euro në vitin 2008), ndërsa tatimi në fitimin e bizneseve arriti vlerën 8.35 milionë euro (4.4 milionë euro në 2008). Të hyrat e mbledhura nga qeveritë lokale në vitin 2009 patën pjesëmarrje (4.2 përqind) dhe vëllim (42.8 milionë euro) të ngjashëm me atë të vitit të kaluar.

3.2.2. Shpenzimet buxhetore

Në vitin 2009 shpenzimet buxhetore arritën vlerën prej 1,232.3 milionë euro, një rritje vjetore prej 29.7 përqind, duke arritur kështu në 32 përqind të PBB-së (24.7 përqind e PBB-së në vitin 2008). Kjo paraqet pjesëmarrjen më të lartë të shpenzimeve buxhetore në PBB në periudhën e pasluftës. Megjithatë, Kosova ka raportin shpenzime buxhetore-PBB më të ulët krahasuar me mesataren e rajonit që është rreth 38 përqind e PBB-së. Në përgjithësi, në vitin 2009 shpenzimet buxhetore të dedikuara për konsum ishin 11.2 përqind e PBB-së, ndërsa investimet kapitale ishin 10.3 përqind e PBB-së.

Figura 9. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në përqindje



Burimi: MEF (2010)

Edhe në vitin 2009 niveli i shpenzimeve buxhetore të realizuara ishte më i ulët se sa niveli i planifikuar, gjë që kryesisht shkaktohet nga vonesat në ekzekutimin e projekteve (Figura 7). Një prej kategorive të shpenzimeve që për çdo vit ka pasur nivel më të ulët të realizimit në raport me nivelin e planifikuar janë shpenzimet kapitale. Megjithatë, në vitin 2009, norma e realizimit të shpenzimeve kapitale është ngritur në 81 përqind të nivelit të planifikuar, krahasuar me 68 përqind në vitin 2008.

Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe në vitin 2009, projektet kapitale absorbuan pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore. Shpenzimet kapitale në vitin 2009 ishin 400.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.4 përqind, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej shpenzimet arriti në 32.2 përqind (36.5 përqind në vitin 2008). Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale është destinuar në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (39.7 përqind e shpenzimeve kapitale). Në vitin 2009, Qeveria e Kosovës shpenzoi 4.2 përqind të buxhetit në sektorin e arsimit, që është një proporcion i ngjajshëm me mesataren e rajonit. Ndërsa, investimet në sektorin e shëndetësisë përbëjnë 6.0 përqind të gjithsej buxhetit dhe janë për 1pp më të ulëta se mesatarja e rajonit. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje relativisht të lartë vjetore prej 17.6 përqind. Pjesa më e madhe e subvencioneve dhe transfereve është destinuar për ndërmarrjet publike (32.0 përqind e subvencioneve), si KEK-u, Termokosi etj., si dhe për pensionet bazë (33.5 përqind e transfereve). Në kuadër të këtyre shpenzimeve, KEK-ut i është ndarë kredi në vlerë prej 78.8 milionë euro. Shpenzimet për paga dhe mëditje shënuan një rritje vjetore prej 16.4 përqind dhe në vitin 2009 përbënin 21.5 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore. Në anën tjetër, shpenzimet për mallra dhe shërbime u rritën për 8.3 përqind, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej shpenzimet ishte 13.9 përqind. Në kategorinë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, në vitin 2009, rritje të theksuar shënuan edhe shpenzimet për shërbimet kontraktuese për konsulentët vendorë dhe të huaj, të cilat arritën vlerën prej 30.9 milionë euro (19.2 milionë euro në vitin 2008). Gjatë vitit 2009 u paraqitën edhe dy kategori tjera të shpenzimeve buxhetore. Në kuadër të këtyre shpenzimeve, në tremujorin e fundit të vitit 2009 është bërë pagesa e një pjese të borxhit publik në vlerë prej 43.8 milionë euro ndaj Bankës Botërore, si dhe pagesa për anëtarësim në BB dhe FMN në vlerë prej 17.0 milionë euro.

Në fund të muajit nëntor 2009, Kuvendi i Kosovës miratoi në parim projektbuxhetin për vitin 2010 në vlerë prej 1.4 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 19.1 përqind krahasuar me buxhetin e vitit 2009. Sipas këtij projektbuxheti, niveli i të hyrave për vitin 2010 arrin vlerën prej 1,029.2 milionë euro, ndërsa vlera e shpenzimeve të buxhetuara është 1,156.6 milionë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës në vitin 2010 pritet të ketë deficit prej 127.4 milionë euro. Në kuadër të buxhetit është paraparë shfrytëzimi i financimit të jashtëm në vlerë prej 50.0 milionë euro, ndërsa një vlerë prej 200.0 milionë euro është ndarë në formë të rezervës. Po ashtu, 70.0 milionë euro janë buxhetuar si hua për përpilimin e politikave, ndërsa pagesa e interesit të borxhit të jashtëm është buxhetuar në vlerë prej 15.0 milionë euro.


3.3. Sektori financiar

3.3.1. Karakteristikat e përgjithshme

Sektori financiar i Kosovës vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2009, duke arritur vlerën e përgjithshme të aseteve prej 2.8 miliardë euro (pa konsideruar BQK-në), që paraqet një rritje vjetore prej 24.2 përqind. Sektori bankar vazhdon të përfaqësojë pjesën më të madhe të aseteve të sektorit financiar (78.6 përqind), edhe pse me një pjesëmarrje më të ulët krahasuar me vitin e kaluar (Figura 10). Fondet pensionale menaxhojnë 13.6 përqind të

gjithsej asetëve të sektorit financiar, përdherisa pjesa tjetër prej 7.8 përqind e asetëve ndahet në mes të institucioneve mikrofinanciare (4.7 përqind), kompanive të sigurimeve (2.9 përqind) dhe ndihmësve financiar (0.2 përqind).

Figura 10. Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2010)

Për sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, viti 2009 nuk u karakterizua me ndonjë ndryshim substancial. Numri i bankave komerciale dhe fondeve pensionale mbetet i njëjtë, ndërsa gjatë këtij viti filluan aktivitetin edhe dy institucione mikrofinanciare (Tabela 3).

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
Bankat komerciale	6	7	8	8
Kompanitë e sigurimeve	9	10	11	11
Fondet pensionale	7	2	2	2
Ndhmësit fin. dhe inst. mikrofinanciare	38	46	45	46

Burimi: BQK (2010)


Vlera e asetëve të jashtme neto (AJN) vazhdon të jetë mjaft e lartë duke arritur shifrën prej 1.7 miliardë euro apo 43.6 përqind e PBB-së në vitin 2009. Pjesa më e madhe e asetëve të sektorit financiar (përfshirë BQK-në) është e investuar në formë të depozitave (44.7 përqind), dhe në letra me vlerë (35.6 përqind). Gjithsej vlera e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm në fund të vitit 2009 ishte 2.04 miliardë euro, apo 18 përqind më e lartë sesa në vitin e kaluar. Rritja e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm kryesisht ndodhi gjatë tremujorit të tretë, përdherisa në tremujorin e fundit kishte një rritje dukshëm më të ulët që përkon me rritjen e shpenzimeve qeveritare gjatë kësaj periudhe.

Asetet e sektorit financiar të Kosovës të investuara jashtë vendit kryesisht përbëhen nga asetet e BQK-së të cilat përfaqësojnë 58.8 përqind të këtyre asetëve, të pasuara nga asetet e bankave komerciale (29.2 përqind) dhe fondeve pensionale (12 përqind). Gjatë vitit 2009, sektori financiar i Kosovës shënoi një rritje më të theksuar të detyrimeve ndaj sektorit të

jashtëm, të cilat pothuajse u trefishuan në krahasim me vitin 2008, duke arritur shumën prej 335.4 milionë euro. Rritja më e theksuar e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm është shkaktuar edhe nga alokimi i kuotës së FMN-së për Kosovën (rreth 60 milionë euro), si dhe nga rritja e vlerës së kredive nga jashtë që shfrytëzohen nga bankat komerciale dhe institucionet tjera financiare në Kosovë.

Sektori financiar bartë detyrime ndaj sektorit fiskal, por jo edhe kërkesa. Këto detyrime përbëhen nga depozitat e qeverisë në sektorin financiar (kryesisht në BQK), të cilat në fund të vitit 2009 arritën vlerën 846.3 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.9 përqind (Figura 11). Kjo rënie e depozitave ndodhi kryesisht gjatë tremujorit të fundit të vitit, si rezultat i rritjes së shpenzimeve buxhetore. Bilanc negativ vazhduan të kenë edhe kërkesat neto të sektorit financiar ndaj sektorit real. Në fund të vitit 2009, kërkesat e sektorit financiar ndaj sektorit real, të përbëra kryesisht nga kreditë e lëshuara nga sektori bankar, arritën vlerën prej 1.4 miliardë euro, ndërsa detyrimet ndaj sektorit real, që kryesisht përbëhen nga depozitat në bankat komerciale, arritën vlerën 1.8 miliardë euro (Figura 11).

Figura 11. Kërkesat neto të sektorit financiar




Burimi: BQK (2010)

3.3.2. Struktura dhe aktiviteti i sektorit bankar

Struktura pronësore e sistemit bankar të Kosovës në vitin 2009 ishte e njëjtë me vitin e kaluar, e përbërë nga gjashtë banka me pronësi të huaj dhe dy me pronësi vendore. Sektori mbetet i dominuar nga bankat me pronësi të huaj të cilat menaxhojnë 91.5 përqind të gjithsej asetëve. Karakteristikë e tregut bankar të Kosovës vazhdon të jetë shkalla e lartë e koncentrimin, ku 81 përqind e gjithsej asetëve menaxhohen nga tri bankat më të mëdha. Megjithatë, hyrja e bankave të reja në treg gjatë vitit 2008, si dhe rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla, ka ndikuar që shkalla e koncentrimin në tregun bankar të Kosovës të ndjekë trend rënës. Për shembull, shkalla e koncentrimin e shprehur përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index: HHI) për asetë në vitin 2009 zbriti në 2,482 pikë, nga 2,745 pikë sa ishte në vitin 2008 (Figura 12).

Figura 12. HHI për asete, kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2010)

Gjatë vitit 2009, ishte evident një ngadalësim i theksuar i rritjes së numrit të degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale, ndërsa numri i të punësuarve në këtë sektor u zvogëluar. Këto zhvillime kryesisht reflektojnë masat e ndërmarra nga bankat komerciale për të zvogëluar shpenzimet e tyre operative. Në vitin 2009, numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale arriti në 292 (5 më shumë se në vitin 2008), përderisa numri i punëtorëve të punësuar në këtë sektor zbriti në 3,444 (nga 3,607 sa ishte në fund të vitit 2008). Gjatë vitit 2009, ka vazhduar zgjerimi i infrastrukturës së bankave në kuptim të numrit të bankomatëve, POS terminaleve dhe llogarive elektronike bankare me qëllim të lehtësimit të qasjes së klientëve në shërbimet bankare (Tabela 4). Madje, numri i llogarive elektronike (e-banking) është trefishuar, duke arritur kështu në 40,924.

Tabela 4. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
Numri i degëve dhe nëndegëve	220	235	287	292
Numri i të punësuarëve	2,416	2,715	3,607	3,444
Numri i ATM-ve	116	155	240	339
Numri i POS-ve	1,767	2,554	3,426	5,251
Numri i llogarive e-banking	2,872	4,742	13,051	40,924

Burimi: BQK (2010)

3.3.2.1. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar

i. Asetet

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2009. Vlera e aseteve të menaxhuara nga bankat komerciale në fund të vitit 2009 arriti në 2.2 miliardë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 21.9 përqind. Vlera e aseteve të sektorit bankar shënoi rritje

në raport me PBB-në, duke arritur nivelin prej 56.5 përqind (krahasuar me 47 përqind të PBB-së sa ishte në vitin 2008).

Struktura e aseteve të sektorit bankar në vitin 2009 ishte e ngjashme me periudhat e kaluara, ku pjesën më të madhe e përfaqësojnë kreditë (58.5 përqind). Sidoqoftë, pjesëmarrja e kredive në gjithsej strukturën e aseteve në vitin 2009 ishte për 6.9pp më e ulët se sa në vitin 2008. Në anën tjetër, pothuaj të gjitha kategoritë tjera kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në strukturën e përgjithshme të aseteve të sektorit bankar (Tabela 5).

Tabela 5. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	2006		2007		2008		2009	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	141.1	12.1%	189.0	13.2%	218.2	12.1%	322.7	14.6%
Bilanci me bankat komerciale	243.3	20.9%	208.1	14.5%	283.9	15.7%	405.6	18.4%
Letrat me vlerë	99.4	8.6%	78.9	5.5%	40.5	2.2%	97.0	4.4%
Kreditë dhe lizingu (bruto)	636.6	54.8%	892.1	62.2%	1,183.4	65.4%	1,289.0	58.5%
Asetet fikse	23.0	2.0%	27.2	1.9%	39.0	2.2%	43.1	2.0%
Asetet tjera	17.9	1.5%	39.7	2.8%	43.1	2.4%	46.7	2.1%
Gjithsej	1,161	100%	1,435	100%	1,808	100%	2,204	100%

Burimi: BQK (2010)

Kreditë e sektorit bankar gjatë vitit 2009 vazhduan trendin e rritjes, por me një normë dukshëm më të ulët krahasuar me periudhat e kaluara. Norma vjetore e rritjes së kredive të sektorit bankar ishte 8.9 përqind (32.7 përqind në vitin 2008). Shtrëngimi i kredidhënies më tepër u vërejt te kreditë për ndërmarrjet, të cilat në vitin 2009 shënuan një rritje vjetore prej vetëm 4.6 përqind (30.4 përqind në vitin 2008). Kreditë për ekonomitë familjare u ndikuan në masë më të vogël, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 22.3 përqind (40.1 përqind në vitin 2008). Niveli i kredive të reja të lëshuara në vitin 2009 vërehet të jetë më i ulët se ai i një viti paraprak. Gjatë vitit 2009 vlera mesatare e kredive të reja të lëshuara për një muaj ishte 52.5 milion euro krahasuar me 57.8 milion euro në vitin 2008.

Ngadalësimi i kredidhënies i ka shtyrë bankat komerciale të orientojnë një pjesë të investimeve të tyre drejt kategorive tjera të aseteve. Rritja më e theksuar vërehet në investimet në letra me vlerë, të cilat arritën në 97 milionë euro në vitin 2009 nga 40.5 milion euro në vitin 2008 (Tabela 5). Rritja e këtyre investimeve po ashtu është rezultat i stabilizimit të tregjeve të kapitalit në sektorin e jashtëm, gjë që ka kontribuar në rritjen e sigurisë së këtyre investimeve.


ii. Struktura e kredive

Struktura e kredive edhe gjatë vitit 2009 u dominua nga kreditë për ndërmarrjet. Sidoqoftë, pjesëmarrja e tyre në gjithsej kreditë zbriti në 73.3 përqind (76.3 përqind në 2008), përderisa pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare u ngrit në 26.7 përqind të gjithsej kredive (23.7 përqind në 2008). Niveli i ulët i prodhimit dhe mbështetja e lartë e ekonomisë së Kosovës në import pasqyrohen edhe në shpërndarjen sektoriale të kredive për ndërmarrjet private. Pjesa më e madhe e këtyre kredive absorbohet nga ndërmarrjet e sektorit të tregtisë (56.4 përqind e kredive të ndërmarrjeve), përderisa sektori i industrisë

(përfshirë minierat, prodhimtarinë, energjinë dhe ndërtimtarinë) ka 25.0 përqind të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Sektori me pjesëmarrje më të ulët vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, me vetëm 4.0 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje. Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një rritje e pjesëmarrjes së kredive për sektorin e industrisë (7.5pp), ndërsa pjesëmarrja e kredive të sektorëve tjerë nuk kishte ndonjë ndryshim substancial. Ngadalësimi i kredidhënies duket mos të ketë ndikuar kreditë për sektorin e industrisë, të cilat arritën vlerën prej 236.7 milionë euro në vitin 2009, që paraqet një rritje vjetore prej 47.8 përqind. Megjithatë, ngadalësimi i kredidhënies është vërejtur më së shumti në sektorin e tregtisë, ku rritja vjetore e këtyre kredive ishte 5.7 përqind, një rritje dukshëm më e ulët se ajo e vitit paraprak prej 21.3 përqind.

Struktura e kredive ishte e ngjashme me vitin e kaluar edhe për sa i përket afatit të maturimit. Pjesa më e madhe e kredive përbëhet nga kreditë me afat maturimi prej më shumë se dy vite, të cilat përfaqësojnë 70 përqind të gjithsej kredive (Figura 13). Pjesëmarrja e kredive me afat më të gjatë të maturimit ka ndjekur një trend të vazhdueshëm të rritjes, duke reflektuar ngritjen e besimit të sistemit bankar ndaj mjedisit afarist në Kosovë. Pjesa tjetër e kredive përbëhet nga kreditë me afat maturimi ndërmjet një dhe dy viteve, të cilat përfaqësojnë 11.2 përqind të gjithsej kredive. Ndërsa, kreditë me afat maturimi deri në një vit përbëjnë 18.8 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar. Ngadalësim më i theksuar i kreditimit është vërejtur në kreditë me maturitet prej një deri në dy vite të cilat paraqesin kategorinë e vetme të kredive, vlera e të cilave shënoi rënie prej 11.1 përqind.

Figura 13. Struktura e kredive



Burimi: BQK(2010)

iii. Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar edhe gjatë vitit 2009 u dominua nga depozitat, të cilat përfaqësuan 79.5 përqind të gjithsej detyrimeve. Në vitin 2009, depozitat e sektorit bankar shënuan një rritje vjetore prej 21 përqind (26.3 përqind në vitin 2008), duke arritur vlerën prej 1.74 miliard euro. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së depozitave të ekonomive familjare, meqenëse depozitat e ndërmarrjeve në bankat komerciale shënuan rënie (prej 20.7 përqind). Në kuadër të detyrimeve të sektorit bankar, vërehet një rritje e vazhdueshme e borxhit të ndërvarur dhe e plasmanëve nga bankat komerciale jashtë vendit, gjë që tregon se sektori bankar i Kosovës po e rrit shfrytëzimin e burimeve të

jashtme të financimit (shih Tabelën 6). Sidoqoftë, pjesëmarrja e këtyre kategorive në gjithsej detyrimet e sektorit bankar vazhdon të jetë e ulët (3.8 përqind).

Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2006		2007		2008		2009	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	30.3	2.6%	25.8	1.8%	34.9	1.9%	58.5	2.7%
Depozitat	924.3	79.6%	1,143.1	79.7%	1,444.1	79.9%	1,744.9	79.2%
Huatë tjera	4.2	0.4%	2.7	0.2%
Detyrimet tjera	92.1	7.9%	103.7	7.2%	129.8	7.2%	171.7	7.8%
Borxhi i ndërvuar	7.0	0.6%	7.0	0.5%	7.0	0.4%	24.4	1.1%
Mjetet vetanake	103.3	8.9%	152.7	10.6%	192.5	10.6%	204.6	9.3%
Gjithsej	1,161	100%	1,435	100%	1,808	100%	2,204	100%

Burimi: BQK (2010)

Një kategori mjaft e rëndësishme e detyrimeve të sektorit bankar përbëhet nga mjetet vetanake të bankave komerciale, të cilat kryesisht përbëhen nga kapitali aksionar që përfaqëson 77.9 përqind të gjithsej këtyre mjeteve. Në vitin 2009, bankat komerciale rritën kapitalin aksionar për 9.3 përqind, duke e ngritur në nivelin prej 159.4 milion euro. Profiti i pashpërndarë (si pjesë e mjeteve vetanake) pothuajse u dyfishua krahasuar me vitin 2008 duke arritur vlerën prej 19.7 milion euro, ndërsa profiti i realizuar gjatë vitit 2009 ishte për 30 përqind më i ulët se ai i vitit 2008.


iv. Struktura e depozitave

Pjesa më e madhe e depozitave të sektorit bankar përbëhet nga depozitat e ekonomive familjare me një pjesëmarrje prej rreth 60 përqind në gjithsej depozitat, përderisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 15.3 përqind. Deri në vitin 2009, një pjesë substanciale e depozitave në sektorin bankar i takonte ndërmarrjeve publike, mirëpo me transferimin e dividendës në vlerë prej 200 milionë euro nga PTK-ja te Qeveria e Kosovës, depozitat e ndërmarrjeve publike shënuan një rënie të konsiderueshme. Në fund të vitit 2009, depozitat e ndërmarrjeve publike përfaqësuan 7.0 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar, krahasuar me 18.3 përqind në vitin 2008. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e depozitave të qeverisë në bankat komerciale në vitin 2009 arriti në 9.4 përqind dhe pjesa prej 4.1 përqind e depozitave i takon institucioneve tjera financiare.

Sipas afatit të maturimit, 29.5 përqind e depozitave janë depozita të transferueshme, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara. Në kuadër të këtyre depozitave dominojnë depozitat me afat maturimi deri në një vit, të cilat përbëjnë 84.1 përqind të gjithsej depozitave të kursimit dhe të afatizuara.

Depozitat me afat maturimi një deri në dy vite përbëjnë 7.7 përqind të depozitave të kursimit dhe të afatizuara, ndërsa 8.2 përqind e këtyre depozitave kanë maturitet më të gjatë se dy vite (Figura 14). Si rezultat i rritjes së besimit të publikut në sistemin bankar si dhe rritjes së vazhdueshme të normave të interesit në depozita, vërehet një lëvizje e vazhdueshme e depozitave nga ato të transferueshme drejt depozitave të kursimit dhe të afatizuara. Për më tepër, në vitin 2009 është vërejtur një rritje e konsiderueshme e depozitave me afat maturimi mbi dy vite, të cilat arritën vlerën prej 101.3 milion euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 34.2 përqind. Pjesa më e madhe e depozitave të sektorit bankar të Kosovës janë në valutën euro (93.6 përqind e gjithsej depozitave).

Figura 14. Struktura e depozitave




Burimi: BQK (2010)

3.3.2.2 Normat e interesit

Dallimi ndërmjet normave të interesit në depozita dhe kredi në fund të vitit 2009 ishte 10.1 pp, që paraqet një rritje prej vetëm 0.7pp krahasuar me vitin 2008, kur ky dallim kishte rënie më të theksuar.⁶ Kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes së lehtë në normat e interesit në kredi (0.3pp) dhe rënies së normave të interesit në depozita (0.4pp). Një ndër faktorët që ndikoi në rritjen e kujdesit të bankave në raport me normat e ofruara të interesit, ishte ngadalësimi i kredihënies gjatë vitit 2009 (Figura 15).

Figura 15. Normat e interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

Shënim: Ndryshim metodologjik nga viti 2008.


⁶ Normat e interesit në kredi dhe depozita janë mesatare të ponderuara të produkteve specifike.

Gjatë vitit 2009, normat e interesit në kredi për ndërmarrje vazhduan të jenë më të larta se për ekonomi familjare, ndërsa e kundërta qëndron për normat e interesit në depozita ku ndërmarrjet përfitojnë norma më të larta të interesit. Një përcaktues tjetër i normës së interesit është afati i maturimit. Për shembull, për kreditë e ndërmarrjeve dallimi në mes të normës së interesit për kredi deri në një vit dhe atyre mbi një vit është 5.19pp. Përderisa norma e ofruar e interesit për depozitat e ekonomive familjare me afat maturimi deri në një vit është për 1.21pp më e ulët se sa e atyre me afat maturimi mbi dy vite.

3.3.2.3 Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar i Kosovës mbylli vitin 2009 me një profit neto prej 29.6 milion euro. Profiti i realizuar ishte për 30.5 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2008, që tregon për një performancë më të dobët të sektorit bankar. Zvogëlimi i profitit është rezultat i ngadalësimit të rritjes së të hyrave të bankave komerciale, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit kredihënës, përderisa shpenzimet ndoqën një trend më të shpejtë të rritjes krahasuar me të hyrat. Zvogëlimi i profitit neto shkaktoi rënie e treguesve të profitabilitetit të sektorit bankar, siç janë kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Asset: ROAA) dhe kthimi mesatar në kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE), (Figura 16). ROAA e sektorit bankar në vitin 2009 zbriti në nivelin prej 1.4 përqind, nga 2.4 përqind, sa ishte në vitin 2008. Një rënie po aq të theksuar shënoi edhe ROAE, duke rënë në nivelin prej 13 përqind në vitin 2009 (24.7 përqind në 2008).

Figura 16. Treguesit e performancës, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

Të hyrat e sektorit bankar gjatë vitit 2009 ndoqën një trend dukshëm më të ngadalshëm të rritjes krahasuar me vitet paraprake. Në vitin 2009, sektori bankar realizoi të hyra në vlerë prej 201.5 milion euro, që është vetëm 3.3 përqind më e lartë se sa të hyrat në vitin 2008 (rritja vjetore në vitin 2008 ishte 24.0 përqind). Faktori kryesor që ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së të hyrave të sektorit bankar është ngadalësimi i kredihënies nga ky sektor që shkaktoi ngadalësimin e rritjes së të hyrave nga interesi në kredi. Të hyrat nga interesi në kredi në vitin 2009 shënuan një rritje vjetore prej 13.9 përqind, që është dukshëm më e ulët se sa rritja vjetore prej 36.3 përqind që ishte realizuar në vitin 2008. Faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së të hyrave të sektorit

bankar është rënia e normës interesit EURIBOR në tregun ndërbankar evropian, që shkaktoi rënie të theksuar të të hyrave nga plasmanët në bankat komerciale jashtë vendit. Këto të hyra në vitin 2009 ishin vetëm 2.8 milion euro krahasuar me 12.0 milion euro në vitin 2008. Struktura e të hyrave të sektorit bankar vazhdon të jetë e ngjashme me vitet paraprake, ku të hyrat nga interesi përfaqësojnë burimin kryesor të të hyrave të sektorit bankar, duke përfaqësuar 81 përqind të gjithsej të hyrave.

Tabela 7. Bilanci i suksesit, në milionë euro

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
Të hyrat				
Të hyrat nga interesi	88.8	117.9	155.7	163.2
Të hyrat nga jointerеси	25.2	39.5	39.3	38.2
Gjithsej të hyra	114.0	157.3	195.0	201.5
Shpenzimet				
Shpenzime e interesit	19.9	26.0	37.3	51.6
Shpen. tjera përveç të int.	19.6	19.9	21.9	32.6
Shpen. e përgj. dhe admin.	54.8	69.7	86.0	87.0
Gjithsej shpenzimet	94	115.6	145	171.3
Të hyrat neto				
Të hyrat operuese neto	25.5	41.7	49.0	29.6
Të hyrat neto para tatimit	26.6	41.3	47.6	28.9
Provizionet për tatim	6.4	7.9	11.2	3.6
Neto fitimi / humbja brenda periudhës	20.2	33.5	36.4	25.3


Burimi: BQK (2010)

Niveli i shpenzimeve të sektorit bankar në vitin 2009 ishte për 17.7 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2008, duke arritur vlerën prej 171.2 milionë euro. Edhe te shpenzimet vërehet një normë më e ulët e rritjes krahasuar me vitin 2008, kur shpenzimet u rritën me një normë vjetore prej 26.3 përqind. Ky ngadalësim kryesisht i atribuohet shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, të cilat në vitin 2009 shënuan një rritje vjetore prej vetëm 1.2 përqind, krahasuar me rritjen prej 23.4 përqind në vitin 2008. Ky është rezultat i masave të ndërmarra nga bankat komerciale për të zvogëluar shpenzimet operacionale. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të sektorit bankar, duke përbërë 50.6 përqind të gjithsej shpenzimeve, mirëpo pjesëmarrja e tyre në vitin 2009 ishte për 8.3pp më e ulët sesa në vitin e kaluar. Një rritje e theksuar vërehet te shpenzimet për provizionet mbi kreditë që bëjnë pjesë në kuadër të shpenzimeve për jointerеси, të cilat në vitin 2009 arritën vlerën prej 25.7 milion euro, apo një rritje vjetore prej 51.3 përqind.

Ngritja e provizioneve për kreditë u shkaktua nga rritja e kredive joperformuese (angl. Non-performing Loans: NPL) gjatë vitit 2009, pjesëmarrja e të cilave në gjithsej kreditë arriti në 4.3 përqind (3.3 përqind në vitin 2008). Rritja e NPL-ve ndodhi kryesisht gjatë gjysmës së parë të vitit, ndërsa gjatë gjysmës së dytë të vitit gjendja në cilësinë e portofolit kreditor të sektorit bankar ishte kryesisht stabile. Sidoqoftë, niveli aktual i kredive joperformuese të sektorit bankar është mjaft mirë i mbuluar me provizione, të cilat mbulojnë rreth 140 përqind të vlerës së kredive jo-performuese (Figura 17). Për më tepër, rezultatet e 'stress testit' (me të dhënat e shtatorit 2009) sugjerojnë që sektori bankar është në gjendje të mbajë treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR) mbi nivelin prej 12 përqind edhe në qoftë se NPL-të do të rriteshin për 150 përqind. Sektori bankar i Kosovës është mjaft mirë i kapitalizuar, me një CAR prej 18 përqind, që tejkalon

nivelin minimal prej 12 përqind të përcaktuar nga Banka Qendrore, çka tregon për një nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë së sektorit.

Figura 17. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria e tyre me provizione, në përqindje



Burimi: BQK (2010)

Rritja më e shpejtë e depozitave në krahasim me rritjen e kredive gjatë vitit 2009, ndikoi në rritjen e likuiditetit të bankave. Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në vitin 2009 ishte 74 përqind, nivel ky më i ulët se sa niveli prej 80 përqind i rekomanduar nga Banka Qendrore. Si rezultat i ngadalësimit të rritjes së kredisë, pjesëmarrja e asetëve likuide në gjithsej asetet e sektorit bankar arriti në 37 përqind, nga 30 përqind sa ishte në vitin 2008. Niveli i mirë i likuiditetit të sektorit bankar konfirmohet edhe nga rezultatet e 'stress-testit' (me të dhënat e shtatorit 2009). Bazuar në këto rezultate, mund të konstatohet se sistemi bankar është në gjendje për të përballuar norma të ndryshme të tërheqjes së depozitave pa pasur nevojë për fonde likuide shtesë.

Zhvillimet që e karakterizuan sektorin bankar gjatë vitit 2009 kishin implikime edhe për nivelin e efikasitetit të këtij sektori. Në këtë kontekst, raporti ndërmjet të hyrave të realizuara nga sektori bankar dhe gjithsej asetëve në vitin 2009 zbriti në 9.1 përqind, nga 10.8 përqind në vitin 2008. Kjo sugjeron se bankat komerciale ishin më pak efektive për të gjeneruar të hyra nga shfrytëzimi i asetëve të tyre. Në anën tjetër, bankat u treguan më efektive në shfrytëzimin e resurseve humane, ku vlera mesatare e asetëve të menaxhuara nga një punëtor në vitin 2009 ishte 637 mijë euro, krahasuar me 501 mijë euro në vitin 2008. Këtij dallimi i ka kontribuar shkurtimi i vendeve të punës në bankat komerciale gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009.

3.3.3 Kompanitë e sigurimit

Sektori i kompanive të sigurimeve vazhdoi të jetë stabil duke shënuar një rritje të moderuar në krahasim me vitin e kaluar. Në fund të vitit 2009, numri i kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë ishte 11, prej të cilave 10 ushtrojnë veprimtarinë në sigurimet jo-jetë, ndërsa një kompani ushtron veprimtarinë vetëm me sigurimet e jetës. Sa i përket strukturës së pronësisë, 8 prej tyre janë në pronësi të huaj, ndërsa 3 janë në pronësi vendore. Asetet e sektorit të sigurimeve (sigurimi jetësor dhe jo jetësor) në vitin 2009 arritën vlerën prej 88.1 milionë euro, një rritje rreth 5 përqind krahasuar me vitin 2008. Struktura e asetëve dominohet nga depozitat të cilat përbëjnë 63.7 përqind të gjithsej

aseteve. Në anën e detyrimeve, kapitali aksionar paraqet kategorinë që ka peshën kryesore (45.5 përqind e totalit të detyrimeve).

Gjatë vitit 2009, numri i policave të shitura arriti në 511 mijë, që paraqet një rritje prej 7.4 përqind krahasuar me vitin 2008. Rritje shënoi edhe vlera e primeve të pranuara, e cila arriti në 67.7 milionë euro, që është për 20.2 përqind më e lartë se sa në vitin 2008. Veprimtaria e kompanive të sigurimeve kryesisht është e bazuar në ofrimin e policave të përgjegjësishë ndaj palës së tretë (PPT), të cilat gjenerojnë pjesën më të madhe të primeve të (53.7 përqind të gjithsej primeve të pranuara). Gjatë vitit 2009, vlera e primeve nga kjo kategori arriti në 35.4 milionë euro, që paraqet rritje prej 2.2 përqind krahasuar me vitin paraprak. Primet nga shitja e policave për sigurimet vullnetare vazhdojnë të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej primet e pranuara (27.6 përqind të gjithsej primeve). Vlera e primeve të pranuara nga ky lloj i sigurimeve arriti në 17.1 milionë euro, që paraqet një rritje prej 90 përqind krahasuar me vitin 2008, ndërsa kategoria e policave kufitare shënoi një rritje vjetore rreth 15 përqind, duke arritur vlerën prej 11.9 milionë euro (18 përqind të gjithsej primeve).


Në vitin 2009, shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve ishte 18.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.5 përqind. Edhe pse shuma e dëmeve të paguara shënoi rritje, raporti në mes të dëmeve të paguara dhe primeve të pranuara shënoi rënie nga 31.3 përqind, sa ishte në fund të vitit 2008, në 27.8 përqind në fund të vitit 2009 si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së primeve të pranuara. Rreth 73 përqind e vlerës së dëmeve të paguara përbëhet nga kompensimi për mbajtësit e policave PPT, ndërsa rritje kanë shënuar kërkesat për dëmet e paguara ndaj mbajtëseve të policave tjera (jo PPT), që në vitin 2009 përfaqësuan 21 përqind të gjithsej dëmeve të paguara (11 përqind në vitin 2008).

3.3.4 Fondet pensionale

Sistemi pensional i Kosovës është i bazuar në tri shtylla. Pensioni bazë përfaqëson shtyllën e parë dhe menaxhohet nga Qeveria dhe si përfitues të këtij pensioni janë të gjithë personat mbi moshën 65 vjeçare. Kontributet e obligueshme që menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) paraqesin shtyllën e dytë. Ndërkaq, shtylla e tretë, e cila përfaqëson pensionet vullnetare, menaxhohet nga TKPK dhe Fondi Slloven-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Vlera e asetëve të sistemit pensional të Kosovës në vitin 2009 ishte ekuivalente me rreth 10 përqind të PBB-së. Asetet të cilat janë nën menaxhimin e TKPK-së në vitin 2009 arritën vlerën prej 376 milion euro, ndërsa FSKP kishte në menaxhim rreth 4.7 milion euro. Asetet e FSKP-së janë të investuara kryesisht në fletëobligacione (84.0 përqind), si dhe në depozita bankare (15.0 përqind), ndërsa pjesa tjetër prej 1.0 përqind është e mbajtur në formë të parasë së gatshme.

Performanca e TKPK-së gjatë vitit 2009 ishte relativisht e mirë krahasuar me vitin 2008, kur çmimi i aksionit të TKPK-së u zvogëluar nga 1.22 euro në 0.86 euro për aksion (çmimi bazë gjatë kontributit llogaritet 1.0 euro për aksion). Gjatë vitit 2009 kthimi në mjetet e investuara ishte 14.1 përqind (dhjetor 2008-dhjetor 2009). Këto zhvillime në vlerën e aksionit të TKPK-së janë në linjë me zhvillimet në tregjet ndërkombëtare (Figura 18). Përmirësimi i performancës së tregjeve të kapitalit në nivel ndërkombëtar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, u reflektua edhe në investimet e TKPK-së të cilat shënuan norma pozitive të kthimit. Vlera e aksionit të TKPK-së në fund të vitit 2009 arriti në rreth 1.0 euro.


Figura 18. Çmimi i aksionit tëTKPK-së dhe indeksi DJI dhe FTSE



Burimi: Trusti (2010), DJI dhe FTSE (2010)

Siç mund të vërehet në figurën 19, investimet e TKPK-së janë më shumë të koncentruara në fonde të përbashkëta (mutual funds), të cilat përbëjnë 38.0 përqind të gjithë investimeve. Ndërsa, 23.7 përqind e gjithë mjeteve të TKPK-së janë investuar në depozita dhe para të gatshme. Në fletobligacione janë investuar 14.2 përqind të mjeteve, ndërsa pjesa e mbetur e investimeve i takojnë kategorive tjera. TKPK mbanë një strukturë të investimeve kryesisht të ngjashme me fondet pensionale të disa vendeve të BE-së (Figura 19).

Figura 19. Struktura e investimeve e fondeve pensionale



Burimi: OECD (2010) dhe Trusti (2010)

3.3.5 Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar

Në fund të vitit 2009 numri i institucioneve mikrofinanciare (IMF) që operojnë në Kosovë ishte 19 apo 3 më shumë në krahasim me vitin 2008. Aktiviteti i IMF-ve vazhdon të përqendrohet në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Numri i kredive

të lëshuara nga këto institucione ka arritur në 57,500, që paraqet një rritje vjetore prej 14.6 përqind. Në fund të vitit 2009, vlera e portfolios së kredive të IMF-ve arriti në 109 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 16 përqind. Pjesëmarrja e kredive të IMF-ve në totalin e kredive të sektorit financiar u rritë nga 7.4 përqind, sa ishte në vitin 2008 në 7.9 përqind në vitin 2009.

Ndihmësit financiar në Kosovë përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferimin e parave (ATP). Gjatë vitit 2009, përmes ndihmësve financiarë u transferuan 226.5 milionë euro. Në vitin 2009, shumën e transfereve të dërguara përmes ATP-ve në Kosovë ishte 226.5 milionë euro, ose 2.7 përqind më pak se në fund të vitit 2008. Nga kjo shumë 90 përqind ishin transfere hyrëse në Kosovë. Tranferet përmes ATP-ve përbëjnë 4.4 përqind të totalit të transfereve ndërkombëtare, kurse pjesa më e madhe e transfereve ndërkombëtare vazhdon të kryhet përmes bankave komerciale (rreth 70 përqind e gjithsej transfereve).


3.4. Sektori i jashtëm

Gjatë vitit 2009, në bilancin e pagesave të Kosovës është regjistruar rritje vjetore e deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 7.2 përqind, duke arritur kështu në afër 16 përqind të PBB-së (përfshirë asistencën e jashtme), që paraqet një rritje prej 1pp krahasuar me vitin 2008. Duke përjashtuar asistencën e jashtme, deficitin e llogarisë rrjedhëse është afër 24 përqind e PBB-së. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse rezultoi nga rënia e dërgesave të emigrantëve dhe të ardhurave, ndërsa deficitin tregtar, si komponentë kryesore e llogarisë rrjedhëse, shënoi rritje modeste. Llogaria kapitale dhe financiare, përkundër rënies së IHD-ve, shënoi rritje për 15.3 përqind, rritje kjo e cila i atribuohet zvogëlimit të aseteve rezervë. Gjatë vitit 2009, Kosova pagoi shumë më prej 132 milion euro të borxhit të jashtëm ku një pjesë përfshinë faljen e borxhit nga qeveria e SHBA-së në vlerë prej 90 milion euro.

3.4.1 Llogaria rrjedhëse

Llogaria rrjedhëse gjatë vitit 2009 u karakterizua me deficit prej 646.0 milionë euro. Deficitin e llogarisë rrjedhëse vazhdon të jetë rezultat i bilancit tregtar negativ në mallra, ndërsa bilanci i shërbimeve dhe të ardhurat ishte në nivel pozitiv. Me gjithë zvogëlimin, bilanci pozitiv i transeferëve rrjedhëse vazhdon të ketë efekt në zvogëlimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse (Figura 20).

Figura 20. Bilanci i llogarisë rrjedhëse



Burimi : BQK (2010)

3.4.1.1 Mallrat dhe shërbimet

Mbështetja e lartë e ekonomisë në importin e mallrave dhe, në anën tjetër, niveli mjaft i ulët i eksporteve, ka bërë që Kosova vazhdimisht të karakterizohet me deficit të lartë tregtar. Si pasojë e ndikimit të krizës globale në vitin 2009, eksportet dhe importet shënuan rënie, ndërsa deficitin tregtar shënoi një rritje vjetore modeste (Tabela 8). Deficitin tregtar si përqindje e PBB-së arriti në 44.5 përqind (45.0 përqind në vitin 2008) që paraqet rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak si rezultat i rënies së lehtë të importeve. Eksportet e Kosovës në vitin 2009 arritën vlerën 162.6 milion euro, që paraqet një rënie nominale prej 18.1 përqind, që rezultoi nga zvogëlimi i kërkesës dhe nivelit të çmimeve në nivel ndërkombëtar dhe problemeve në zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-s me Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën.

Tabela 8. Bilanci tregtar i Kosovës, në milionë euro

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
Eksportet	110.8	165.1	198.5	162.6
Importet	1305.9	1576.2	1928.2	1898.7
Bilanci tregtar	-1,195.1	-1,411.1	-1,729.8	-1,736.1
Bilanci tregtar (% e PBB-së)	-38.3	-41.4	-45	-44.5
Raporti eksport/import (%)	8.5	10.5	10.3	8.6

Burimi: BQK (2010)


Importet gjatë vitit 2009 arritën vlerën prej 1,898.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore nominale prej 1.6 përqind. Ndërsa, në terma real, importet shënuan një rritje vjetore prej 3.0 përqind, gjë që tregon efektin e rënies së çmimeve gjatë vitit 2009. Sidoqoftë, kjo rritje paraqet një ngadalësim të theksuar të rritjes së importeve krahasuar me vitin paraprak, gjatë të cilit norma reale e rritjes ishte 17.3 përqind. Ngadalësimi i rritjes së importeve pasqyron rënien e kërkesës së brendshme si pasojë e reflektimit të efekteve të krizës globale. Mbulesa e eksporteve me importe vazhdon të jetë në nivel mjaftë të ulët. Në vitin 2009, ky tregues shënoi rënie prej 1.7pp krahasuar me vitin paraprak, duke arritur nivelin prej 8.6 përqind (Tabela 8). Kjo si pasojë e zvogëlimit më të theksuar të eksporteve në krahasim me importet gjatë vitit 2009.

Struktura e eksporteve në vitin 2009 u dominua nga metalet bazë të cilat kishin një pjesëmarrje prej 58.5 përqind në gjithsej eksportet. Sidoqoftë, vlera e eksportit të metaleve bazë shënoi një rënie vjetore prej 33.8 përqind duke zvogëluar pjesëmarrjen në gjithsej eksportet për 12.0pp. Kjo ndodhi për shkak të rënies së kërkesës dhe çmimeve të metaleve në bursat ndërkombëtare. Eksportet e produkteve minerale në vitin 2009 arritën në 24.1 milionë euro, me një pjesëmarrje prej 14.8 përqind në gjithsej eksportet. Kategoria që dyfishoi pjesëmarrjen në gjithsej eksportet janë produktet e plastikës dhe gomës duke arritur në 6.4 përqind të gjithsej eksporteve apo 10.3 milionë euro. Produktet e ushqimit dhe pijeve kishin një pjesëmarrje të ngjashme me periudhën paraprake (5.3 përqind), ndërsa vlera e këtyre eksporteve shënoi një rënie vjetore prej 18.2 përqind.

Struktura e importeve gjatë vitit 2009 ishte relativisht e ngjashme me vitin paraprak, me përjashtim të rënies së konsiderueshme të importit të produkteve minerale, posaçërisht karburanteve, që shënuan një rënie vjetore prej 17.8 përqind. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e këtyre produkteve në gjithsej importet për vitin 2009 u zvogëlua në 16.4, nga 19.6 përqind në vitin 2008. Në vitin 2009, makineritë dhe pajisjet ishin kategoria e dytë më e madhe për nga pjesëmarrja në strukturën e importeve, të përfaqësuara me 13.7 përqind. Importi i produkteve ushqimore gjatë vitit 2009 shënoi rënie për 13.0 përqind krahasuar me vitin 2008, duke arritur shumën 227.9 milion euro apo 12.0 përqind e gjithsej importeve. Dy kategori tjera me peshë më të vogël në strukturën e importeve në vitin 2009 janë mjetet e transportit dhe metalet bazë me pjesëmarrje prej 8.9 përkatësisht 7.8 përqind.

Figura 21 paraqet klasifikimin e produkteve të importuara sipas përdorimit final të tyre apo sipas Kategorive Kryesore Ekonomike (Broad Economic Categories: BEC). Kategoria më e rëndësishme sipas këtij klasifikimi përbëhet nga produktet e ndërmjetme të cilat kanë një pjesëmarrje prej 40.7 përqind në gjithsej importet. Megjithatë, si rezultat i trendit rritës të mallrave kapitale, pjesëmarrja e mallrave të ndërmjetme vazhdimisht ka shënuar rënie.

Figura 21. Importet sipas BEC




Burimi: BQK (2010)

Kategoria e dytë për nga rëndësia, sipas klasifikimit BEC, përbëhet nga mallrat e konsumit me një pjesëmarrje prej 31.8 përqind në gjithsej importet, raport ky i ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Ngritje të pjesëmarrjes shënuan mallrat kapitale, të cilat në vitin 2009 përfaqësuan 12.4 përqind të gjithsej importeve (10.1 përqind në vitin 2008). Trendi rritës i importit të mallrave kapitale gjatë viteve të fundit është inkurajues për ekonominë e vendit, pasi që importi i këtyre mallrave është indikacion i ngritjes së nivelit të prodhimit në vend. Rritja e importit të mallrave kapitale, deri në një masë, mund të ketë qenë rezultat i rritjes së konsiderueshme të investimeve kapitale nga qeveria në vitin 2009.

Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës mbeten vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendet anëtare të CEFTA-s, me të cilat Kosova në vitin 2009 realizoi 74.4 përqind të tregtisë. Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së gjatë vitit 2009 shënuan një rënie prej 24.7 përqind, e cila është më e lartë sesa rënia e eksporteve drejt vendeve të CEFTA-s, gjë që reflekton ndikimin më të madh të krizës ekonomike në vendet e BE-së. Sidoqoftë, pjesëmarrja e eksporteve drejt këtyre vendeve në gjithsej eksportet e Kosovës arriti në 41.5 përqind, që paraqet një rritje prej 2.8 pp krahasuar me vitin 2008. Në kuadër të vendeve të BE-së, Italia paraqet pikësypnimin kryesor të eksporteve të Kosovës. Eksportet drejt këtij vendi përfaqësojnë 28.3 përqind të gjithsej eksporteve të Kosovës dhe kryesisht përbëhen nga metalet bazë. Në qershor të vitit 2009, Komisioni Evropian u dakordua që të zgjasë dhe për pesë vite statusin e vendeve të favorizuara në tregti me BE-në për shtatë shtete të Evropës Juglindore, ndër të cilat bënë pjesë edhe Kosova. Kjo i kontribuon në masë të madhe zhvillimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve tregtare midis Kosovës dhe vendeve të BE-së, si dhe krijon lehtësi për prodhuesit Kosovarë të depërtojnë në tregjet evropiane.

Eksportet e destinuar për vendet e CEFTA-s kishin pjesëmarrje të ngjashme më atë të vitit 2008 (32.0 përqind), ndërsa vlera e tyre shënoi një rënie vjetore prej 15.3 përqind. Në kuadër të këtyre vendeve, Kosova më së shumti ka eksportuar në Shqipëri dhe në Maqedoni (15.3 përkatësisht 10.6 përqind të gjithsej eksporteve). Gjatë vitit 2009, eksportet drejt Shqipërisë u rritën për 18.0 përqind, përderisa eksportet drejt Maqedonisë u zvogëluan për 13.7 përqind.

Figura 22. Struktura e tregtisë sipas partnerëve tregtarë, në përqindje



Burimi: BQK (2010)


Si pasojë e embargos që Serbia dhe Bosnja e Hercegovina po aplikojnë ndaj produkteve të Kosovës, eksportet në drejtim të këtyre dy vendeve po ndjekin një trend rënës. Në vitin 2009, Kosova eksportoi në Serbi mallra në vlerë prej 3.5 milionë euro (9.9 milionë euro në 2008 dhe 19.3 milionë euro në 2007), ndërsa eksportet drejt Bosnje dhe Hercegovinë ishin 1.2 milionë euro (5.9 milionë euro në 2008 dhe 4.8 milionë euro në 2008).

Vendet e BE-së dhe CEFTA-s ishin partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës edhe sa i përket importeve, me një pjesëmarrje prej 38.7 përkatësisht 36.0 përqind në gjithsej importet. Pjesëmarrjen më të madhe në importet nga vendet e BE-së kanë mallrat nga Gjermania duke arritur vlerën prej 235.4 milionë euro apo 12.4 përqind e gjithsej importeve gjatë vitit 2009. Prej vendeve të CEFTA-s, Kosova më së shumti importoi prej Maqedonisë me vlerë prej 290.7 milionë euro (15.3 përqind e gjithsej importeve) dhe Serbisë me vlerë prej 209.1 milionë euro (11.0 përqind e gjithsej importeve), ndërsa nga Shqipëria dhe Mali i Zi importet arritën në 58.8 përkatësisht 13.1 milion euro.

Përkundër zhvlerësimit të normës reale efektive të këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate: REER) prej mesatarisht 4.2 përqind krahasuar me vitin 2008 (Figura 23), eksportet e Kosovës nuk shfaqën ndonjë performancë më të mirë dhe nuk reflektuan konkurrueshmëri më të lartë kundrejt partnerëve tregtarë. REER është zhvlerësuar si ndaj vendeve të eurozonës (3.4 përqind) ashtu edhe ndaj vendeve të CEFTA-s (4.1 përqind), mirëpo eksportet e Kosovës drejt këtyre vendeve shënuan rënie si rezultat i rënies së kërkesës globale dhe moszbatimit të marrëveshjes CEFTA. Zhvlerësimi i REER gjatë vitit 2009 kryesisht është nxitur nga rënia e çmimeve në Kosovë më shumë sesa në vendet tjera, kurse kursi i këmbimit me valutat e partnereve tregtar kishte ndikim minimal.

Një kategori e rëndësishme në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave janë edhe shërbimet, të cilat prej vitit 2006 deri në vitin 2009 u karakterizuan me bilanc pozitiv. Për vitin 2009, të hyrat nga shërbimet arritën në 135.3 milion euro (72.1 milion euro në 2008). Në vitin 2009, trendi i rritjes së të hyrave nga shërbimet u përsheptua dukshëm, duke shënuar rritje vjetore prej 21.8 përqind dhe arriti vlerën në 434.5 milion, ndërsa pagesat për shërbime u rritën me 5.1 përqind, duke arritur vlerën e 299.2 milion euro.

Figura 23. Indeksi REER bazuar në CPI



Burimi: BQK (2010)

Ndikim pozitiv në të hyrat nga shërbimet më së shumti kanë pasur shërbimet e udhëtimit (të dominuara nga udhëtimet personale) me 56.5pp, bilanci i të cilave në vitin 2009 pothuajse u dyfishua dhe arriti vlerën prej 126.4 milionë euro. Bilanc pozitiv, po ashtu, kishin shërbimet qeveritare (shërbimet e ofruara për ambasada dhe pranisë ushtarake të NATO-s), të cilat në vitin 2009 shënuan rritje vjetore prej 12.9 përqind dhe arritën në 107.4 milion euro.

Të hyrat nga shërbimet e komunikimit gjatë vitit 2009 shënuan rënie për 14.8 përqind, ndërsa vlera e tyre në vitin 2009 arriti në 49.7 milion euro. Pagesat për shërbimet e komunikimit arritën në 13.9 milion eurosh, duke rezultuar në një bilanc prej 35.9 milion euro. Kategoritë e shërbimeve të cilat në vitin 2009 kishin bilanc negativ janë shërbimet tjera biznesore (-79.3 milionë euro), shërbimet e transportit (-59.6 milionë euro) dhe shërbimet e sigurimit (-5.8 milionë euro). Kategoria që shënoi rritje të konsiderueshme në kuadër të shërbimeve, ishin të hyrat nga shërbimet e ndërtimit, të cilat arritën në 15.7 milion euro (nga 6.6 milionë euro në 2008). Pagesat për këto shërbime arritën në 5.0 milion euro që paraqet rënie krahasuar me vitin paraprak (5.7 milionë euro në vitin 2008).

3.4.1.2 Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse


Kategoria e të ardhurave përbëhet nga kompensimi i punëtorëve dhe të ardhurat nga investimet e realizuara jashtë ekonomisë. Në vitin 2009 kategoria e të ardhurave kishte bilanc pozitiv prej 75.1 milionë euro, si rezultat i të hyrave (pranimeve) me vlerë prej 159.9 milionë euro dhe pagesave në vlerë prej 84.9 milionë euro. Sidoqoftë, bilanci i të ardhurave në vitin 2009 shënoi një rënie prej 51.7 përqind, krahasuar me vitin paraprak, që rezultoi nga zvogëlimi i të hyrave të kësaj kategorie për 28.8 përqind dhe rritjes së pagesave për 22.7 përqind. Zvogëlimi i gjithsej të ardhurave ishte pasojë e zvogëlimit të të ardhurave nga depozitat e qeverisë dhe investimet e TKPK-së jashtë vendit. Të ardhurat nga këto investime gjatë vitit 2009 shënuan vlerën prej 12.5 milionë euro, ndërsa në vitin e kaluar vlera e të ardhurave nga këto investime ishte 57.3 milionë euro. Në anën tjetër, pagesat në kuadër të të hyrave nga investimet arritën në 83.9 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 22.7 përqind, që kryesisht ishin në emër të pagesës së dividendës nga

kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë. Të ardhurat nga investimet tjera ishin 10.3 milionë euro, që po ashtu paraqet një rënie të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar kur këto investime gjeneruan të ardhura në vlerë prej 54.8 milionë euro. Prej tyre, 2.2 milionë janë të ardhura nga depozitat e investuara të BQK-së, ndërsa 3.8 milionë euro janë të ardhura nga investimet e BQK-së në letra me vlerë.

Kompensimet e punëtorëve kanë pjesëmarrjen më të rëndësishme në llogarinë e të ardhurave. Prej tyre, pjesën më të madhe e përbëjnë të ardhurat e realizuara nga personeli lokal i punësuar në KFOR, kompensimi i punëtorëve Kosovarë në Afganistan dhe Irak si dhe transferet nga Serbia që financojnë strukturat paralele në Kosovë. Në vitin 2009, të ardhurat e përgjithshme nga kompensimet e punëtorëve shënuan një rënie vjetore prej 12.1 përqind, rënie kjo e cila kryesisht i adresohet zvogëlimit të stafit lokal në KFOR.

Një komponentë mjaft e rëndësishme e llogarisë rrjedhëse në bilancin e pagesave të Kosovës janë edhe transferet rrjedhëse, të cilat vazhdimisht janë karakterizuar me bilanc pozitiv, duke kontribuar kështu në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në vitin 2009, transferet rrjedhëse arritën në 833.5 milionë euro, që paraqet rënie për 0.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar (Figura 24). Kjo rënie kryesisht i atribuohet zvogëlimit të transfereve hyrëse të sektorëve tjerë (kryesisht dërgesat e emigrantëve) që përbëjnë 56.9 përqind të gjithëj transfereve rrjedhëse. Vlera neto e transfereve rrjedhëse të sektorëve tjerë në vitin 2009 ishte 473.9 milionë euro, që paraqet një rënie prej 11.5 përqind. Kontributin më të madh kishte rënia prej 5.5 përqind e dërgesave të emigrantëve kosovarë, si dhe rritja prej 16.7 përqind e dërgesave nga stafi ndërkombëtar në Kosovë. Rënia e dërgesave të emigrantëve gjatë vitit 2009 reflekton efektet e krizës ekonomike në vendet e zhvilluara, e cila shkaktoi rritje të nivelit të papunësisë duke i përfshirë edhe emigrantët nga Kosova (shih kutinë 1).

Figura 24. Transferet rrjedhëse, në milionë euro




Kategoria e dytë më e rëndësishme e transfereve rrjedhëse janë transferet e sektorit qeveritar (donatorët, EULEX-i dhe UNMIK-u), të cilat në vitin 2009 shënuan vlerën neto prej 359.6 milionë euro. Përkundër trendit rënës të këtyre transfereve në vitet e kaluara (2004-2008), në vitin 2009 kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 18.8 përqind.

Kutia 2. Papunësia në BE dhe dërgesat e emigrantëve në Kosovë

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, viti 2009 paraqet periudhën e vetme kur dërgesat e emigrantëve kosovarë shënuan rënie. Rënia e dërgesave të emigrantëve është rezultat i krizës ekonomike globale, e cila në masë të konsiderueshme goditi vendet e zhvilluara ku janë të koncentruar një numër i madh i emigrantëve nga Kosova. Efektet e krizës u manifestuan me shkurtime të theksuara të vendeve të punës, ku nuk mbetën pa u ndikuar edhe emigrantët kosovarë. Rrjedhimisht, vëllimi i dërgesave të emigrantëve në vitin 2009 u zvogëlua për 5.5 përqind duke shënuar rënie në 505.6 milion euro nga 535.4 milion euro, sa ishte në vitin 2008. Rënia dërgesave të emigrantëve ka implikimet negative për ekonominë e Kosovës, pasi që një numër i madh i familjeve në Kosovë financojnë konsumin.

Figura 25. Papunësia në vendet e BE-së dhe dërgesat e emigrantëve në Kosovë




Burimi: Eurostat (2010) dhe BQK (2010)

Në rastet kur ka rritje të papunësisë në vendet e zhvilluara, emigrantët paraqiten të jenë më të ekspozuar ndaj shkurtimeve të vendeve të punës. Për shembull, në tregun e punës në Zvicër, norma e papunësisë në mesin e emigrantëve është rreth 7.2 përqind, që është më e lartë sesa norma e përgjithshme e papunësisë prej 4.1 përqind në vitin 2009. Ngjashëm qëndron situata edhe në tregun e punës në Gjermani, ku shkalla e papunësisë në mesin e emigrantëve është dyfishi i normës së përgjithshme të papunësisë e cila për vitin 2009 ishte 7.6 përqind. Siç edhe është paraqitur në figurën 25, dërgesat e emigrantëve në Kosovë korrelojnë negativisht me papunësinë në BE (koeficienti i korrelacionit është -0.76).

3.4.2 Llogaria kapitale dhe financiare

Llogaria kapitale dhe financiare gjatë vitit 2009 u karakterizua me një nivel më të ulët të IHD-ve, investimeve portfolio dhe investimeve tjera. Sidoqoftë, bilanci i llogarisë kapitale dhe financiare gjatë këtij viti shënoi rritje si rezultat i zvogëlimit për 154.0 milion euro të aseteve rezervë. IHD-të neto, si komponentë kryesore e llogarisë kapitale dhe financiare, shënuan rënie prej 17.6 përqind gjatë vitit 2009 (Figura 26).

Figura 26. Llogaria financiare, neto




Burimi: BQK (2010)

Investimet nga bankat komerciale në instrumentet e tregjeve financiare ndikuan që investimet portfolio jashtë vendit të shënojnë rritje. Sidoqoftë, në vitin 2009 është shënuar rritje e konsiderueshme e hyrjes së kapitalit në formave tjera si rezultat i rritjes së vazhdueshme të kredive tregtare dhe linjave kreditore të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë.

3.4.2.1 Investimet e Huaja Direkte

Në vitin 2009 IHD-të shënuan një rënie vjetore prej 20.4 përqind. Vlera e IHD-ve në ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2009 ishte 291.5 milion (Figura 27), përdërisa IHD-të e rezidentëve kosovarë në vende tjera arritën një vlerë prej 10.6 milion euro (kryesisht për blerje të patundshmërive në Shqipëri). Rrjedhimisht, vlera neto e IHD-ve në vitin 2009 ishte 280.9 milion euro.

Figura 27. Investimet e huaja direkte në Kosovë dhe rritja ekonomike në eurozonë




Burimi: Eurostat (2010) dhe BQK (2010)

Rënia e IHD-ve gjatë vitit 2009 kryesisht është pasojë e krizës ekonomike globale, e cila ndikoi planet dhe kapacitetet investuese të investitorëve të huaj. Vendet e BE-së, të cilat janë një burim mjaft i rëndësishëm i IHD-ve për Kosovën, ishin ndër vendet të cilat u ndikuan në masën më të madhe nga kriza ekonomike. Përveç efekteve të krizës globale, moszbatimi i plotë i marrëveshjes për tregti të lirë CEFTA, po ashtu, mund të ketë pasur efekt dekurajues për investitorët e jashtëm. Kjo për arsye se shumë investitorë që investojnë në një vend të Ballkanit synojnë mbulimin e tërë tregut rajonal, duke pasur parasysh se madhësia e ekonomive të vendeve individuale të rajonit është relativisht e vogël. Në këtë kontekst, pengesat e paraqitura nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina për eksportet kosovare krijojnë vështirësi për qasje në tërë tregun rajonal.

Struktura e IHD-ve vazhdon të dominohet nga investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë 72.6 përqind të gjithëj IHD-ve (Figura 28). Investimet kapitale kanë shënuar rënie për 4.8 përqind dhe për vitin 2009 ishte 211.6 milion euro. Fitimet e pashpërndara përfaqësojnë kategorinë e dytë më të rëndësishme të IHD-ve (20.1 përqind të gjithëj IHD-ve), ndërsa në vitet paraprake kjo formë e investimeve kishte pjesëmarrjen më të ulët në strukturën e IHD-ve në Kosovë. Fitimet e pashpërndara në vitin 2009 shënuan një ngritje prej 4.5 përqind krahasuar me vitin 2008 dhe arritën në 58.7 milion euro. Në kuadër të IHD-ve, rënie të theksuar gjatë vitit 2009 kanë shënuar IHD-të në formën e 'investimeve tjera' të cilat kryesisht përbëhen nga kreditë ndërmjet ndërmarrjeve. Kjo rënie mund të reflektojë probleme të kompanive jashtë vendit si rezultat i krizës. Kjo kategori e investimeve u zvogëluar nga 88.0 milion euro në vitin 2008 në 21.2 milion euro në vitin 2009, duke përfaqësuar vetëm 7.3 përqind të gjithëj IHD-ve.

Figura 28. Struktura e IHD-ve sipas llojit të investimeve




Burimi: BQK (2010)

Sipas aktivitetit ekonomik, IHD-të vazhdojnë të dominohen nga investimet në shërbime financiare, megjithëse pjesëmarrja e kësaj kategorie të investimeve në gjithëj IHD-të shënoi një rënie prej 10pp që kryesisht është pasojë e zvogëlimit të profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe. Sektori i patundshmërive gjithashtu përfaqëson një pikësnyim të rëndësishëm për investitorët e huaj. IHD-të në patundshmëri përfaqësuan 15.0 përqind të gjithëj IHD-ve të pranuar në Kosovë gjatë vitit 2009. Rritje të konsiderueshme në pjesëmarrje shënuan IHD-të në sektorin e prodhimit dhe ndërtimitarisë. IHD-të në sektorin

e transportit dhe telekomunikimit vazhdojnë të kenë pjesëmarrje të konsiderueshme në strukturën e IHD-ve në Kosovë, për kundër rënies së theksuar gjatë vitit 2009 (Figura 29).


Figura 29. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK (2010)

Pjese më e madhe e IHD-ve në Kosovë ka për origjinë vendet e BE-së. Siç shihet në figurën 30, Gjermania përfaqëson burimin më të rëndësishëm të IHD-ve në Kosovë, e pasuar nga Sllovenia. Në vitin 2009, vërehet një rënie e theksuar e investimeve me prejardhje nga Austria, të cilat në vitin 2008 përfaqësonin pjesën më të madhe të investimeve të huaja në Kosovë. Vlera e IHD-ve nga Austria në vitin 2009 ishte 15.5 milion euro që përfaqëson 5 përqind të gjithsej IHD-ve.

Figura 30. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës




Burimi: BQK (2010)

3.4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë

Portfolio investimet gjatë vitit 2009 shënuan bilanc prej 56.6 milion euro (shih figurën 26). Këto investime kryesisht përbëhen nga investimet e bankave komerciale në instrumente të tregjeve financiare jashtë vendit. Si pasojë e turbulencave që u paraqitën në tregjet financiare ndërkombëtare, gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, bankat tërhoqën një pjesë të këtyre investimeve (27.2 milion euro), mirëpo me fillimin e rikuperimit të këtyre tregjeve, bankat përsëri investuan një pjesë të mjeteve të tyre (83.7 milion euro) në këto tregje.

Sa i përket investimeve tjera, bilanci i tyre ishte pozitiv me një vlerë prej 53.6 milion euro që në tërësi reflekton anën e detyrimeve. Në kuadër të detyrimeve nga investimet tjera, ky bilanc kryesisht rrjedhë nga kreditë tregtare të cilat arritën vlerën 103.0 milion euro që kompanitë vendase iu detyrohen kompanive jo rezidente. Ndërsa kreditimi i bankave në Kosovë nga bankat jo rezidente nëpërmjet linjave kreditore, si dhe kreditimi i sektorëve të tjerë dhe pagesa e një pjese tjetër nga Kosova të borxhit publik të trashëguar nga ish-Jugosllavia, ndikuan që ky bilanci i investimeve të tjera të arrijë në 53.6 milion euro.

Figura 31. Struktura e investimeve tjera



Burimi: BQK (2010)

Nga figura 31 vërehet se në vitin 2009 janë rritur kreditë tregtare të pranuar nga ndërmarrjet vendase prej ndërmarrjeve jorezidente. Kjo, deri në një masë, tregon për një performancë më të dobët të ndërmarrjeve gjatë vitit 2009, gjë që është në përputhje me zhvillimet e përgjithshme në ekonominë e vendit. Asetet rezervë të Kosovës në vitin 2009 u zvogëluan për 154.0 milion euro, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të depozitave të qeverisë me BQK-në. Pjesë e aseteve rezervë të Kosovës është edhe pozicioni rezervë i Kosovës në FMN në shumë prej rreth 15 milion euro.

4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare

BQK-ja ka autoritet rregullator dhe zbatues për të gjitha institucionet financiare në Kosovë, si dhe merr pjesë në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar, i cili sektor aktualisht mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare (institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jo bankare, zyrat e këmbimit të valutave dhe institucionet për transferin e parave).

Synimi i BQK –se është që të ketë një mbikëqyrje financiare dhe një proces rregullativ që është efikas, fleksibil dhe i cili promovon një sektor financiar konkurrues të bazuar në treg, duke zbatuar parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar.

Qasja e mbikëqyrjes së institucioneve financiare është zhvilluar në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare për mbikëqyrësit, duke filluar nga qasja e “bazuar në rregulla” drejt qasjes së “bazuar në rrezik”, e formuluar sipas Principeve Themelore të Basel-it dhe Shtyllës së 2-të të Basel-it II për bankat, dhe një regjim te aftësisë paguese të bazuar në rrezikun, e cila është duke u adoptuar në rrafshin ndërkombëtar për kompanitë e sigurimeve.

Qasja e bazuar në rrezikun ka për qëllim t’i mundësojë BQK–së që në mënyrë të përshtatshme të përdorë burimet e saj mbikëqyrëse në ato fusha me rrezikshmëri më të lartë, brenda institucioneve individuale financiare dhe sektorit financiar në përgjithësi. Mbikëqyrja bankare në bazë të rrezikut kryesisht përqendrohet në aftësinë e menagjmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun, kurse mbikëqyrja e sigurimeve në baze të rrezikut përqendrohet në kërkesat e aftësisë paguese dhe krijon kornizë të matur, e cila pasqyron në mënyrë më të saktë rreziqet e ndërmarra nga siguruesit. Qëllimi është krijimi i një mbikëqyrje sa më efektive dhe të balancuar mirë të sektorit të sigurimit, e cila do të sigurojë perspektivën e aftësisë paguese, si dhe çështjet e tjera me rendësi për mbikëqyrjen e sigurimeve të cilat mund të çojnë në liberalizimin e tarifave.

Në përputhje me legjislacionin që e drejton funksionin e saj të paraparë me kornizën ligjore BQK-ja ka vendosur standarde dhe kërkesa mbikëqyrëse të hollësishme në mënyrë që të arrijë një sektor financiar të rregulluar mirë. Gjithashtu, Ligji mbi Bankën Qendrore dhe rregulloret në fuqi i japin Bordit Drejtues të BQK-së autoritet për të adoptuar rregulla prudente të mbikëqyrjes, të cilat përcaktojnë limitet, direktivat operuese, procedurat dhe kërkesat raportuese për institucionet financiare, si dhe masat zbatuese në rast mospajtueshmërie me kërkesat ligjore ose për shkak të praktikave të pasigurta dhe jo të shëndosha.

Korniza ligjore prudente vazhdimisht rishikohet dhe freskohet, për të siguruar që vazhdon të jetë në linjë me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Kjo kornizë gjithashtu rishikohet për të siguruar ekuilibrin e duhur për krijimin e një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

4.1. Veprimtaria Rregullative e Sektorit Financiar

Si rregullator, BQK-ja merr pjesë në zbatimin kornizës ligjore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe rregulloreve përkatëse të UNMIK-ut. Korniza ligjore për drejtimin e këtyre veprimtarive në përputhje me standardet e BE-së është përshtatur në nivelin aktual të

zhvillimit të institucioneve financiare në Kosovë dhe, gjithashtu, është plotësuar me rregullat dhe vendimet e BQK-së.

Korniza e rregullave të mbikëqyrjes financiare është krijuar në fillim të themelimit të BQK-së. Që nga ajo kohë sektori financiar ka ndryshuar dhe, po ashtu, ka ndryshuar edhe qasja e BQK-së ndaj mbikëqyrjes së institucioneve financiare. Bazuar në faktorët e lartpërmendur dhe në rekomandimet e asistencës teknike, mbikëqyrja financiare e BQK-së ka punuar në mënyrë aktive për sa i përket rishikimit dhe plotësimit të kornizës së rregullave, dhe të themelimit të politikave dhe procedurave. Veç kësaj, për të udhëzuar industrinë financiare në implementimin e “praktikave më të mira”, BQK-ja ka publikuar “Letra Këshilluese” si referenca mbështetëse dhe plotësuese.

Gjatë vitit 2009 janë bërë aktivitete në plotësimin e politikave dhe procedurave të mbikëqyrjes financiare. Komiteti i Mbikëqyrjes Financiare të BQK-se gjatë vitit 2009 aprovoi letrat këshilluese të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, si dhe politikën e licencimit mbi shqyrtimin e historikut të personave dhe kompanive të caktuara që janë të interesuara të hyjnë në sistemin bankar dhe atë financiar.

i. Letra këshilluese mbi sistemin e kontrollit të brendshëm – përcakton udhëzimet për një ndihmesë shtesë për bankat dhe degët e bankave të huaja, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet tjera financiare jobankare për sistemin e kontrollit të brendshëm, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, në implementimin e aspekteve të caktuara të sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas kërkesave të Rregullores 1999/21 mbi Kontrollin e brendshëm dhe auditimin, si dhe Rregullën XXX të BQK-së mbi Sistemin e kontrollit të brendshëm. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm është komponent kyç i menaxhimit të institucioneve dhe bazë për operacione të shëndosha të institucioneve të mbuluara.

ii. Letra këshilluese për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit - përcakton udhëzimet dhe përfshinë principet thelbësore të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, të cilat mbikëqyrja e BQK-së i konsideron si esenciale. Po ashtu, përfaqëson standardet të cilat BQK do t'i përdorë në inspektimet në vend për të parë dhe vlerësuar se sa mirë bankat e menaxhojnë rrezikun e likuiditetit. Me këtë, BQK-ja pret që bankat, edhe në mënyrë të pavarur, t'i zhvillojnë apo t'i rishikojnë politikën, procedurat dhe sistemet e tyre për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në mënyrë që në thelb të jetë konform me këto standarde.

iii. Hulumtimin mbi historikun-principet e përshtatshmërisë dhe të duhura- Sipas kornizës ligjore për aplikacione të korporatave të caktuara, BQK-ja zhvillon hulumtime për historikun e personave të propozuar si aksionarë, zyrtarë të lartë ekzekutivë, drejtorë, dhe aksionarë kryesorë të bankave dhe institucioneve financiare, apo si menaxherë të degëve të bankave apo zyrave përfaqësuese, apo çfarëdo zyrtari tjetër që BQK-ja e konsideron të nevojshëm. Edhe gjatë vitit 2009, janë zhvilluar hulumtime për të vërtetuar se personat e propozuar kanë eksperiencën, kompetencën, integritetin, karakterin, aftësitë financiare dhe vullnetin për të drejtuar dhe/ose udhëhequr afarizmin e institucioneve financiare në mënyrë të sigurt, të shëndoshë dhe të ligjshme. BQK-ja mund të ndajë çfarëdo informacioni të pranuar me rregullatorët e tjerë të institucioneve financiare, si rezultat i hetimeve të saja.

Gjithashtu me përkrahje të asistencës teknike të Bankës Botërore u përgatiten projektligji për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive dhe projektligji për ndryshimin e Ligjit

mbi Pensionet në Kosovë. Të dyja ligjet janë në procedurë të rishikimit nga të gjithë palët e interesuara dhe janë të përfshira për aprovim në kornizën ligjore të vitit 2010.

4.2. Licencimi dhe struktura

Në përputhje me legjislacionin që rregullon funksionin e saj statusor, BQK-ja ka autoritetin për të vendosur standardet për licencimin e institucioneve financiare dhe për t'i refuzuar ato të cilat nuk i përmbushin këto standarde.

Vizioni i BQK-së për sektorin financiar është të jetë i qëndrueshëm dhe i drejtuar nga forcat e tregut dhe i cili vepron brenda rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikëqyrjes të harmonizuar në bazë të direktivave të BE-së/ KE-së.

Strategjia e BQK-së në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriteret etike dhe profesionale të duhura dhe të përshtatshme për aksionarë dhe drejtues, janë të aftë që të zhvillojnë një qasje në zhvillimin e matur të biznesit, për t'i mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar në këtë mënyrë në forcimin e sistemit financiar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Drejtoriati i Licencimit dhe Rregullimit ka për detyrë ta kompletojë kornizën ligjore për mbikëqyrje financiare, në përputhje me Direktivat e Bashkësisë Evropiane dhe praktikat e mira ndërkombëtare, ashtu siç janë të prezantuara në "Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive Bankare", të publikuara nga Banka për Rregullim Ndërkombëtar (Bank for International Settlements- BIS), si dhe Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive të Sigurimeve të publikuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors- IAIS). Në kryerjen e këtij misioni Drejtoriati është përgjegjës për licencimin dhe rregullimin e bankave komerciale, kompanive të sigurimit, ndërmjetësuesve, fondeve pensionale suplementare dhe të gjitha institucioneve tjera financiare jobankare.

Aktiviteti i licencimit të bankave nga BQK-ja, gjatë vitit 2009, kryesisht ka përfshirë hapjen e degëve dhe nëndegëve të reja. Gjatë vitit 2009, Bordi Drejtues i BQK-së me kërkesën e Fima Validus nga Kroacia, në pamundësi të financimit të aktivitetit në Kosovë, ka tërhequr licencën preliminare të FIMA bankë në Kosovë. Gjatë vitit 2009, sistemi bankar u zgjerua me një rrjet prej tetë bankave me 296 degë dhe nëndegë.

Kompanitë e Sigurimeve. Gjatë vitit 2009 kanë vazhduar ta ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregun e sigurimeve njëmbëdhjetë (11) kompani të sigurimeve, 10 kompani të sigurimit jo jetë dhe një kompani e sigurimit të jetës. BQK-ja gjatë vitit ka aprovuar ndryshimin e pronësisë së kompanisë së sigurimeve jo jetë Dukagjini dhe sigurim të jetës Dukagjini Life. Tani të dy kompanitë janë 100% në pronësi të kompanisë slovene Sava RE, nga Ljubljana. Po ashtu, gjatë vitit 2009 Bordi Drejtues i BQK-së ka aprovuar licencën e ndërmjetësuesve të sigurimeve ËVP, ENB GmbH për ndërmjetësim të sigurimeve, si dhe ANSIIA për trajtime dhe rregullime të dëmeve.

Institucionet mikrofinanciare. Në fund të vitit 2009 në Kosovë kanë operuar katërmëdhjetë (14) institucione mikrofinanciare dhe tetë (6) institucione jobankare financiare. Gjatë vitit 2009, me kërkesën e institucioneve u është tërhequr regjistrimi i ABU (Agro Business Unit) dhe Efikasiteti dhe Siguria si institucione financiare jobankare.

Zyrat e këmbimit të valutave dhe zyreat e transferit të parave. Gjatë vitit 2009, Bordi Drejtues i BQK-së aprovoi regjistrimin e dy zyrave të këmbimit për aktivitete të këmbimit të valutave, Edona në Pejë dhe Sara në Prishtinë. Në fund të vitit 2009, kanë

operuar në Kosovë 23 zyre të këmbimit të valutave dhe tri agjensione të transferit të parave.

Tabela 9. Aktiviteti i licencimit të bankave, 2005 – 2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Të licensuara më parë	7	7	8	8	9
Aprovime preliminare*	0	2	1	1	0
Revokim/Tërheqje e licencës	0	(1)	0	0	(1)
Totali	7	8	9	9	8

Burimi: BQK (2010)

Tabela 10. Aktiviteti i licencimit të kompanive të sigurimeve , 2005 – 2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Të licensuara më parë	8	8	9	9	11
Të licensuar	1	1	0	2	0
Refuzuar	(1)	0	0	0	0
Totali	8	9	9	11	11

Burimi: BQK (2010)

Tabela 11. Aktiviteti i licencimit të fondeve pensionale, 2005 – 2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Fondet pensionale të detyrueshme	1	1	1	1	1
Fondet pensionale suplementare	6	6	1	0	0
Ofruesit e pensioneve individuale	0	1	2	1	1
Totali	7	8	4	2	2

Burimi: BQK (2010)

Tabela 12. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare financiare, 2005 – 2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Të regjistruara më parë	18	19	18	19	22
Regjistruara	1	1	1	4	0
Tërheqja e regjistrimit	0	(2)	0	(1)	(2)
Totali	19	18	19	22	20

Burimi: BQK (2010)

Tabela 13. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit, 2005-2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Agjentët/ operatorët	658	784	347	479	528
Brokerët e sigurimit	2	2	2	2	4
Trajtuesit e dëmeve	2	2	2	3	4

Burimi: BQK (2010)

Tabela 14. Aktiviteti i regjistrimit të agjensioneve të transferit të parave, 2005 – 2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Të regjistruara më parë	1	2	3	3	3
Regjistruara	1	1	0	0	0
Totali	2	3	3	3	3

Burimi: BQK (2010)

Tabela 15. Aktivitet e Regjistrimit të zyrave të këmbimit të valutave, 2005 – 2009

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Të regjistruara më parë	3	6	16	23	21
Regjistruara	4	10	7	0	2
Tërheqja e regjistrimit	(1)	0	0	(2)	0
Totali	6	16	23	21	23

Burimi: BQK (2010)

4.3 Veprimtaria e mbikëqyrjes financiare

Një nga funksionet kryesore të BQK-së është që të sigurojë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim të krijimit të një sistemi financiar të shëndoshë, të arritshëm dhe konkurrues, i cili sistem është i besueshëm dhe ofron një gamë të gjerë të shërbimeve financiare. Në kryerjen e këtij misioni, drejtoratet e Licensimit dhe Rregullimit, të Mbikëqyrjes së Bankave, Sigurimeve dhe Pensioneve janë përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe kontrollimin e institucioneve financiare dhe institucioneve jobankare financiare që operojnë në Kosovë.

4.3.1 Zhvillimet më domethënëse të mbikëqyrjes bankare

Sistemi bankar vazhdoi me rritje përgjatë gjithë vitit 2009, ndonëse ritmi i rritjes ishte më i vogël krahasuar me vitet paraprake. Për shkak të vetë specifikave të ndërtimit dhe zhvillimit të sistemit bankar, efektet nga kriza financiare ndërkombëtare ishin kryesisht indirekte. Industria bankare mbeti financiarisht e shëndoshë, likuide dhe solvente.

Fokusi i aktivitetit mbikëqyrës gjatë 2009 u artikulua si përgjigje ndaj nevojës për mbikëqyrje më të përafërt të sistemit bankar, për t'i amortizuar efektet potenciale nga sektori real i ekonomisë. Rritja e shpeshtësisë së ekzaminimeve në vend dhe nga jashtë përmes njësisë së analizave financiare, ekzaminimet e përbashkëta me autoritetet rregullative dhe mbikëqyrëse, ekzaminimet e fokusuara sipas profilit të institucionit dhe mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me strukturat menaxhuese të bankave, si dhe me autoritetet tjera mbikëqyrëse ishin pjesë integrale e këtij dimensionit.

Industria bankare vazhdoi të dominohet nga bankat me kapital të huaj, tri nga të cilat, banka sistemike (ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe NLB) përbëjnë 81% të totalit të mjeteve të industrisë, përderisa bankat me kapital vendor dhe bankat e inkuorporuara më vonë në treg konsoliduan pozicionet e tyre.

Aktiviteti mbikëqyrës gjatë 2009 u fokusua kryesisht në rritjen e vëmendjes së bankave ndaj efekteve potenciale nga kriza financiare ndërkombëtare që të sigurohet kujdes i shtuar në menaxhimin e rreziqeve bankare. Pikë referimi i mbikëqyrjes ishte vlerësimi i

kapaciteteve menaxhuese të rreziqeve bankare në kornizat e një klime ekonomike të paqëndrueshme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) dhe KfW – Banka Gjermane për Zhvillim, pas përkrahjes nga Bordi i BQK-ës, studimit të leverdisë në vitin 2007-8, dhe pas Vlerësimit Bazel për Mbikëqyrjen Financiare, që kanë rezultuar të favorshme, kanë vazhduar përpjekjet për themelimin e fondit për sigurimin e depozitave, po ashtu duke punësuar menaxherin e projektit.

Palët e interesit të konsultuara vazhdimisht dhe të përfshira në proces përfshijnë: Shoqata e Bankave të Kosovës, bankat komerciale, Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucionet Mikrofinanciare, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Banka Botërore, USAID, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Komisioni European, Shoqata e Auditorëve dhe Kontabilistëve të Certifikuar – SCAAK, Oda e Avokatëve të Kosovës, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), etj. Gjatë vitit 2009, BQK-ja ka bërë disa përpjekje në mënyrë që të themelohet sistemi, siç janë: kërkesa për fonde shtesë nga donatorët, ku është siguruar përkrahja nga Qeveria e Kosovës, ndryshimet në ligj sipas kërkesës së MEF, bashkëpunimi i ngushtë me MEF dhe palët me interes e në veçanti Shoqata e Bankave të Kosovës.

Ndryshimet në projektligj kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2009, me komentet nga MEF-i dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) të cilat janë inkorporuar në draft. Projektligji ka marrë përgjigje pozitive përmes deklaratës së kërkuar sipas procedurave për përkim me harmonizimin me legjislacionin evropian, që lëshohet nga Agjencioni Kombëtar për Zhvillim dhe Integritet Europiane pranë Zyrës së Kryeministrit, dhe MEF-i pritet t'a procedojë në Parlamentin e Kosovës brenda vitit 2010. Projektligji është i bazuar në Direktivën Europiane për garantim të depozitave 2009/14/EC⁷, praktikës ndërkombëtare dhe asaj regjionale dhe projektligji është finalizuar sipas ligjeve në fuqi në Kosovë.

Sigurimi i depozitave në shumë vende ka treguar se është i domosdoshëm, sidomos në rastin e krizës financiare, ku ka shërbyer si mjet për rritjen e besimit të depozitorëve në bankat e tyre, dhe me këtë ka penguar tërheqjen e depozitave nga bankat. Fondet për sigurim të depozitave kanë ngritur nivelin e garantimit të depozitave⁸ (shih tabelën e nivelit të garancionit të depozitave) ndërkaq në Kosovë fillohet me nivelin prej 2,000 € dhe mendohet që gradualisht të ngritet ky nivel me rastin e akumulimit të fondeve.

Ekzaminimet nga jashtë-analiza financiare

Për të përcjellë tendencat e indikatorëve me frekuencë të lartë, mbikëqyrja bankare rriti kërkesat për raportim - shpeshësinë dhe përbërjen e indikatorëve për t'u raportuar. Monitorimi i indikatorëve me frekuencë të lartë u vu në shërbim të pasurimit të 'sistemit të paralajmërimit të hershëm', që më kohë të identifikohet niveli i qëndrueshmërisë së bankave individuale dhe i sistemit bankarë si tërësi. Mbi këtë bazë u siguroa monitorim ditor i lëvizjes së ekspozimeve kreditore jashtë vendit, likuiditetit, performancës së kredive dhe depozitave (struktura e depozitave dhe lëvizjet e normave të interesit). Analiza financiare e këtyre indikatorëve evidentoi ritme të rëndomta lëvizjesh, të diktuar kryesisht nga konkurrenca më e konsoliduar e tregut.

⁷ Shih <http://eur-lex.europa.eu/JOHtml.do?uri=OJ:L:2009:068:SOM:EN:HTML>

⁸ Në Evropë ka ndodhur ngritja e garancionit nga 25,000 në 50,000 €, në disa vende ka edhe garancion pa kufi; në SHBA nga 150,000 \$ në 250,000 \$).

Ekzaminimet në vend

Gjatë vitit 2009 u kryen 18 ekzaminime të plota dhe 17 të fokusuara të institucioneve financiare. Qasja e ndjekur e mbikëqyrjes bazuar në rrezik⁹ mundësi ekzaminime më efektive përmes profilizimit të bankave dhe përshtatjes më racionale të aktivitetit mbikëqyrës. Përmes mbikëqyrjes së bazuar në rrezik janë monitoruar më shpesh nivelet e vetvetishme të rrezikut kreditor, likuiditetit, tregut, rrezikut operacional dhe mjaftueshmeria e menaxhimit të këtyre rreziqeve. Kjo qasje ka mundësuar marrjen e masave me kohë për të siguruar funksionim të shëndoshe dhe të sigurte të bankave.

Tabela 16. Ekzaminimet e institucioneve financiare gjatë vitit 2009

Institucionet financiare (Inspektimet e plota dhe të fokusuara)		
Përshkrimi	I plotë	I fokusuar
Banka	7	17
Institucionet mikrofinanciar	4	
Institucionet financiare jobankare	7	
Gjithsej	18	17

Burimi: BQK (2010)

Parametrat financiar të gjeneruar gjatë vitit 2009 në sektorin bankar

Sistemi bankar vijoi me rritje edhe gjatë vitit 2009. Shfrytëzimi i mirë i burimeve financiare ka ndikuar që sistemi bankar të shënojë performancë pozitive të treguesve të profitabilitetit. Treguesit kryesorë të profitabilitetit, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (ROA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (ROE), edhe gjatë vitit 2009 kanë vazhduar të shënojnë nivel relativisht të lartë. Ndonëse me një rënie të lehtë krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i rritjes më të shpejtë të aktivitetit mesatar dhe kapitalit mesatar sesa të fitimit neto, kthimi nga aktivet mesatare (ROA) në fund të vitit 2009 shënon nivelin prej 1.4%, derisa në vitin e kaluar ishte 2.4%, ndërsa ROE prej 20.2% sa ishte në vitin e kaluar, në vitin aktual shënon nivelin prej 13%.

Trendi i qëndrueshëm i treguesit të kapitalizimit (mjaftueshmërisë së kapitalit) të sektorit bankar ka vazhduar gjatë tërë vitit 2009. Treguesit e likuiditetit dhe kapitalizimit kanë qenë pozitiv dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ. Kapitalizimi i sektorit bankar në fund të periudhës i përcaktuar sipas treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit është 18%, duke rezultuar me rritje prej 1.4 pikë përqindje¹⁰ krahasuar me fundin e vitit 2008.

Aktivitetet likuide të sektorit bankar përfaqësojnë 37% të totalit të aktivitetit, si dhe 44.59% të totalit të depozitave. Është shënuar rritje apo përmirësim në raportin e aktiveve likuide me totalin e aktiveve dhe depozitave për 9.3 pikë përqindje, respektivisht 11.1 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar. Niveli i mjeteve likuide në kuadër të sistemit bankar në përgjithësi ka qenë i kënaqshëm. Edhe pse sistemi bankar vazhdoi të jetë mirë i

⁹ Trajnimi i mbajtur në Prishtinë "Mbikëqyrja e bazuar në rrezik" organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Sistemi i Rezervave Federale – i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte një mundësi më shumë për të mësuar nga praktikatat më të avancuara të mbikëqyrjes bazuar në rrezik. Stafii i mbikëqyrjes bankare mori pjesë në trajnime të ngjashme edhe jashtë Kosovës, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës Gjermani dhe Francë.

¹⁰ Me pikë përqindje iu është referuar diferencës aritmetike ndërmjet dy përqindjeve.


kapitalizuar dhe likuid, mbikëqyrja bankare ishte shumë aktive, duke rritur shpeshtësinë e monitorimit të performancës financiare të industrisë bankare.

Aktiviteti kreditues (kreditë neto) merr pjesë me 60.4% në totalin e aktivitetit të sistemit bankar, derisa në vitin e kaluar ky tregues ishte 67.17%. Treguesit e kualitetit të mjeteve evidentojnë gjendje pak më të përkeqësuar se në vitin e kaluar. Kështu që, pjesëmarrja e kredive me vonesa dhe e atyre joperformuese në totalin e kredive tani evidentohet 10.2% dhe 4.3%, për dallim nga një vit më parë pjesëmarrja e të cilave ishte 6.7% dhe 3.3%.

Zhvillimet e aktivitetit dhe pasivitetit të sistemit bankar


Totali i aktivitetit të sistemit bankar në vitin 2009 shënoi rritje me rreth 371 milionë euro ose për 21% krahasuar me vitin 2008. Paraqitja grafike e trendit të totalit të aktivitetit (e shprehur në mijëra euro) në periudhën dhjetor 2008 – dhjetor 2009

Figura 32. Vlera e asetëve në sektorin bankar - aktivitet gjithsej, në mijëra euro



Burimi: BQK (2010)

Figura 33. Trendi i kredive në sektorin bankar - gjithsej kreditë, në mijëra euro



Burimi: BQK (2010)

Zërat kryesor të aktivitetit të sistemit bankar evidentojnë ndryshimet si më poshtë:

“Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në” ka shënuar rritje për rreth 104.6 milionë euro apo për 48% krahasuar me vitin e kaluar. Si rezultat i ndryshimeve të theksuara, pesha e këtij pozicioni në kuadër të totalit të aktivitetit ka shënuar rritje nga 13% sa ishte në vitin e kaluar në 15% në vitin aktual.


“Aktivet fitimprurëse”¹¹ edhe gjatë vitit 2009 kanë vazhduar të kenë peshën më të madhe në totalin e aktivitetit duke shënuar rritje në vlerë absolute për 260 mijë euro ose 18.22% krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, si rezultat i rritjes më të shpejt të pozicionit “Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në” pesha e “Aktiveve fitimprurëse” në kuadër të totalit të aktiveve ka shënuar rënie të lehtë nga 82.91%, sa ishte në vitin e kaluar në 80.65% në fund të vitit aktual. Aktivitetet tjera të cilat nuk i përkasin aktiveve fitimprurëse dhe pozicionit “Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në” vazhdojnë të marrin pjesë me vetëm 4.34% të totalit të aktivitetit në fund të vitit aktual, respektivisht me 4.08% në vitin e kaluar. Në strukturën e mjeteve fitimprurëse vazhdon të mbizotërojë pozicioni i kredive (neto) me 70%, ndërsa pozicionet tjera marrin pjesë me: 24% nga kërkesat ndaj bankave

¹¹ Struktura e aktiveve fitimprurëse përfshinë këto pozicione: Kreditë, Kërkesat ndaj bankave (Plasmanët), Asetet e tregueshme dhe Letrat me vlerë.

(plasmanët), 2.69 % asetet e tregtueshme, dhe 4.4% letrat me vlerë. Në vitin e kaluar struktura e mjeteve fitimprurëse ishte e përbërë me sa vijon: 77.31% nga kreditë (neto), 19.86% nga kërkesat ndaj bankave (plasmanët), 1.57% asetet e tregtueshme dhe 1.26% letrat me vlerë. Nga përshkrimi i theksuar shihet se pozicioni i kredive neto ka shënuar rënie për 7.31 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar ndërsa në anën tjetër pozicioni i plasmanëve ka shënuar rritje për 4.14 pikë përqindje. Rënia e peshës së kredive në strukturën e mjeteve fitimprurëse është ndikuar nga rritja me e shpejt e pozicionit të plasmanëve se sa e kredive si dhe nga efekti i rritjes së rezervës për kredi nga 4.6% të totalit të kredive bruto në vitin e kaluar në 6.1% në vitin aktual. Zhvillimet e theksuar më lart në aktivet fitimprurëse kanë ndikuar direkt në fitimit e sistemit bankar duke gjeneruar tregues më të ulët të profitabilitetit krahasuar me vitin e kaluar.

Burimet e financimit -Depozitat e sistemit bankar evidentojnë këto ndryshime gjatë vitit 2009. Gjithsej depozitat shënuan rritje me rreth 309.5 milionë euro ose 21% krahasuar me vitin e kaluar. Në këtë rritje, depozitat pa interes u rritën rreth 39.4 milionë euro ose 11.6%, ndërsa depozitat me interes u rritën për 269.9 milionë euro ose për 24.5% krahasuar me vitin e kaluar. Në kuadër të strukturës të depozitave pa interes janë shënuar këto ndryshime : depozitat nga bankat u zvogëluar për 294 mijë euro ose 3.8%, depozitat nga individët u rritën për 41.6 milionë euro ose 22.1% dhe depozitat nga ndërmarrjet u zvogëluar për 1.8 milionë euro ose për 1.3%, ndërsa në kuadër të strukturës së depozitave me interes janë shënuar këto ndryshime: depozitat nga bankat të cilat në dhjetor 2008 ishin në vlerë prej 6.7 milion euro, në dhjetor 2009 vlera e tyre është 3.1 milionë euro, depozitat nga individët u rritën për 172.5 milionë euro ose 26.1% dhe depozitat nga ndërmarrjet (duke përjashtuar vetëm institucionet bankare dhe ekonomitë familjare) u rriten për 101.1 milionë euro ose për 23.2%.

Figura 34. Trendi i depozitave në sektorin bankar - gjithsej depozita, në mijëra euro



Burimi: BQK (2010)

Përkundër trendit të rënies së burimeve të mjeteve – depozitave në tregjet globale, të ndikuar nga kriza financiare në tregjet globale dhe recesioneve ekonomike të vendeve më të zhvilluara botërore, depozitat në industrinë bankare të vendit vazhduan të rriten. Kjo rritje e depozitave ka ruajtur peshën e lartë që pozicioni i depozitave ka në kuadër të pasivit të pjesa e detyrimeve me 92.7%. Siç shihet nga grafiku i mëposhtëm, trendi i

depozitave nga dhjetori 2008 deri në dhjetor 2009 vazhdimisht ka shënuar qëndrueshmëri stabile të rritjes.

Parametrat financiarë të gjeneruar gjatë vitit 2009 - industria e mikrofinancave

Institucioneve mikrofinanciare (IMF), gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin e kaluar ka shënuar këto ndryshime: Totali i aktiveve ka shënuar rritje prej 25.2 milion euro ose 25.7% krahasuar me vitin e kaluar duke shënuar vlerën 123 milionë euro. Kreditë neto janë rritur për 18.5 milion euro ose 21%. Treguesi i kualitetit të kredive përkatësisht raporti i kredive me probleme me totalin kredive ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin e kaluar. Pjesëmarrja e kredive problematike në totalin e kredive në fund të dhjetorit 2009 sillej 3.04%. Në vitin e kaluar këta tregues ishin shumë më të lartë duke shënuar nivelet 6.30% . Mirëpo, kjo është më tepër rrjedhojë e tërheqjes së licencës së ABU-së¹² që kishte një portofolio kreditore në vlerë prej 5 milionë euro nga e cila 4.7 milionë euro ishin kredi me problem. Aktiviteti kreditor i sektorit të IMF vazhdojnë të jetë aktivi kryesor në kuadër të totalit të aktivitetit duke shënuar nivelin prej 88.4% Edhe gjatë vitit 2009 sektori i IMF ka shënuar tregues pozitiv të profitabilitetit. Kthimi nga mjetet mesatare (ROA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (ROE) kanë shënuar nivelet 1.53% përkatësisht 4.59%. Këta tregues kanë shënuar rënie të ndjeshme krahasuar me nivelet prej 6.19% përkatësisht 14.92% të vitit të kaluar nga ndikimi i rritjes së shpenzimeve të provizionit për kredi për afër 3 milionë euro. Sektori i IMF – ve vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar. Totali i aktiveve është i mbështetur nga kapitali me 30.4%.

4.3.2 Mbikëqyrja e Sigurimeve dhe Pensioneve

Gjatë vitit 2009 në industrinë e sigurimeve operuan gjithsej 11 kompani të sigurimeve, prej tyre dhjetë kompani jo jetë dhe një kompani për sigurim të jetës.

Sa i përket strukturës së pronësisë së kompanive jo-jetë, gjatë kësaj periudhe ndryshim pësoi KS Dukagjini ku pas shitblerjes së aksioneve mes aksionareve, kjo kompani zotërohet 100% nga Sava Re, me ç'rast një kompani është me pronësi të huaj, gjashtë me pronësi mikserë përzier (vendore dhe të huaj), ndërkaq tri kompani janë tërësisht me pronësi vendore.

Po ashtu, ndryshim në strukturë të pronësisë gjatë vitit 2009 pësoi edhe kompania e sigurimeve të jetës “Dukagjini Life”, ku si rezultat i shitblerjes së aksioneve, momentalisht kjo kompani zotërohet 100% nga SAVA Re, d.m.th është tërësisht me pronësi të huaj.

Krahasuar me vitin 2008 rritja e aktivitetit të sigurimeve argumentohet me rritjen e numrit të policave gjatë vitit 2009. Në fund të vitit 2009 numri total policave të shitura të sigurimeve ishte në vlerë prej 629,444 që rezultoi me një rritje prej 32.11% krahasuar me vitin 2008.

Strukturën e portfolios siguroese për vitin 2009 e karakterizuan 40.11 % polica te detyrueshme, 29% polica te sigurimit kufitar, 12.24% polica te sigurimeve tjera (vullnetare) dhe 18.45 policat e sigurimit shëndetësor ne kufi. Tregu i sigurimeve te jetës akoma mbetet i ulte dhe se gjate vitit 2009 ne total portfolion siguroese morri pjese me 0.39% te policave.

¹² Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në mes të Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER) dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (FKSHC) si dhe të kërkesës së FKSHC më 13 tetor 2009, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka tërhequr regjistrimin e Agro Business Unit si institucion financiar jo-bankar.

Gjatë vitit 2009 u grumbulluan prime në vlerë prej 68,3 milion euro apo 21.3% më shumë se në vitin 2008. Vlera e dëmeve të paguara në vitin 2009 ishte 18,5 milionë euro, apo 6.4 % më shumë se në vitin e 2008.

4.3.2.1 Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes së sigurimeve

Duke pasur parasysh rolin dhe objektivat e Drejtoratit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve, drejt mbrojtës së interesave të policmbajtësve (klientëve) dhe në përgjithësi ruajtjes dhe qëndrueshmërisë së stabilitetit të sistemit financiar, edhe këtë vit drejtorati përmes instrumenteve të veta mbikëqyrëse qoftë përmes ekzaminimeve në vend (on-site) dhe monitorimit nga jashtë (off-site) ushtroi një mbikëqyrje të bazuar në rrezik.

Përveç kryerjes së ekzaminimeve në vend, monitorimi i aktivitetit të kompanive është bërë edhe përmes monitorimit nga jashtë (off-site), duke pranuar raporte nga kompanitë e në baza mujore, tremujore apo vjetore. Mbi bazën e këtyre raporteve janë llogaritur indikatorë (tregues) të ndryshëm financiarë të cilët tregojnë mirëvajtjen e aktivitetit të kompanive të sigurimeve si: margjina minimale e solvencës, fuqia financiare– likuiditeti, kalkulimi i rezervave teknike, ekspozimi i rrezikut, maksimumi i mbajtëse së rrezikut nga kompanitë e sigurimeve, kualiteti i risigurimit, si dhe tregues tjerë relevantë financiarë.

Tabela 17. Ekzaminimet e zhvilluara gjatë vitit 2009

Përshkrimi	Numri i ekzaminimeve 2009
Kompanitë e sigurimeve, inspektim i plotë	10
Kompanitë e sigurimeve, inspektim i fokusuar	23
Kompanitë e sigurimeve- zyrat e operatorëve dhe agjentëve	82
Sigurimi kufitar (IAK), Fondi i Garancisë (GFK)	2

Burimi: BQK (2010)

Gjatë vitit 2009, ndryshim pësoi edhe Rregulla 8 e BQK-së mbi “Depozitimimin e aseteve si garanci, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e rrezikut, investimeve dhe likuiditetin” përkatësisht neni 3 të kësaj rregulle që ka të bëjë me investimin e kapitalit themeltar të kompanive të sigurimeve jo jetë. Duke pasur parasysh se më parë kompanitë e sigurimeve kanë qenë të obliguara që 60 % të kapitalit themeltar ta mbajnë në BQK dhe 40% ta investojnë në bankat komerciale të Kosovës, BQK-ja vendosi që kompanitë e sigurimeve 10% të kapitalit themeltar ta mbajnë në BQK dhe 90 % ta investojnë në bankat komerciale të Kosovës, mirëpo jo më shumë se 30% të mjeteve në një bankë të vetme me qëllim të diversifikimit të rrezikut.

Përveç aktiviteteve që rezultuan nga plani operativ i mbikëqyrjes së sigurimeve, gjatë vitit 2009 BQK-ja lëshoi edhe dy udhëzime administrative; njëri kishte të bënte me rregullimin dhe mënyrën e investimit të mjeteve të fondit garantues (kapitalit themeltar) për kompanitë e sigurimeve të jetës. Udhëzimi tjetër administrativ kishte të bënte me certifikimin e rezervave teknike për kompani të sigurimeve jojetë në baza tremujore bazuar në udhëzimet e metodologjisë së llogaritjes së rezervave teknike.

Sipas këtij udhëzimi, kompanitë e sigurimeve jojetë janë të obliguara që në baza tremujore dhe vjetore të dorëzojnë në BQK rezervat teknike të certifikuar nga aktuari i certifikuar i kompanisë apo i angazhuar nga jashtë dhe mbi këtë bazë BQK-ja do vlerësojë dhe sigurojë adekuatshmërinë e rezervave.

Mbështetur në marrëveshjet e mirëkuptimit mes BQK-së dhe autoriteteve të mbikëqyrjes financiare të Shqipërisë dhe Sllovenisë në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve, këtë vit

ekipit të ekzaminereve të drejtoratit të mbikëqyrjes së sigurimeve dhe pensioneve gjatë procesit të ekzaminimeve iu bashkëngjiten edhe ekzaminerë të autoriteteve të lartpërmendura, i cili bashkëpunim kontribuoi në këmbimin dhe avancimin e eksperiencave profesionale në fushën e sigurimeve.

Performanca financiare e industrisë së sigurimeve gjatë vitit 2009

Edhe gjatë vitit 2009 industria e sigurimeve performoi me një rritje të qëndrueshme. Tabela e mëposhtme tregon se bruto primi i shkruar ka shënuar rritje për 20.41% në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008.

Tabela 18. Bruto Primi i Shkruar 2009 – 2008

Primet	2009	2008	Ndryshimi në %	Indeksi	
				2008	2009
TPL	35,394,753	35,008,412	1.10	56%	67%
Sigurimi kufitar	11,992,789	9,800,771	22.37	19%	19%
Jo TPL	17,133,899	9,117,255	87.93	27%	17%
Kthimet	(1,365,724)	(1,477,866)	(7.59)	(0.02)	(0.03)
BPSH	63,155,717	52,448,552	20.41	100%	100%

Burimi: BQK (2010)

Rritje më të madhe kanë shënuar sigurimet vullnetare, e cila rritje në vitin 2009 rezultoi për 88% krahasuar me vitin 2008, ndërkaq sigurimi vullnetar shënoi rritje për 22.4%, pjesën tjetër e përbën sigurimi i auto përgjegjësisë (detyrueshëm).

Vlen të theksohet pjesëmarrja e sigurimeve vullnetare në total portfolion e sigurimeve që merr pjesë 27% në vitin 2009 derisa në vitin 2008 ishte 17%. Orientimi drejt sigurimeve vullnetare tregon një indikator zhvillimor për industrinë e sigurimeve në Kosovë.

Tabela 19. Raporti i dëmeve të paguara dhe të ndodhura 2009-2008

Përshkrimi	2009	2008
Raporti i dëmeve të paguara	32.60%	27.35%
Raporti i dëmeve të ndodhura	42.20%	37.72%
Raporti i shpenzimeve	59.32%	51.12%
Raporti i kombinuar	101.52%	78.84%

Burimi: BQK (2010)

Tabela 20. Kthimi mesatar ne asete (ROA) dhe Kthimi mesatar ne ekuitet (ROE)

Përshkrimi	Standard	2009	2008
ROA	9%	3.60%	5.54%
ROE	15%	8.86%	11.44%

Burimi: BQK (2010)

Tabela 21. Aktivet e industrisë së sigurimeve 2009-2008

Asetet	2009	2008	Ndrysh. në %	Indeksi 2009	Indeksi 2008
Paraja e gatshme	56,605,434	56,977,603	(0.65)	66%	73%
Asetet kurente	18,407,987	12,756,152	44.31	22%	16%
Asetet fikse	10,149,660	7,735,167	31.21	12%	10%
Asetet e paprekshme	62,806	782,765	(91.98)	0%	1%
Gjithsej asete	85,225,888	78,251,687	8.91	100%	100%

Burimi: BQK (2010)

Në përgjithësi aktivet në industrinë e sigurimeve në Kosovë kanë shënuar rritje për 8,91%, në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008. Në vitin 2009 aktivet likuide përbëjnë 22% të total aseteve, përderisa në vitin 2008 përbënin 16%. Gjithashtu asetet fikse në vitin 2009 kanë shënuar rritje për 31% në krahasim me vitin 2008 që ishte 12% e totalit të aseteve.

4.3.3 Zhvillimet domethënëse të mbikëqyrjes të pensioneve gjatë vitit 2009

Sistemi pensional i Kosovës është sistem i organizuar në tri shtylla kryesore.

Shtylla e parë	Pensioni bazik
Shtylla e dytë	Pensionet individuale të kursimeve që i siguron TKPK-ja
Shtylla e tretë	Fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit, vullnetare individuale.

Pensionet bazë i siguron Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale. Pensionet individuale të kursimeve i siguron Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës nga kontributet e obliguara të punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndërsa ofrohen edhe fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit dhe vullnetare individuale.

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) funksionon mbi bazën e kontributeve të definuara. Kontributet grumbullohen nga punëdhënësit që paguajnë një shumë prej 5% të pagave të përgjithshme të të gjithë punonjësve, si dhe çdo punonjës paguan një shumë prej 5% të rrogës së tërësishme të tij. Pas një rënie drastike të vlerës së mjeteve (kontributeve) të Trusit në vitin 2008, si rezultat i krizës financiare globale, në vitin 2009 vlera e kontributeve të TKPK-së të investuara jashtë Kosovës ka rezultuar kthime pozitive krahasuar me humbjet e vlerës së mjeteve të investuara jashtë Kosovës.


Gjendja e përgjithshme mjeteve pensionale të TKPK-së në fund të vitit 2009 ishte në vlerë prej 375,967,679.65 €, aksione të lëshuara në numër 382,643,494.67, vlera e aksionit ishte 0.9818, ndërsa numri i kontribuuesve ishte 301,710.

Tabela 22. Vlera e mjeteve të TKPK-së nga themelimi

Vitet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Vlera e mjeteve	8,620,010	37,856,290	82,933,196	143,724,854	213,385,342	278,047,877	253,842,714	375,967,680


Burimi: Trusti (2010)

Figura 35. Trendi i mjeteve në TKPK nga themelimi



Burimi: BQK (2010)

Figura 36. Çmimi i aksionit të TKPK-së nga themelimi



Burimi: Trusti (2010)

Tabela 23. Çmimet për aksion nga themelimi i TKPK-së

Vitet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Çmimi	1.0002	1.0081	1.0209	1.1093	1.1983	1.2184	0.8605	0.9818

Burimi: Trusti (2010)

Gjithashtu, shtylla e tretë që përfaqësohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve gjatë vitit 2009 ka ushtruar aktivitetet si në vijim:

- Grumbullimin e kontributeve apo asetëve në llogaritë individuale,
- Mbajtjen dhe administrimin e llogarive individuale,
- Menaxhimin e asetëve të grumbulluara,
- Pagesën e pensioneve suplementare.

Gjendja e përgjithshme e mjeteve pensionale në FSKP në vitin 2009 është pasqyruar në tabelën në vijim:

Tabela 24. Gjendja e mjeteve pensionale në FSKP në vitin 2009

Fondi 1	3,155,289.54
Fondi 2	1,598,650.68
Menagjeri i asetëve	4,004,543.00

Burimi: Fondi Slloveno - Kosovar

Fondi 1 paraqet gjendjen e kontributeve pensionale e kontribuuesve vullnetarë, ndërsa Fondi 2 paraqet gjendjen e mjeteve pensionale të fondeve punëdhënëse PTK dhe KEK të transferuara në FSKP, pas mbylljes së këtyre fondeve me kërkesën e bordeve të fondeve.

Shtylla e dytë dhe e tretë mbikëqyren nga BQK-ja përmes analizave të jashtme (Off-Site) me mbledhjen e të dhëna dhe raporteve që në pajtueshmëri me kornizën ligjore ofrohen në, mujore, tremujore dhe vjetore. Këto të dhëna vlerësohen dhe shërbejnë për të llogaritur indikatorë (tregues) të ndryshëm financiarë që tregojnë mirëvajtjen e aktivitetit të Trustit dhe FSKP. Gjithashtu, ekzaminimi në vend i (përgjithshëm dhe i fokusuar), i cili kryhet së

paku një herë në vit për Trustin dhe FSKP-ne ka përcjell më për së afërmi gjendjen financiare të këtyre institucioneve dhe rrezikun e ndërmarrë.

4.4. Veprimet ndëshkuese

Shtrirja dhe frekuenca e aktiviteteve të mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme rritet në raste kur keqësohet profili i rrezikut të një institucioni. Sa më i pafavorshëm të jetë profili i rrezikut, aq më e madhe do të jetë shkalla e ndërhyrjes së mbikëqyrjes, dhe më të mëdha do të jenë gjasat e ndërmarrjes së masave korrigjuese dhe gjobave si mjete të përforsimit të pajtueshmërisë apo sigurimit të kthimit në gjendje të sigurt dhe të shëndoshë.

Pavarësisht nga përpjekjet e mbikëqyrësve, gjatë vitit 2009 janë krijuar situata kur institucionet financiare kanë dështuar për të arritur kërkesat prudente të mbikëqyrjes ose janë përdorur praktika të pasigurta dhe jo të shëndosha bankare dhe siguruese. Mbikëqyrja e posaçme, masat përmirësuese dhe gjobat janë imponuar në atë mënyrë që të jenë transparente dhe të paanshme, gjë që ka reflektuar mbikëqyrjen shqetësuese të BQK-së, duke pasur në konsiderim bashkëpunimin dhe perceptimin e kompetencës së menaxhmentit të institucionit.

Si rezultat i shkeljeve të rregulloreve ose praktikave bankare të pasigurta ose jo të shëndosha, BQK-ja ka vazhduar të mbajë nën memorandume të mirëkuptimit dy banka gjatë vitit 2009, ndërsa mbikëqyrja e sigurimeve ka nisur 18 veprime detyruese kundër kompanive të sigurimit. Arsytet e masave ndëshkuese kishin të bëjnë me mosrespektimin e tarifave (primeve) të produkteve të sigurimeve vullnetare gjatë procesit të ofertimit në tenderë të organizatave publike, shitjen e produktit të kartonit të gjelbër, angazhimin e personave të palicencuar në aktivitete të sigurimeve, si dhe operimin e tyre në zyra të palicencuara. Vlera e tërësishme e dënimeve me gjobe ndaj kompanive të sigurimeve në vitin 2009 ishte 50,000 euro që kanë qenë të hyra për buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Si rezultat i gjendjes së rëndë financiare të KS "Dardania", në maj të vitit 2009 Bordi i BQK-së vendos nën administrim të përkohshëm kompaninë me qellim të sanimit të gjendjes financiare dhe ruajtjes së aseteve të kompanisë që si rezultat do ketë ruajtjen e interesave të mbajtësve të policave.

Veprimet detyruese në vitin 2009 të ndërmarra bazuar në Rregulloren nr. 1999/21 dhe 2001/25, shtrihen, duke filluar nga vërejtjet me shkrim, urdhëresat administrative dhe ishin të bazuara në masën e shkeljes, ekspozimit të rrezikut, shkeljeve të përsëritura, etj. Llojet e veprimeve detyruese të ndërmarra nga BQK-ja, duke përfshirë komunikimet me gojë dhe me shkrim, kufizimi i aktiviteteve të caktuara, marrëveshjet formale në mes të BQK-së dhe institucioneve financiare dhe kërkesat për ngritjen e kapitalit aksionar, ngritjen e rezervave teknike, pagesën e dëmeve dhe dënimet monetare. Veprimet detyruese ndaj institucioneve financiare kanë rezultuar në pozita më të mira financiare të institucioneve financiare dhe kanë zvogëluar rrezikun.

4.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e mbikëqyrjes financiare

Bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare dhe të sigurimeve, i është kushtuar një vëmendje më e posaçme gjatë vitit 2009.

Bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Shqipërisë, të Sllovenisë, dhe Autoritetin Rregullativ të Mbikëqyrjes në Turqi dhe Austri është zgjeruar edhe më tepër gjatë vitit 2009, me rastin e takimeve, seminareve dhe kolegejeve të organizuara nga autoritetet e mbikëqyrjes në Shqipëri, Slloveni, Turqi dhe Austri dhe anasjelltas. Të gjitha këto

zhvillime kontribuuan edhe me shumë në zgjerimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave mbikëqyrëse në mes dy vendeve.

Gjithashtu, bashkëpunimi me autoritetet e mbikëqyrjes së sigurimeve të Shqipërisë, të Sllovenisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe Austrisë është zgjeruar më tepër në aspektin e shkëmbimit të informatave rregulluese dhe mbikëqyrëse. Sidomos, janë shkëmbyer informata me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Sllovenisë me rastin e blerjes së aksioneve deri në 100% të pronësisë së KS Dukagjini dhe Dukagjini Life nga ana e Sava RE, në Slloveni.

Një komponentët shume i rëndësishëm që e karakterizoi drejtoratin gjatë vitit 2009 ishte edhe ofrimi i asistencës teknike nga Banka Botërore.

Asistenca teknike u ofrua në disa fusha të sigurimeve: duke përfshirë përgatitjen e draft ligjit mbi sigurimin e detyrueshëm, i cili draft është i përfshirë në koncizën ligjore për aprovim në vitin 2010. Vlen të theksohet asistenca teknike ofruar në fushën e sigurimit të jetës, përmes të së cilës u rishikua rregullativa ligjore ekzistuese si dhe u propozuan rekomandimet përkatëse, pastaj u përgatiten manualët për ekzaminime në vend dhe monitorim nga jashtë përmes të të cilëve mundësohet një mbikëqyrje të bazuar në rrezik.

Po ashtu asistencë teknike është ofruar edhe lidhur me liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm, me ç'rast nga eksperti i bankës botërore është bërë vlerësim i procesit të kontrolluar të liberalizimit, si dhe janë dhënë rekomandimet lidhur me procesin e mëtejshëm drejt liberalizimit të plotë. Njëkohësisht është përgatitur edhe manuali mbi politikën dhe procedurat e mbikëqyrjes së sigurimeve, i cili do të shërbejë si udhëzues në procesin e mbikëqyrjes së sigurimeve si në aspektin teorik edhe në atë praktik.

Bazuar në 'principet bazë për mbikëqyrje efektive bankare'¹³, memorandumet e mirëkuptimit, marrëveshjet shumëpalëshe të nënshkruara, si dhe zhvillimet në tregjet financiare, gjatë vitit 2009 vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së komunikimit dhe bashkërendimit të aktivitetit mbikëqyrës me autoritetet rregullative dhe mbikëqyrëse të vendeve në të cilat kanë pronësinë bankat që operojnë në Kosovë si me Slloveni, Austri, Turqi dhe Gjermani. Në këtë fushë, mbikëqyrja bankare ka realizuar dy ekzaminime të përbashkëta si dhe ka marrë pjesë në kolegjet mbikëqyrëse të organizuara nga autoritetet rregullative dhe mbikëqyrëse 'amë'. Kjo qasje gjithashtu ka siguruar informacion relevant për veprimet e ndërmarra nga autoritete rregullative dhe mbikëqyrëse ndaj karshi efekteve të krizës financiare si dhe për praktikën e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

4.6. Komitetet e mbikëqyrjes financiare

Gjatë vitit 2009 në kuadër të mbikëqyrjes financiare kanë vepruar tri komitete këshilluese:

Komiteti i mbikëqyrjes financiare

Komiteti drejtues i bankës kreditore në likuidim

Komiteti drejtues për KS Dradania në administrim

Komiteti i mbikëqyrjes financiare funksionon që nga vitit 2006. Objektivi primar është të shërbejë si trup këshill dhënës në dhënien e rekomandimeve Guvernatorit në procesin e vendimmarrjes. Në vazhden e takimeve të rregullta të Komitetit të mbikëqyrjes financiare gjatë vitit 2009 janë mbajtur gjithsej 8 sesione ku janë shqyrtuar çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare që operojnë në vend duke filluar nga licencimi, mbikëqyrja dhe rregullimi i këtyre institucioneve.

¹³ "Principet bazë për mbikëqyrje efektive bankare" – Komiteti i Bazelit për mbikëqyrje bankare

Komiteti drejtues për Bankën Kreditore në likuidim është themeluar në vijim të procesit të likuidimit, likuidatori me menaxhmentin e BQK, për të monitoruar procesin e likuidimit dhe bashkërenduar aktivitetet e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit. Komiteti takohet në baza mujore, për të diskutuar dhe koordinuar çështjet me interes të përbashkët. Çështjet e diskutuara dhe të trajtuara janë rimbursimi i depozitarëve, kostoja e likuidimit, inkasimet, etj.

Komitetit drejtues mbi KS Dardania ka filluar punën pas vendimit të Bordit Drejtues të BQK-së për të vendosur nën masa të administrimit të Përkohshëm në KS Dardania bazuar në nenin 77 pika j, të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25. Gjatë kësaj periudhe, ekipi i komiteti drejtues në bashkëpunim me administratorin e përkohshëm kanë mbajtur takime të rregullta përmes të cilave është përcjellë mbarëvajtja e situatës me vendosjen e administrimit të përkohshëm.


5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) u siguron institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë shërbimet e rëndomta që ofrojnë bankat qendrore. Në përgjithësi këto shërbime kanë të bëjnë me qarkullimin e parave të gatshme, transaksionet e llogarive, menaxhimin e mjeteve financiare, sistemet ndërbankare të pagesave, regjistrin e kredive dhe statistikat dhe analizat ekonomike.

5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme


BQK-ja është kompetente për sigurimin e një furnizimi të duhur të ekonomisë vendore me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme. Meqë euroja është valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë, përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kanë të bëjnë në radhë të parë me euron.

Figura 37. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2010)


Figura 38. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK(2010)


Sa i përket vlerës së përgjithshme, paratë e gatshme të furnizuara gjatë vitit 2009 patën një rritje prej 37 përqind krahasuar me vitin 2008, ndërkaq struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk pati ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2008 në vitin 2009. Te kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë denominimet e ulëta – 5, 10, 20 dhe 50 euro, ndërsa vëllimet e denominimeve prej 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta. Te monedhat euro furnizimi kryesisht dominohet nga monedhat me vlerë të mesme nga 5 eurocent deri në 50 eurocent, ndërsa vëllimet e denominimeve të ulëta jo vetëm që janë dukshëm më të ulëta në krahasim por edhe patën rënie të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.

Figura 39. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2010)


Figura 40. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2010)


Siç është paraqitur në figurat e mësipërme, gjatë vitit 2009, BQK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me afër 6.8 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë rreth 190 milionë euro) dhe mbi 0.92 milion copë monedha euro (në shumë rreth 0.4 milion euro). Në vitin 2009, vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje të konsiderueshme prej 15 përqind krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 12 milionë copë kartëmonedha euro (mesatarisht rreth 48,000 copë kartëmonedha në ditë) dhe afër 2.9 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 12,000 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 599 milionë euro dhe 2.1 milionë euro, përkatësisht. Struktura e kartëmonedhave dhe monedhave euro të pranuar nuk dallon shumë nga viti paraprak.

Figura 41. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2010)

Figura 42. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2010)

Ngjashëm me vitet e kaluara, në vitin 2009, paratë e gatshme të depozituara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 411 milionë euro, ndryshimi i tillë ishte në një masë të konsiderueshme më të lartë se sa në vitin e mëhershëm kur qe rreth 385 milionë euro.


Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme, duke dërguar tepricat në eurozonë, ku kthehen në mjete interes-prurëse, rritja vjetore e parave të gatshme të depozituara kundrejt parave të gatshme të furnizuara ka rezultuar gjithashtu në rritjen e neto dërgesave jashtë vendit të parave të gatshme. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2009 arritën shumën prej 429 milionë eurove duke qenë më të larta se sa një vit më herët kur ishin 409 milionë euro. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.

Figura 43. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2010)


Figura 44. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

Operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat standarde. Të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera procesohen dhe klasifikohen sipas shkallës së vjetërsimit. Gjatë vitit, rreth 3.8 milionë copë kartëmonedha euro (32 për qind e numrit të kartëmonedhave euro të depozituara) u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat qendrore të eurozonës. Një vëllim i këllillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 20, 10 dhe 5 euro, për shkak të qarkullimit më të madh të tyre në ekonomi.


Figura 45. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2010)

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të kartëmonedhave plotësisht të reja euro, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2009, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me mbi 2.1 milionë copë kartëmonedha të reja euro (31 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara).


Figura 46. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar



Burimi: BQK (2010)

Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve më të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë).


Figura 47. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)



Burimi: BQK (2010)

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja vazhdoi të përcjellë rastet e parave të falsifikuara gjatë vitit 2009. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false dhe organizimin e trajnimeve relevante për stafin e institucioneve financiare. Vlen të theksohet finalizimi i termave të referencës së komitetit të përbashkët me policinë për analizë të parave të falsifikuara.

Figura 48. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara



Burimi: BQK (2010)

5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Thesarin dhe institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), ndërmarrjet publike, institucionet financiare dhe organizatat ndërkombëtare. Në vitin 2009, sikurse edhe viteve të mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave, duke përfshirë çfarëdo forme të kreditimit.

Gjatë vitit 2009, BQK-ja vazhdoi të mbështesë avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Thesarit dhe të AKP-së. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i urdhërtransferave në emër të AKP-së.

Tabela 25. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009
Transaksionet me para të gatshme					
Depozitat në para të gatshme	456,279	440,975	533,178	524,346	601,207
Tërheqjet në para të gatshme	206,375	145,875	161,433	139,233	190,152
Transferët vendore					
Transferët vendor ardhës	828,633	998,128	1,055,472	1,076,145	1,225,527
Transferët vendor dalës	698,779	769,460	697,290	998,067	1,184,358
Transferët ndërkombëtar					
Transferët ndërkombëtar ardhës	100,592	260,267	335,613	203,113	202,755
Transferët ndërkombëtar dalës	321,600	325,810	322,489	567,908	666,571


Burimi: BQK (2010)

Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së lidhet me bankat komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së kryhen në emër të dhe për llogari të Thesarit.

BQK-ja merr pjesë në kanalizimin e urdhërpagesave vendore në emër të dhe për llogari të llogarimbajtësve të saj si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN). Gjatë vitit 2009, përmes SEKN-së BQK-ja ka dërguar në emër të klientëve të saj mbi 145.8 mijë urdhërpagesa shkuarëse (një rritje prej 8 për qind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 81.6 mijë urdhërpagesa ardhëse (një zvogëlim prej 7 për qind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse në vitin 2009 arritën mbi 1.1 miliardë euro (një rritje prej 19 për qind krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse arritën mbi 1.2 miliardë euro (një rritje prej 14 për qind krahasuar me vitin paraprak). BQK-ja ka mbetur, sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve, pjesëmarrësi më i madh në SEKN.


Kur flitet për transaksionet e pagesave vendore, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato si pjesëmarrëse në SEKN, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.

Figura 49. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse, numri




Burimi: BQK (2010)

Figura 50. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2010)

Figura 51. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2010)


Figura 52. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, në vitin 2009, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kanë të bëjnë me transferet e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 53. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri




Burimi: BQK (2010)

Figura 54. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2010)

Figura 55. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2010)


Figura 56. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2010)

Depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës së bashku me depozitat e AKP-së përbëjnë pjesën më të madhe të depozitave të gjithmbarshme të mbajtura në BQK në fund vitin 2009 (61 për qind). Më 31 dhjetor 2009, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës arritën shumën prej 213.8 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 451 milionë euro.

Figura 57. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, miliard euro



Burimi: BQK (2010)

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave që mbahen në llogaritë në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me obligimet e tyre rregullatore. Ato përbëjnë 22 për qind të depozitave të gjithsejta që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2009. Më 31 dhjetor 2009, depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimit ishin në shumën prej 240.9 milionë euro.

Po ashtu edhe niveli i depozitave të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) të mbajtura në BQK u rrit gjatë vitit 2009. Ato përbënë rreth 11 për qind të depozitave të gjithsejta që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2009 dhe në fund të vitit arritën shumën prej 122 milionë euro.

5.3. Menaxhimi i mjeteve

Bazuar në Ligjin mbi BQK-në (neni 6), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është e autorizuar të veprojë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe të ofrojë këshilla financiare me kërkesë të kësaj Ministrie. Njëkohësisht, sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (neni 7), BQK është autorizuar t'i investojë mjetet e Qeverisë. Kjo formë e investimeve financiare mundëson kthimin në investime i cili në formë interesi derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Fondet e depozituara në BQK u takojnë kryesisht institucioneve qeveritare. Kështu, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (rezervat buxhetore) dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) janë ndër depozitarët kryesorë të BQK-së. Pjesa tjetër e fondeve ka të bëjë kryesisht me rezervën e detyrueshme të cilën bankat komerciale e mbajnë në BQK. Po ashtu, BQK-ja është e ngarkuar me menaxhimin e fondeve të depozituara nga agjencitë publike, institucionet financiare, dhe organizatat donatore. Drejtorati për Menaxhim të Mjeteve menaxhon portfolion e Thesarit si portfolio të veçantë, duke u bazuar në marrëveshje me Thesarin, përmes komitetit të likuiditetit, i cili mban takime r të rregullta çdo muaj. Pjesa tjetër e portfolios përmban të gjitha mjetet tjera të BQK-së. Sidoqoftë, të gjitha mjetet menaxhohen në pajtim me Politikën e Investimeve të aprovuar nga Bordi Drejtues i BQK-së duke i dhënë theks të veçantë *sigurisë, likuiditetit* dhe së fundi *kthimit në investime*.

Menaxhimi i rrezikut kryhet përmes vlerësimit mujor të bankave me të cilat bashkëpunon BQK-ja. Të gjitha aktivitetet e investimeve kryhen me bankat që i përmbushin kriteret e parashtruara të politikës së investimeve. Edhe përkundër krizës financiare, nga vlerësimet e vazhdueshme për qëndrueshmëri financiare nga Agjencionet Financiare Ndërkombëtare të gjitha bankat me të cilat bashkëpunon BQK-ja i përmbushin kriteret e politikës së investimeve me kategoritë kryesore të vlerësimit (Aaa dhe Aa).

BQK-ja i investon mjetet në instrumentet e tregut të parasë. Gjatë vitit 2009, vëmendje e posaçme i është kushtuar shpërndarjes së rrezikut. Të gjitha mjetet janë të investuara në bankat qendrore dhe komerciale të cilat janë nga shtetet e BE-së. Ndër tri Bankat Qendrore të këtyre shteteve Evropiane me të cilat bashkëpunon BQK janë: Banka Qendrore e Gjermanisë (Deutsche Bundesbank), Banka e Francës (Banque de France) dhe Banka Qendrore e Luksemburgut (Banque Centrale du Luxembourg) të cilat kanë një rrezik kreditor minimal dhe katër banka komerciale të shteteve anëtare të BE-së të cilat kanë një klasifikim kreditor Aa ose Aaa sipas vlerësimeve nga agjencitë ndërkombëtare financiare, Moody's, Fitch dhe Standard & Poor's.

Drejtorati i Menaxhimit të Mjeteve, përmes raporteve të menaxhimit të rrezikut, siguron të dhënat kreditore për secilën bankë me të cilën bashkëpunon, që do të përmbajë raportin e Agjencioneve Financiare Ndërkombëtare (Moody's) dhe/ose (Standard & Poor's), nëse ekziston mundësia edhe pasqyrat e rishikimit. Secila bankë me të cilën bashkëpunon BQK-ja rishikohet në baza mujore. Pasqyra të ndara të rishikimit të fokusuar në zhvillimet aktuale, si dhe raportimi i çfarëdo përmirësimi të çrregullimit në gjendjen e përgjithshme financiare të një banke me të cilën bashkëpunon BQK-ja, përgatitet në baza mujore, për t'u siguruar se janë përmbushur kriteret e përcaktuara me Politikën e Investimeve. Në qoftë se klasifikimi i detyrimeve afatshkurta të bankës me të cilën bashkëpunon BQK-ja bie

poshtë P1 (Moody's) apo A-1 (Standard & Poor's) do të rishikohet nga menaxheri i rrezikut dhe rishikimi i tillë do t'i prezantohet menjëherë komitetit të investimeve.

Në rast të letrave me vlerë, komiteti i investimeve do të vendosë nëse ato duhet shitur apo të lejohen që të arrijnë maturitetin. Atëherë kur zbulohet se banka me të cilën bashkëpunon BQK-ja ka rënë poshtë klasifikimeve të kërkuara, do të largohet nga lista e aprovuar. Nga vlerësimet e kryera mbi bankat me të cilat bashkëpunon BQK-ja, bankat të cilat nuk kanë përmbushë kriteret e klasifikimit kreditor janë larguar nga lista e aprovuar. Asnjë investim nuk është kryer me bankat me të cilat bashkëpunon BQK-ja, pa u shqyrtuar, rishikuar dhe aprovuar nga komiteti i investimeve, i cili takohet rregullisht për çdo muaj për t'u rikthyer në listën e aprovuar të BQK-së.

Investimi i mjeteve të paraqitura në valutën euro, deri në fund të vitit 2009 është bërë në instrumentet financiare, në depozita bankare (50%) dhe në letra me vlerë (50%) të garantuara nga shtetet e Bashkimit Evropian. Përcaktimi i kufijve të investimeve për secilën bankë me të cilën bashkëpunon BQK-ja dhe për vendet ku investohet janë të kufizuara rreptësisht. Përputhshmëria me rregullat e investimeve të brendshme është punuar në baza ditore, ndërsa të gjitha aktivitetet janë të ndara nga "back office-i" dhe të raportuara te Guvernatori. Analizat e rreziqeve, si dhe auditimet e funksioneve të menaxhimit të mjeteve janë bërë rregullisht.

Depozitimet e marra nga BQK-ja janë paguar në bazë të *normës së kamatës* së Bankës Qendrore Evropiane, dhe vlerës aktuale në të cilën ndodhet sistemi global financiar bazuar në politikën mbi normën e kamatës të BQK-së. Kthimi nga investimet i arritur nga BQK-ja në mesatare është minimum i normës së kamatës së ofruar, ku BQK-ja ndal një diferencë, e cila kontribuon në kthimin nga investimet e saj.


Sipas raportit të datës 31 dhjetor 2009, vlera e shumës së investuar të Thesarit me BQK-në ishte **213** milionë euro. Këto investime janë kryer në pajtim me politikën e investimeve dhe politikën e normës së kamatës të aprovuara nga Bordi Drejtues i BQK-së. Ky portofol është investuar në letra me vlerë të garantuara nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe depozita të afatizuara bankare.

Sipas raportit të datës 31 dhjetor 2009, totali i mjeteve të menaxhuara ishte **1,084** miliardë nga këto depozitimi nga Thesari është **213** milion euro (20%), AKP **451** milion euro (42%), TKPK **122** milion euro (11%) dhe depozitarët e tjerë përfshijnë rreth **298** milion euro (27%).

5.4. Sistemi ndërbankar i pagesave


Zhvillimi i një sistemi efikas dhe të sigurt për pagesat vendore, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare, është një funksion parësor i BQK-së. Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) i operuar nga BQK-ja është sistemi i vetëm ndërbankar i pagesave në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2009 u shënuan rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të SEKN-së dhe u bë avancimi i tij i mëtejshëm, ku duhet theksuar sidomos lansimin e skemës së debitimit direkt. Si një zhvillim tjetër me rëndësi në lëmin e sistemit të pagesave ishte përgatitja e Strategjisë së zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave dhe fillimi i zbatimit të saj.

Figura 58. Numri i transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2010)

Figura 59. Vlera e transaksioneve në SEKN




Burimi: BQK (2010)

Në vazhdimësi, vëllimi dhe vlera e transaksioneve të përshkuara përmes SEKN-së janë rritur, duke pasqyruar rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Sikurse viteve të mëparshme, në vitin 2009, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme. Rreth 3.8 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 3.98 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së. Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 38 për qind dhe vlera e transaksioneve u rrit për 26 për qind.


Rritja e konsiderueshme e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në vitin 2009 ishte rreth 15.9 milionë euro, krahasuar me rreth 12.7 milionë euro në vitin 2008. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SEKN-së në vitin 2009 ishte afro 15.1 mijë, krahasuar me rreth 10.9 mijë në vitin 2008.

Figura 60. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2010)

Figura 61. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN




Burimi: BQK (2010)

Janë disa lloje të veçanta të transaksioneve të SEKN-së: prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro (masive) dhe të rregullta (individuale dhe masive). Nivelet krahasuese të

vëllimeve dhe vlerave të tyre për vitet 2009 dhe 2008 janë të paraqitura në figurat e mëposhtme.

Pagesat e rregullta përbejnë rreth 90 përqind të vëllimit dhe rreth 70 përqind të vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Ato kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (një-deri te shumë ose shumë-deri te-një). Ato procesohen përmes sesioneve të rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto.


Figura 62. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2010)

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SEKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuara për pagesat në përgjithësi dhe pagesat e rregullta masive janë të destinuara për pagesat dhe arkëtimet e ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme, transaksionet Kos-Giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të entiteteve të mëdha faturuese.

Figura 63. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2010)

Transaksionet prioritare procesohen dhe shlyhen menjëherë në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare mund të kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2009, sa i përket vëllimit, ato përfaqësuan më pak se 1 përqind të transaksioneve të SEKN-së, ndërsa sa i përket vlerës, ato arritën të përfaqësojnë mbi 14 përqind të transaksioneve të SEKN-së. Ky lloj vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

Gjatë vitit 2009, në SEKN u bënë disa zhvillime teknologjike dhe procedurale. E arritura më e madhe e vitit në SEKN ishte *lansimi i skemës së debitimit direkt*. Me anë të skemës së debitimit direkt ofrohet një mundësi e avancuar e kryerjes së pagesave periodike pa para të gatshme. Skema në tërësi karakterizohet me standardizim dhe automatizim të lartë. Pagesat periodike që mund të kryhen përmes kësaj skeme kanë të bëjnë në radhë të parë me shërbimet e rregullta të lidhura me objekte banimi apo pune si furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, telefonia, ngrohja, mirëmbajtja etj. Shërbimet e këtilla përmes skemës së debitimit direkt mund të paguhet në një mënyrë fare të lehtë për konsumatorët. Me kontraktim të njëhershëm paraprak me kompaninë shërbyese përkatëse, qytetari apo organizata mund të realizojë, çdo muaj në datën e caktuar, pagimin automatik nga llogaria e vet bankare pa autorizime apo veprime plotësuese.

Në vitin 2009 u përgatit *Strategjia e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave me përkrahjen e Bankës Botërore*. Kjo strategji përbëhet nga vizioni dhe plani përkatës i veprimit dhe është e strukturuar sipas nëntë shtyllave: i) korniza ligjore, ii) pagesat me vlera të mëdha dhe ato urgjente, iii) pagesat me vlera të vogla, iv) transaksionet qeveritare, v) letrat me vlerë, vi) tregu monetar, vii) dërgesat nga jashtë, viii) mbikëqyrja e sistemit të pagesave, dhe ix) bashkëpunimi. Si e tillë, kjo strategji është gjithëpërfshirëse dhe është paraparë të implementohet në afat të mesëm.


5.5. Regjistri i kredive

Regjistri i kredive paraqet një shtyllë të veçantë të infrastrukturës financiare kombëtare. Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK), që menaxhohet nga BQK-ja, e ka një rol të ndjeshëm në zhvillimin e sistemit bankar, avancimin e tregut të kredive si dhe promovimin në përgjithësi të stabilitetit financiar në Republikën e Kosovës. Ai në radhë të parë shërben për këmbimin e informacionit kreditor personal mes institucioneve kredidhënëse. Pos bankave dhe institucioneve të tjera kredidhënëse edhe vetë kredimarrësit dhe aplikuesit për kredit si subjekte kreditore mund të sigurojnë informacionin përkatës personal me ndihmën e RKK-së në raste të jashtëzakonshme. Për kryerjen e detyrave zyrtare, RKK-së i qasen edhe mbikëqyrësit e institucioneve kredidhënëse.

Në fund të vitit 2009, në RKK ishin afro 900 mijë shënime kreditore në lidhje me kreditë aktive dhe të shlyera, përkatësisht 25 përqind më shumë krahasuar me një vit më herët. Përderisa numri i institucioneve kredidhënëse mbeti i njëjtë, numri i përdoruesve të tyre individualë arriti në mbi 1 mijë apo u rritë për një të katërtën nga viti paraprak.


Edhe numri i kërtimeve nga ana e institucioneve kredidhënëse për kredimarrës apo aplikues individualë për kredit u rrit për një të tretën krahasuar me vitin paraprak duke arritur në afro 600 mijë. Po ashtu, edhe numri i kërtimeve nga ana e subjekteve kredimarrëse u rrit dukshëm në terma relativë, ndonëse në terma absolutë mbetet nën 1 mijë.

Figura 64. Numri i shënimeve kreditore në fund të vitit, mijëra euro



Burimi: BQK (2010)

Figura 65. Numri i kërtimeve në RKK gjatë vitit, mijëra euro



Burimi: BQK (2010)

Sikurse viteve paraprake që nga lansimi i tij në vitin 2006, edhe gjatë vitit të fundit roli i RKK-së është ngritur dukshëm. Zyra e regjistrat të kredive përpos menaxhimit të sistemit, gjithashtu ka koordinuar zhvillimin e mëtutjeshëm dhe ka monitoruar veprimin sipas kërkesave teknike të stafit përgjegjës të institucioneve kredidhënëse dhe stafit të drejtoratit të mbikëqyrjes bankare. Një sërë takimesh janë mbajtur me institucionet kredidhënëse dhe palët e tjera relevante.

Komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet relevante në vendet evropiane i është kushtuar rëndësi e veçantë gjatë vitit. Pos kontakteve me regjistrat e kredive në regjion dhe më gjerë, janë bërë përgatitjet për anëtarësim në shoqatën e njohur evropiane të regjistrave të kredive - ACCIS (Association of Consumer Credit Information Suppliers). Anëtarësimi do të arrihet në fillim të vitit 2010 dhe do të kontribuojë në avancimet formale dhe funksionale të RKK-së dhe në veçanti në angazhimet drejt integritimit evropian.

5.6. Aktivitetet në fushën e statistikave dhe analizave ekonomike

Viti 2009 u karakterizua me arritje shumëdimensionale si në fushën e statistikave, ashtu edhe atë të analizave ekonomike. Gushti i vitit 2009 ishte i veçantë për funksionin statistikor të BQK-së, sepse menjëherë pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në FMN, u publikuan statistikave monetare dhe financiare të shtetit të Kosovës në publikimin prestigjioz të FMN-së: *International Financial Statistics (IFS)*. Pjesë integrale e këtij suksesi, krahas personelit të përkushtuar dhe profesional, ishte edhe asistencë teknike si dhe trajnimet relevante të ofruara nga ana e institucioneve ndërkombëtare, veçanërisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Viti 2009 paraqet periudhën e zhvillimit akselerues edhe në fushën e statistikave të sektorit të jashtëm. Statistikat e bilancit të pagesave për herë të parë janë përpiluar dhe

publikuar në baza tremujore. Kjo i paraprinë publikimit edhe të këtyre statistikave në IFS në vitin 2010, që njëherësh rrumbullakon funksionin statistikor të BQK-së konform standardeve ndërkombëtare.

Në përputhje me zhvillimet në sektorin bankar në Kosovë dhe standardet ndërkombëtare statistikore dhe me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së statistikave monetare, financiare dhe të bilancit të pagesave, gjatë vitit 2009 janë përgatitur versionet e reja të raportit bankar statistikor, raportit mbi normat e kamatës, dhe sistemit të raportimit të transaksioneve ndërkombëtare. Zbatimi i këtyre projekteve statistikore ka filluar që nga janari 2010.

Në aspektin e analizave ekonomike, viti 2009 u karakterizua me përpilimin e raportit treguesit e shpejtë ekonomikë. Ky është një raport interno, i cili përpilohet në baza mujore me qëllim të informimit të Bordit Drejtues dhe menaxhmentit të BQK-së mbi zhvillimet më të reja ekonomike në vend.

Viti 2009 shënon edhe fillimin e punës në përpilimin e 'modelit makroekonomik'. Përmes këtij modeli synohet krijimi i një kornize në kuadër të së cilës do të mundësohet analizimi dhe parashikimi i zhvillimeve makroekonomike në vend. Viti 2009 karakterizohet edhe me avancimin e mëtejshëm të analizës 'stres-test' të sektorit bankar, si dhe me përpilimin e raporteve dhe analizave të ndryshme interne, që të gjitha këto në funksion të stabilitetit financiar dhe mbështetjes së politikave të përgjithshme ekonomike në vend.

Në kuadër të publikimeve duhet veçuar edicionin jubilar numër 100 të Buletinit Mujor Statistikor. Kjo shënon avancimin e mëtutjeshëm të buletinit në kontekst të volumit dhe cilësisë së statistikave dhe pjesës analitike të publikuara në këtë buletin. Për më tepër, përveç statistikave monetare dhe financiare, dhe statistikave të bilancit të pagesave, është rritur përfshirja e statistikave të sektorit fiskal dhe të sektorit real. Që nga ky edicion, Buletini Mujor Statistikor, së bashku me publikimet tjera të BQK-së publikohet në dizajn të ri.

Në kuadër të publikimeve tjera periodike, gjatë vitit 2009 janë publikuar edhe Buletini i Bilancit të Pagesave dhe Buletini i Sektorit Financiar. Për dallim nga edicionet e kaluara, edicioni i fundit i Buletinit të Bilancit të Pagesave ka pasur një ngritje në cilësi si dhe është publikuar me të dhëna tremujore të bilancit të pagesave. Përveç kësaj, buletini është pasuruar me analiza më gjithëpërfshirëse të zhvillimeve në bilancin e pagesave. Përmirësim në kualitet është shënuar edhe në Buletinin e Sektorit Financiar në kontekst të analizave më cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Ky publikim në vitin 2010 do të avancohet në Raport të Stabilitetit Financiar.

Në vitin 2009 u shënuan përparime edhe në funksionin kërkimor me ç'rast janë publikuar edhe dy punime shkencore, dhe atë: (i) *Përcaktuesit e dërgesave të emigrantëve: rasti i Kosovës* dhe (ii) *Efiçienca e bankave në Evropën Juglindore: me theks të posaçëm në Kosovë*. Viti 2009 karakterizohet edhe me pjesëmarrjen dhe prezantimet e stafit në konferenca dhe seminare të ndryshme, brenda dhe jashtë Kosovës. Duhet veçuar pjesëmarrjen dhe prezantimet e stafit me punime shkencore në konferenca ndërkombëtare në Britani të Madhe dhe Kroaci. Për më shumë, BQK-ja ka organizuar konferencë me rastin e 10 vjetorit të themelimit dhe katër seminare mbi politikat ekonomike, me ç'rast janë shtjelluar tema nga ekspert vendor dhe ndërkombëtar.

6. Zhvillimet e brendshme

6.1. Kontrolli i brendshëm

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin e BQK-së (neni 30), Inspektori i përgjithshëm ka ofruar përmbledhjen e gjetjeve dhe sugjerimeve të tij në raportet prezantuar çdo gjashtë muaj para komitetit të auditimit të Bordit Drejtues të BQK-së.

Zyra e Inspektorit të përgjithshëm përfshin auditimin e brendshëm, kontrollin dhe implementimin e buxhetit dhe analizat operacionale.

Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm, si në vitet paraprake, edhe në vitin 2009 ka vepruar në bazë të planit vjetor të propozuar nga Inspektori i përgjithshëm me aprovimin paraprak nga komiteti i auditimit si organ i pavarur dhe aprovimin final nga Bordi Drejtues.

Auditimi i brendshëm në BQK sikurse edhe vitet e mëparshme edhe për vitin 2009 ka përgatitur planin vjetor të Auditimit konform Standardeve Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit Intern të Institutit të Auditorëve Intern-IIA (Institute of Internal Auditors, Altamonte Springs, Florida, SHBA). Konkretisht, plani vjetor është përgatitur duke u bazuar në këto standarde:

Standardi 1110.A1; Standardi 2010; Standardi 2010.A1; Standardi 2010.C1 dhe të standardit 2020 që ka ky plan vjetor është hartuar në bazë të vlerësimit vjetor të rrezikut, vlerësim ky që identifikon rreziqet dhe i kategorizon ato sipas shkallës së rrezikshmërisë. Plani i bazuar në rrezik përcakton prioritetet e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe është konsistent me qëllimet dhe objektivat e BQK-së

Shkallët e rrezikut përcaktohen në bazë të faktorëve kyç të rrezikut që janë gjasa dhe ndikimi. Nga këta faktorë përcaktohet se sa shpesh duhet kryer aktivitetin e auditimit në aktivitetet apo në veprimtaritë e caktuara të BQK-së, që d.m.th. se aty ku humbja materiale dhe e reputacionit është më e madhe, aty duhet koncentruar më shpesh auditimi. Pra, si përmbledhje e kësaj mund të konstatojmë se rreziku në Bankën Qendrore shërben si pikënisje e auditorit.

Në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe duke marrë në konsideratë humbjet e mundshme materiale dhe të reputacionit të institucionit, auditimet janë kryer në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Fushat në vazhdim janë konsideruar të kenë rrezik më të shprehur:

- Menaxhimi mjeteve (investimet e jashtme)
- Operacionet e parave të gatshme
- Teknologjia informative dhe e sistemeve
- Sistemi i pagesave
- Prokurimet, e kështu me radhë.

Përveç auditimeve të planifikuara, me kërkesë të Guvernatorit dhe Inspektorit të përgjithshëm janë kryer edhe disa auditime 'ad hoc'.

Qëllimi i auditimit të brendshëm është të ekzaminojë, të vlerësojë dhe të raportojë mbi përshtatshmërinë e sistemeve të kontrolleve të brendshme duke bërë sugjerime dhe rekomandime për përmirësime. Në bazë të ekzaminimit dhe vlerësimit të sistemeve të kontrolleve të brendshme, vlerësimit të transaksioneve, dhe verifikimit të përputhshmërisë me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi, auditimi i brendshëm përgatit raporte të shkruara, të cilat përfshijnë përgjigjet e menaxhmentit mbi gjetjet dhe rekomandimet.

Raportet e auditimit të brendshëm pas aprovimit nga Inspektori i përgjithshëm i dorëzohen menaxhmentit dhe Guvernatorit.

Me qëllim të përcjelljes së implementimi të rekomandimeve, auditimi i brendshëm në vazhdimësi azhurnon formën tabelore të përcjelljes së implementimit të rekomandimeve në mënyre kronologjike me të gjitha informacionet relevante. Raportet e tilla përdoren si mjete të transparencës dhe komunikimit për t'i transmetuar nëpërmjet komitetit të auditimit Bordit Drejtues statusin e implementimit të rekomandimeve.

Si aktivitet shtesë, tanimë i pashmangshëm me qëllim të monitorimit të përhershëm të portofolios së investimeve të BQK-së, i kërkuar nga Inspektori i përgjithshëm, është auditimi në baza javore i operacioneve të investimeve në letra me vlerë dhe depozita të afatizuara. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2009, janë përpiluar 52 raporte speciale për përcjelljen e të gjitha investimeve si në tregun e parasë po ashtu dhe në letrat me vlerë. Kësaj fushe i është dhënë rëndësi e veçantë sidomos që nga viti i kaluar për shkak të krizës globale financiare.

Gjatë vitit 2009, auditimi i brendshëm ka vazhduar monitorimin e procesit të rinumërimit të parave për dërgesa jashtë vendit pastaj ka vazhduar me përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të sugjeruara nga auditimi drejtoratit të TI-së lidhur me sistemin mbështetës të jashtëm (ruajtjes së shënimeve).

Në vazhden e zhvillimit profesional të stafit i është kushtuar rëndësi vazhdimësisë se ngritjeve profesionale të gjithë personelit të auditimit të brendshëm përmes ndjekjes së trajnimeve, seminareve ndërkombëtare dhe kombëtare, studimeve post diplomime, si dhe thellimit të kooperimit me bankat qendrore të regjionit dhe institucionet profesionale, si Instituti "IBFI" – në kuadër të Bank de France, CEF në Slloveni, etj., pastaj anëtarësimi në shoqatat e ndryshme ndërkombëtare për Auditim të Brendshëm siç janë: Instituti i Auditorëve të Brendshëm- IIA (Institute of Internal Audit) dhe së fundi anëtarësimi në Shoqatën e Auditimit të Sistemeve Informative dhe Kontrollit-ISACA (Information Systems Audit and Control Association).

6.1.1 Kontrolli, implementimi i buxhetit dhe analizat operacionale

Edhe gjatë vitit 2009, kontrolli dhe implementimi i buxhetit ka kontribuar me punën në atë mënyrë që të behet shfrytëzimi sa më racional dhe efektiv i resurseve në dispozicion dhe në harmoni me buxhetin e aprovuar nga Bordi Drejtues, ngase në implementimin e buxhetit BQK-ja duhet ta ketë për qëllim shfrytëzimin sa më racional dhe më efektiv të resurseve në dispozicion dhe në pajtim me linjat e aprovuara buxhetore.

Kontrolli i implementimit të buxhetit së bashku me analizat operacionale paraqet një vazhdimësi dhe tërësi të pandarë të proceseve dhe punëve të filluar në vitet paraprake, që zhvillohen sot dhe do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen në BQK si një "unazë" shumë me rëndësi në zinxhirin e kontroleve të brendshme të instaluar dhe që veprojnë në kuadër të Zyrës së Inspektorit të përgjithshëm dhe duke u përmbajtur realizimi të objektivave të planit të biznesit për vitin 2007/09 si dhe;

- Është bërë mbikëqyrja dhe aprovimi i shpenzimeve operative dhe kapitale në pajtim me linjat e aprovuara dhe të përcaktuara me buxhet.
- Janë kontrolluar dhe përcjellë gjithashtu të hyrat e realizuara të BQK-së, posaçërisht të hyrat nga interesi në depozitat e afatizuara dhe letrat me vlerë .
- Monitorimi dhe mirëmbajtja e tërësishme shpenzimeve të BQK-së.

Raportet e kontrollit dhe implementimit të buxhetit dhe analizat operacionale janë përgatitur dhe punuar për çdo muaj dhe sipas periudhave në bazë të parimit aktual, ndërsa arritje kualitative janë bërë sa i përket të hyrave ve të BQK-se në

- kontroll/verifikim dhe mbikëqyrje të të hyrave e sidomos e të hyrave që realizohen nga interesi në plasmanët e afatizuara në bankat e jashtme dhe nga letrat me vlerë, si dhe mirëmbajtje dhe evidencë mujore të depozitave të klientëve dhe e plasmanëve të BQK-së në bankat e jashtme/te hyrat dhe shpenzimet e interesit.

Gjatë vitit 2009 është vazhduar me zbatimin e zotuar të objektivave të planifikuara në kontrollin dhe implementimin e buxhetit për periudhën 2007/09 dhe në këtë drejtim janë kryer edhe këto punë:

- përmirësimet dhe shtimi i informatave të dhënave mbi të hyrat dhe shpenzimet në raportet javore, mujore dhe vjetore;
- përcjellja, evidenca e shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare në vend dhe jashtë vendit për secilën njësi, departament dhe drejtoritë veç e veç dhe në tërësi, si dhe krahasimet me periudha javore për mëditjet brenda në vend, si dhe
- përcjellje të veçantë të kontrolleve dhe realizimit të linjave të buxhetuar për ngritje profesionale te stafit, trajnimet në vend dhe jashtë vendit.

6.2. Burimet njerëzore

Burimet njerëzore kkanë vazhduar së zhvilluari në përputhje me objektivat e BQK-së dhe politikat relevante si ajo e trajnimeve, punësimit, kodit të etikës dhe mirësjelljes, sigurimit me kohë të burimeve njerëzore, vlerësimit të performancave pagave dhe beneficioneve. E tërë kjo është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e lartë dhe grupet punuese.

Për të shtuar efektivitetin më të madh të punës burimet njerëzore gjatë vitit 2009 janë siguruar me softuer të avancuar të burimeve njerëzore me një databazë funksionale, e cila ka mundësuar rritjen e sasisë dhe kualitetit të informacionit të menaxhmenti i lartë dhe punëtorët, i cili vazhdimisht përpunohet nga burimet njerëzore.

Në vijim të mbështetjes nga Banka Botërore po zbatohet projekti „Ndihma për BQK-në për vlerësim funksional dhe zhvillimin afatmesëm të planit për punësim dhe shqyrtimi i stimulimit të stafit”. Në zbatim të këtij projekti është bërë identifikimi i objektivave të trajnimit dhe zhvillimit të stafit në përputhje me objektivat strategjike për 2010-2015.

Gjatë vitit 2009 janë shpallur 17 konkurse në gazetate relevante në Kosovë, si dhe në ueb faqe të BQK-s, (në tri gjuhete; shqip, serbishte dhe anglishte). Sipas këtyre shpalljeve janë rekrutuar 16 punëtorë të rinj dhe prej këtyre tre janë me master në universitetet e njohura jashtë vendit, 16 me diplomë universiteti dhe një me shkollë të mesme dhe certifikata të njohura ndërkomtarisht në fushën e teknologjisë informative. Ndërkaq, gjatë këtij viti vetëm një punëtor ka dhënë dorëheqje vullnetarisht.

Gjate vitit 2009 numri mesatar i të punësuarve ka qenë 161, prej tyre 46% femra dhe 54% meshkuj, me moshë mesatare 39 vjeç. Pjesëmarrja e femrave në pozitave menaxheriale në total zë vend 37%, ndërsa meshkuj 63 %.

BQK-ja ka vazhduar të promovohet si punëdhënës me mundësi të barabarta duke zbatuar trajtim korrekt dhe jodiskriminues gjatë punësimit si nga gjinia, mosha, raca, mendimi politik dhe statuset tjera të mbrojtura me ligj.

Shikuar sipas strukturës kualifikuese të punëtorëve, në fund të vitit 2009, rezultojnë të dhëna si më poshtë:

Tabela 26. Struktura kualifikuese e të punësuarve në BQK në fund të vitit 2009

Llojet e kualifikimit	Numri i Strukturave Kualifikuese	Numri Kualifikues i Gjinisë Femrore	Numri Kualifikues i Gjinisë Mashkullore
PhD	1		1
Master	24	9	15
Diplomë Universiteti	66	28	38
Bachelor	26	13	13
Shkollë të lartë	1	1	
Shkollë të mesme	45	23	22
Shkollë fillore	4	3	1
Gjithsej nr. Punëtorëve	167	77	90

Burimi: BQK (2010)

Banka Qendrore e Kosovës, vazhdimisht u ofron mundësi studentëve nga universitetet/kolegjet si nga vendi, ashtu edhe atyre jashtë vendit, mbajtjen e praktikës për studentë në mënyrë që t'u sigurojë atyre mundësi unike për të fituar përvojë pune në fusha të ndryshme të funksioneve dhe operacioneve të BQK-së si dhe ngritje të nivelit më të lartë të universitetit nga teoria në praktike. Gjatë vitit 2009 në BQK me sukses mbaruan praktikën 17 studentë.

Gjithashtu, BQK-ja vazhdimisht është e angazhuar që t'u sigurojë punëtorëve të saj mundësi për të fituar njohuri të mjaftueshme, aftësi dhe ekspertizë relevante për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me standardet më të larta për arritjen e potencialit të plotë të tyre përmes trajnimeve, kurseve, seminareve, shkollimeve akademike dhe pasakademike duke përkrahur edhe financiarisht zhvillimin e stafit. Krahas përkrahjes me mjete vetanake, BQK-ja, për këto qëllime, ka gëzuar edhe përkrahje të konsiderueshme nga Banka Botërore.

Gjatë vitit 2009 stafi i BQK-së ka ndjekur trajnime jashtë vendit, gjithsej 367 ditë pune me gjithsej 62 trajnime të ndjekura dhe 76 persona të trajnuar, kryesisht në IMF - Joint Vienna Institute, Bankën Qendrore Evropiane, Deutsche Bundesbank, Bankën e Francës, Bankën Nacionale Austriake, Federal Reserves Bank të New Yorkut, Bankën e Anglisë, Bankën e Holandës, Bankën e Çekisë, Toronto Center etj.

Kryesisht, trajnimet e ndjekura nga stafi kanë të bëjnë me fushat si vijon: Macroeconomic Modeling and Forecasting II Balance of Payments Statistics, Risk Focused Supervision and Risk Assessment. Fight against financial delinquency and Money Laundering, Banking Leadership program, Payment Systems, Financial Derivatives and Reserve Management, Legal Aspects of International Financial Institutions, Banking Supervision under Basel II, Financial Stability in Central European Economics, Instruments of Financial Markets, Internal Audit and risks management in a Central Bank, Risk Based IT Audit, CISA, The Basel Capital Accord for Banks etj.

6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Gjatë vitit 2009, aktiviteti ligjor i BQK-së është përqendruar në zhvillimin dhe avancimin e kornizës rregullative-ligjore në funksion të përmbushjes së objektivave dhe kompetencave të BQK-së në pajtim me legjislacionin në fuqi. Gjatë këtij viti janë bërë zhvillime të dukshme në drejtim të avancimit të kornizës ligjore të BQK-së dhe harmonizimit të saj në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare dhe kornizën ligjore të Unionit Evropian. Kështu, me asistencën teknike të ofruar në vazhdimësi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar si dhe Banka Botërore gjatë këtij viti janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme në drejtim të nxjerrjes së ligjeve të parapara në strategjinë ligjore të BQK-së. Në bashkëpunim me FMN-në është hartuar draftligji i ri për Bankën Qendrore, ku janë përfshirë të gjitha elementet e nevojshme të legjislacionit modern të bankave qendrore e që konsiderohet të jetë një hap para drejt integritimit evropian. Ky ligj pritet të aprovohet gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu, janë bërë përgatitjet e nevojshme për plotësimin e kornizës ligjore edhe në drejtim të nxjerrjes së ligjeve tjera nga lëmi i sistemit financiar të cilat do të kompletojnë kornizën ligjore për ndërtimin dhe zhvillimin e sistemit financiar në Kosovë.

Për më tepër, me qëllim të funksionimit në mënyrë sa më efektive të sistemit financiar, aktiviteti ligjor i BQK-së ka vazhduar edhe me nxjerrjen dhe harmonizimin e akteve nënligjore, marrëveshjeve bashkëpunimi me institucionet vendëse dhe të huaja si dhe me aktivitete tjera duke ndikuar në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në Kosovë.

Aktiviteti ligjor dhe harmonizimi me standardet ndërkombëtare dhe të drejtën e EU-së gjatë gjithë kohës ka qenë i orientuar jo vetëm në modernizimin e infrastrukturës ligjore të BQK-së në hap me zhvillimet më të reja, por gjithashtu edhe në implementimin adekuat të saj në praktikë në përputhje me standardet më të larta të përgjegjësisë dhe të transparencës. E tërë kjo ka ndikuar në zhvillimin dhe ruajtjen e një sektori financiar stabil, të sigurt dhe konkurrues.

7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë në vazhdimësi paraqitet si një komponentë e rëndësishme e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. I nxitur edhe nga kriza globale financiare, viti 2009 u karakterizua me një aktivitet të shtuar midis akterëve në sektorin financiar. Edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nuk ishte e shkëputur nga këto aktivitete, edhe pse pak e ndikuar nga kjo krizë, ajo morri masat e nevojshme preventive për parandalim të ndikimit të krizës. Përgjatë vitit 2009 shumë ekspertë ndërkombëtarë vizituan BQK-në, por edhe shumë ekspertë dhe menaxherë të BQK-së ishin në udhëtime jashtë vendit me qëllim të përmirësimit të proceseve të BQK-së në mënyrë që të jenë më efikasë dhe në shërbim të përmirësimit të sistemit financiar të Kosovës.

Vitin 2009 e karakterizoi edhe shënimi i përvjetorit të 10-të të themelimit të BQK-së, me ç'rast në konferencën dyditore të mbajtur për këtë përvjetor morën pjesë shumë delegacione nga vende të ndryshme të rajonit, Evropës dhe më gjerë. Në këtë kontest, duhet cekur veçanërisht pjesëmarrjen katër e ish drejtorëve të përgjithshëm ndërkombëtarë të BQK-së. Krahas drejtorëve të përgjithshëm të BQK-së, të cilët ishin pjesë domethënëse e zhvillimit të sistemit financiar të Kosovës, në këtë përvjetor të pranishëm ishin shumë personalitete të tjera të larta vendore dhe ndërkombëtare përfshirë këtu Presidentin e Kosovës, Kryekuvendarin, Kryeministrin, Ministrin e MEF-it, anëtarë të komitetit për ekonomi dhe financa, ambasadorë, diplomatë e përfaqësues të institucioneve të ndryshme financiare vendore e ndërkombëtare. Në këtë kontekst vlen të ceket pjesëmarrja edhe e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë si dhe Kryetari i Agjencisë së Rregullimit dhe Mbikëqyrjes Bankare të Turqisë. Ndërsa për ta shënuar këtë ngjarje të pranishëm kanë qene edhe ambasador të vendeve të ndryshme ndër të cilët edhe ambasadori i ShBA-ve.

Gjatë vitit 2009 BQK-në e vizituan delegacione të ndryshme ndërkombëtare si përfaqësuesit e Autoritetit të Tregut Financiar (Financial Market Authority – FMA) dhe të Bankës Kombëtare të Austrisë (Österreichische Nationalbank OeNB), me ç'rast është diskutuar për bashkëpunim në fushën e mbikëqyrjes financiare si dhe ofrimit të ndërsjellë të informatave.

Më pas në selinë qendrore të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në Londër, janë zhvilluar punimet e konferencës vjetore të kësaj banke, në të cilën përveç përfaqësuesve të 62 vendeve të botës, në cilësinë e mysafirëve special morri pjesë edhe Guvernatori i BQK-së-së. Përveç sesioneve të ndryshme në të cilat Guvernatori i BQK-së ka marrë pjesë ai ka qenë i pranishëm edhe në mbledhjen e Bordit të guvernatorëve të kësaj banke.

Në takimin pranveror të FMN-së ka marrë pjesë Guvernatori i BQK-së me delegacion me ç'rast ka realizuar disa takime me zyrtarë të lartë të FMN-së, si me zv.drejtorin menaxherial të FMN-së, me drejtorë ekzekutivë të shumë shteteve anëtare të FMN-së, si dhe me zyrtarë të Bankës Botërore. Takime tjera janë zhvilluar edhe me zv.presidentin e Bankës Botore për Euroazi, zyrtarin nga departamenti i shtetit dhe me zyrtarë të USAID-it, etj. Pastaj, Guvernatori i BQK-së ka marrë pjesë edhe në Forumin e 6-të Ekonomik të Vjenës, respektivisht në sesionin e tretë – sesion ky i guvernatorëve dhe bankierëve si dhe në konferencën me titull “20 vjet pas kolapsit të ekonomisë socialiste, transformimit, zhvillimit ekonomik dhe konvergencat në Poloni dhe në vendet tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore” në Varshavë, me ç'rast Guvernatori pati një takim të ndarë edhe me z. Trichet, president i Bankës Qendrore Evropiane. Gjithashtu Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Bankën për zhvillim të Gjermanisë KfW, Shoqatën e

Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK) , Shkollën e Frankfurtit për Financa dhe Menaxhment (EFSE) dhe më pjesëmarrjen e përfaqësuesit nga Bankat Komerciale të Kosovës dhe të institucioneve tjera relevante financiare kanë mbajtur konferencën njëditore me temën: “Financimi i Përgjegjshëm në Kosovë “.

Gjatë vitit 2009, Guvernatori i Bankës Qendrore të Luksemburgut qëndroi për vizitë në BQK-me ç’rast edhe u nënshkrua një marrëveshje për bashkëpunim reciprok midis dy institucioneve. Gjithashtu BQK-në e ka vizituar edhe ambasadori austriak në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovë përgjatë vitit 2009 ka punuar në drejtim të anëtarësimit në organizata, institucione e shoqata të ndryshme ndërkombëtare. Në këtë kontekst doemos duhet përmendur kontributin aktive të BQK-së në përshejtimin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore (qershor 2009).

7.1. Marrëveshjet ndërkombëtare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me qëllim të lehtësimit të relacioneve me institucionet e ndryshme financiare ka ndërmarrë iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve me vendet e ndryshme të rajonit por edhe më gjerë. Në vitin 2009 BQK ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me institucionet si në vijim:

Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) - me të cilën është bërë plotësimi i Memorandumit të Mirëkuptimit(MM) ekzistues që ka të bëjë me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve nga fusha financiare, e sigurimeve, pensioneve dhe fushave tjera relevante për palët e përfshira në këtë MM.

Bankën Qendrore të Luksemburgut – Marrëveshje Mirëkuptimi në lëmin e menaxhimit të mjeteve, trajnimeve si dhe të ndihmës teknike.

8. Pasqyrat financiare të BQK-së



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

PASQYRA PËRMBLEDHËSE

FAQJA

Pasqyra e gjendjes financiare	1
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5 - 40



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Auditorëve të Pavarur

Bordit Drejtues të
Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 19 maj 2010

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës ("Banka"), të cilat përbëhen nga paqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2009, pasqyra përmbledhëse e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Manaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm, për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tone. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga manaxhmenti, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2009, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Theksimi i Çështjes

Pa dhënë rezervë në opinion, ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4(f) të pasqyrave financiare ku cilësohet se sipas Ligjit Nr. 03/L-074 për Bankën Qëndrore të Republikës së Kosovës, Kapitali dhe Llogaritë e Rezervave të Përgjithshme duhet të jenë së paku të barasvlefshme me pesë për qind të shumës totale të gjendjeve kreditore të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e Bankës në fund të çdo viti financiar. Më 31 dhjetor 2009 dhe 2008 kjo kërkesë nuk ishte përmbushur.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k – Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës


Pasqyra e gjendjes financiare

Më 31 dhjetor


<i>Në mijë Euro</i>	Shëni mi	2009	2008
Aktivët			
Paraja e gatshme	7	21,806	39,674
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,899	10,403
Bono thesari	9	529,652	541,019
Depozita me bankat e huaja	10	487,529	519,276
Aktive në Fondin Monetar Ndërkombëtar ("FMN")	11	124,482	-
Aktive afatgjata materiale	12	2,115	2,087
Aktive afatgjata jo-materiale	13	174	86
Aktive të tjera	14	351	406
Gjithsej aktivët		<u>1,201,008</u>	<u>1,112,951</u>
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave vendase	15	233,246	137,158
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	124,786	-
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	665,187	908,212
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	130,847	24,400
Detyrime të tjera vendase	19	2,019	1,978
Gjithsej detyrimet		<u>1,156,085</u>	<u>1,071,748</u>
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali	20	30,000	30,000
Rezerva të përgjithshme	21	14,923	11,203
Gjithsej kapitali dhe rezervat		<u>44,923</u>	<u>41,203</u>
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		<u>1,201,008</u>	<u>1,112,951</u>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare nga faqja 1 deri në faqen 40 u miratuan nga menaxhmenti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në 24 mars 2010 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Hashim Rexhepi
Guvernator



Gani Gerguri
Zëvendësguvernator

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë Euro</i>	Shëni mi	2009	2008
Të ardhura nga interesi		6,629	42,841
Shpenzime për interes		(2,500)	(34,063)
Të ardhura nga interesi, neto	22	<u>4,129</u>	<u>8,778</u>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		2,462	884
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(269)	(215)
Të ardhura nga tarifa dhe komisione, neto	23	<u>2,193</u>	<u>669</u>
Të ardhura nga grantet	24	24	85
Të ardhura operative të tjera	25	<u>1,340</u>	<u>1,087</u>
Të ardhura operative të tjera		<u>7,686</u>	<u>10,619</u>
Shpenzime personeli	26	(2,160)	(1,771)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(505)	(458)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	27	(998)	(923)
Shpenzimet operative		<u>(3,663)</u>	<u>(3,152)</u>
Fitimi për vitin		<u>4,023</u>	<u>7,467</u>
Te ardhurat/(humbjet) e përmbledhura të tjera:		(303)	-
Gjithsej te ardhurat e përmbledhura për periudhën		<u>3,720</u>	<u>7,467</u>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva

<i>Në mijë EUR</i>	Kapitali i autorizuar	Rezerva të përgjithshme	Fitim i pashpërndarë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2008	20,000	4,590	9,146	33,736
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën				
Fitimi ose humbja	-	-	7,467	7,467
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën	-	-	7,467	7,467
Transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet				
Transferime në kapital të autorizuar	10,000	(854)	(9,146)	-
Gjithsej bartja në kapitalin e autorizuar	10,000	(854)	(9,146)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2008	30,000	3,736	7,467	41,203
Gjendja më 1 janar 2009	30,000	3,736	7,467	41,203
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën				
Fitimi ose humbja	-	-	3,720	3,720
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën	-	-	3,720	3,720
Transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet				
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	7,467	(7,467)	-
Gjithsej bartja në rezervën e përgjithshme	-	7,467	(7,467)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2009	30,000	11,203	3,720	44,923

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimi	2009	2008
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi për periudhën		3,720	7,467
<i>Rregullime për:</i>			-
Zhvlerësimi	12	444	378
Amortizimi	13	61	80
Të ardhura nga grantet	24	(24)	(85)
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(11)	(5)
Të ardhura nga interesi	22	(6,629)	(42,841)
Shpenzime për interes	22	2,500	34,063
		61	(943)
Ndryshime në bono thesari		(15,959)	(145,749)
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		(61,824)	197,908
Ndryshime në aktive me FMN		(124,458)	-
Ndryshime në aktive të tjera		31	(111)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave vendase		96,088	23,604
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN		124,761	-
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		(243,129)	51,482
Ndryshime në detyrimet ndaj entiteve tregtare dhepublike		106,648	(23,835)
Ndryshime në detyrimet e tjera vendase		32	(5,717)
		(117,749)	96,639
Interesa të marra		9,160	47,329
Interesa të paguara		(2,574)	(34,209)
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet operacionale		(111,163)	109,759
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Shitja e aktiveve afatgjata materiale		11	5
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	12	(472)	(357)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	13	(149)	(44)
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet investuese		(610)	(396)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Grante të marra	24	33	36
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet financuese		33	36
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		(111,740)	109,399
Diferencat nga kursi i këmbimit		(303)	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		730,878	621,479
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	28	618,835	730,878

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Subjekti i parë paraardhës i BQK-së – Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është themeluar në përputhje me dispozitat e Rregullores nr: 1999/20 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (nga këtu e tutje "UNMIK") të miratuar më 15 nëntor 1999, ndryshuar më 1 tetor 2001 (Rregullorja nr. 2001/24 e UNMIK-ut). Më 24 gusht 2006 hyri në fuqi një rregullore e re (Rregullorja nr. 2006/47 e UNMIK-ut) e cila transformoi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Më 5 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar bazuar në një treg të qëndrueshëm, duke inkurajuar krijimin e instrumenteve të sigurta financiare; dhe
- të mbështesë, pa ndonjë paragjykim, politikat e përgjithshme ekonomike në Kosovë për të kontribuar në një shpërndarje efikase të burimeve në përputhje me parimin e ekonomise së tregut të hapur.

Midis te tjerash, BQK ka këto kompetenca:

- t'i rekomandojë politika të gjera udhëzuese kuvendit dhe qeverisë në fushat që janë nën përgjegjësinë e saj;
- të vendosë dhe të zbatojë masat, të mbikëqyrë dhe rregullojë sistemet e pagesave për transaksionet në valutën vendase dhe të huaj në Kosovë;
- të zotërojë dhe operojë një ose më shume sisteme pagesash;
- të veprojnë si agjent bankar për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të japë këshilla financiare me kërkesë të saj;
- të veprojnë si agjent fiskal për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- të mbajë depozita në valutë të huaj për bankat, për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, si dhe për subjektet e tjera publike;
- të sigurojë furnizim të mjaftueshëm të bankënotave dhe monedhave për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme;
- të mbajë thesar për ruajtjen e sigurt të monedhave dhe letrave me vlerë;
- të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;
- të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i bëjë publike rezultatet dhe t'i paraqesë propozime e masa Kuvendit dhe Qeverisë në bazë të këtyre analizave;
- të mbikëqyrë dhe rregullojë agjentët e shitjes në këmbimin e valutave, komisionerët-agjentët, dhe fondet e përbashkëta;
- të miratojë auditorët e jashtëm të institucioneve financiare; dhe
- të vendosë standardet e kontabilitetit për institucionet financiare në Kosovë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Subjekti raportues (në vazhdim)

BQK ushtron veprimtarinë e saj nga zyrat e saj qendrore në Prishtinë. Adresa zyrtare e BQK është si më poshtë:

Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

Bordi drejtues

Bordi drejtues formulon politikat operacionale të BQK-së dhe mbikëqyr realizimin e tyre. Menaxhmenti i BQK-së duhet të raportojnë tek Bordi drejtues, jo më pak se dhjetë herë në vit, për zhvillimin e operacioneve dhe politikave, për qëndrueshmërinë e sistemit financiar, për gjendjen e tregjeve të parasë, të kapitalit dhe të valutave, duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe kushtet që kanë ose pritet të kenë ndikime të rëndësishme në administrim ose në operacione të BQK-së, në drejtimin e politikave të saja, në sistemin financiar ose në tregjet e përmendura më parë dhe në çdo çështje tjetër që ndikon ose mundet të ndikojë politikat e BQK-së.

Bordi drejtues përcakton politikat për operacionet e BQK dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Sipas Ligjit nr. 03/L-074, Bordi drejtues përbëhet nga pesë anëtarë. Bordi drejtues ka këto kompetenca:

- të miratojë politikat për përmbushjen e kompetencave të BQK-së dhe të mbikëqyr zbatimin e tyre nga menaxhmenti dhe stafi;
- të miratojë të gjitha rregullat, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga BQK-ja;
- të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BQK-ja ia paraqet Kuvendit dhe Qeverisë;
- të caktojë me vendim së paku dy drejtorë joekzekutiv në përbërjen e Komitetit të auditimit;
- të miratojë organizimin e BQK-së;
- të caktojë dy Zëvendës Guvernatorë me propozim të Guvernatorit për mandat deri në pesë vite;
- të miratojë caktimin e inspektorit të përgjithshëm të BQK-së për mandat deri në pesë vite;
- të miratojë buxhetin e BQK-së;
- të miratojë politikat e kontabilitetit të BQK-së dhe raportet periodike bashkë me gjendjen financiare të BQK-së;
- të vendosë për borxhet e BQK-së në shuma materiale, për afatet dhe kushtet e këtij borxhi;
- të miratojë kategoritë e të hyrave që do të jenë të përshtatshme për investime të resurseve financiare të BQK-së;
- të miratojë apo refuzojë kërkesat për licencë apo regjistrim të institucionit financiar dhe të anulojë licencën ose regjistrimin e institucionit financiar;
- të miratojë strukturat, politikat dhe procedurat e brendshme për licencim, regjistrim, mbikëqyrje dhe rregullim financiar duke përfshirë edhe kompetencat që i delegohen stafit të BQK-së për ndërmarrjen e veprimeve korrektuese; dhe
- të miratojë para zbatimit të tyre të gjitha masat detyruese të përgatitura nga stafi i BQK-së, me përjashtim të atyre që veçanërisht janë në kompetencë të Guvernatorit me ligj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Subjekti raportues (në vazhdim)

Bordi drejtues (në vazhdim)

Më 31 dhjetor 2009, Bordi drejtues i BQK-së përbëhej nga këta anëtarë:

- Gazmend Luboteni – Kryetar i Bordit
- Hashim Rexhepi – Guvernator
- Lulzim Ismajli – Anëtar, Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- Sejdi Rexhepi – Anëtar
- Mejdin Bektashi – Anëtar

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro (“EUR”), e cila është monedha funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Euro është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti i Bankës që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, në shënimin 5 jepet informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare.

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj vlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të tregut rivlerësohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e tregut. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

BQK-ja vepron kryesisht në Euro, ndërsa nga valutat e huaja BQK vepron kryesisht në të drejta të veçanta tërheqjeje (SDR) dhe në dollarin amerikan (USD). Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për rivlerësim më 31 dhjetor 2009 dhe 2008 paraqiten si më poshtë:

	2009 Euro	2008 Euro
1 USD	0.694	0.718
1 SDR	0.918	n/a

b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër kur është e përshtatshme) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet a paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuara mbi bazën e interesit efektiv.

c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, transferimet e fondeve dhe tarifat e licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

d) Përfitimet e punonjësve

i. Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

BQK paguan kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve me kontribute të definuara bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Gjithashtu, BQK-ja njih kontribute fikse të pagueshme në fonde pensionesh jashtë BQK-së. Norma e kontributeve shtesë është 10% e pagës bruto. Këto shuma njihen si shpenzime kur ato ndodhin. BQK-ja nuk ka ndonjë detyrim ligjor apo të tërthortë të paguajë kontribute të tjera.

ii. Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten mbi baza të pazbritshme (sipas vlerës së parasë në kohë) dhe njihen si shpenzime kur shërbimi kryhet.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-074 miratuar më 5 qershor 2008, i cili kërkon që BQK të paguajë tepicën e të ardhurave neto direkt në llogarinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, pasi të ketë plotësuar nivelet e fondeve rezervë (shiko shënimin 4 f).

f) Aktivitet dhe detyrimet financiare

i. Njohja

BQK-ja fillimisht njih depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

ii. Çregjistrimi (Mosnjohja)

BQK-ja çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë që vijnë nga aktivitet financiar, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi aktivitet financiar përmes një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitet financiar. Interesat në aktivitet financiar të transferuar të cilat janë krijuar apo mbajtur nga BQK-ja njihen si një aktiv apo detyrim i veçantë.

BQK-ja çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

iii. Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma paraqitet neto në pasqyra atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivitet dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Aktivitet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

v. Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së tregut të një aktivi ose detyrimi financiar përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të vlerës aktuale, metodën e rrjedhjes së parave të skontuar, krahasime me instrumente të tjera të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu lehtësisht të vëzhgueshme, dhe modele vlerësimi. BQK-ja përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së tregut të instrumenteve më të zakonshme dhe me të thjeshta. Për këto instrumente financiare, të dhënat e përfshira në modele janë të vëzhgueshme në treg.

vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi BQK vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e tregut përmes pasqyrës së të ardhurave ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja nuk do t'i kishte konsideruar, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivësh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me sjelljen e vështirësive financiare në BQK.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të vlerësuara të parave që skontohen me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizjoni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, llogari rrjedhëse me bankat dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiar me kosto të amortizuar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

h) Letra me vlerë

Letrat me vlerë që mbahen për investim njihen fillimisht me vlerën e tregut plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim trajtohen si investime që mbahen deri në maturim.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks, të cilat BQK-ja ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në raste të shitjes ose riklasifikimit përpara maturimit të një sasive të konsiderueshme të letrave me vlerë që mbahen deri në maturim do të rezultojë riklasifikimi i të gjitha letrave me vlerë që mbahen deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte BQK-në të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

i) Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimit të ambientit ku ato janë vendosur. Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij aktivi të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të perdritshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

i) Aktive afatgjata materiale (në vazhdim)

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

	2009	2008
• Investimet në objektet me qira	20 vjet	20 vjet
• Pajisjet	5 vjet	5 vjet
• Kompjuterë	3 vjet	3 vjet
• Automjete	5 vjet	5 vjet

Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

j) Aktive afatgjata jo-materiale

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 3 vjet (2008: 3 vjet).

k) Rënia në vlerë

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie të vlerës së tij. Një aktiv financiar konsiderohet i përkeqësuar nëse ekziston evidencë objektive që një ose më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në rrjedhjet e përlllogaritura të ardhshme të parasë nga ky aktiv.

Humbjet nga rënia në vlerë e aktivit financiar, të mbajtur me koston e amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të përlllogaritura të ardhshme të parasë të skontuara me normën e interesit efektiv fillestar të aktivit financiar.

Rënia në vlerë e aktiveve financiare, të cilat janë të rëndësishme individualisht, vlerësohet në bazë individuale për secilin aktiv. Aktivet financiare, të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, vlerësohen në mënyrë kolektive të ndara në grupe me karakteristika ngjashme **te rreziqeve kreditore**.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

k) Rënia në vlerë (në vazhdim)

(i) Aktivitetet financiare (në vazhdim)

Humbjet nga rënia në vlerë të aktivitetit financiar do të njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Nëse humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit financiar ulet dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje pasi është njohur rënia në vlerë, humbja nga rënia në vlerë e njohur më parë duhet të anulohet. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara anulimi i rënies në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse të parasë që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis aktiveve të tjera të njësive për të zvogëluar vlerën kontabël të tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontohej në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

l) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe të tjera financiare. Ato fillimisht maten me kostot e transaksionit dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

m) Të ardhurat nga grantet

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aktivi njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të aktivitetit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

n) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtarë të caktuar dhe financuar për një afat të shkurtër nga organizata ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin edhe pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtarë. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në pasqyrat financiare.

o) Provizionet

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e skontuar rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme rreziqet specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis kostos së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e aktivitetit të lidhur me atë kontratë.

p) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Një sërë standardesh të reja, ndryshime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive ose të relevante për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2009, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- Rishikimi i SNRF 2 *Pagesat e Bazuara në Aksione* – Transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për t'u shlyer në mjete monetare brenda grupit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2010 ose më pas). Ky standard i rishikuar kërkon që një njësi ekonomike e cila merr mallra ose shërbime nëpërmjet pagesave bazuar në aksione që janë shlyer në mjete monetare ose aktive të tjera nga një njësi tjetër ekonomike brenda grupit ose nga një pronar i kësaj njësie ekonomike, të njohë mallrat ose shërbimet e përfituara në pasqyrat financiare. Më parë transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për t'u shlyer në mjete monetare brenda grupit nuk adresoheshin direkt në SNRF 2. Rishikimet e SNRF 2 nuk janë relevante për pasqyrat financiare të BQK-së sepse BQK-ja nuk ka një plan kompensimi me pagesa bazuar në aksione.
- Rishikimi i SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2009 ose më pas). Objekti i standardit të rishikuar ka ndryshuar dhe përkufizimi i biznesit është zgjeruar. Standardi i rishikuar përfshin gjithashtu një numër ndryshimesh të tjera duke përfshirë:
 - Të gjithë elementët e shumës së paguar nga blerësi njihen dhe maten me vlerën e drejtë në datën e blerjes, duke përfshirë shumat e kushtëzuara.
 - Ndryshime të mëtejshme në shumat e kushtëzuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.
 - Kostot e transaksionit, përveç kostove të emetimit të aksioneve dhe instrumenteve të borxhit, do të njihen kur ndodhin.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

p) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

- Blerësi mund të zgjedhë të masë interesat e pakicës me vlerën e drejtë në datën e blerjes (emri i mirë i plotë), ose interesin e tij proporcional në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të identifikuar të shitësit, mbi bazë transaksion pas transaksioni.

Ky standard nuk është relevant për pasqyrat financiare të BQK.

- SNRF 9 *Instrumentat Financiare* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas, aplikimi i hershëm është i lejuar). Ky standard zëvendëson udhëzimet në SNK 39, *Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja*, në lidhje me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Standardi eliminon kategoritë ekzistuese në SNK 39 për aktivet financiare të mbajtur deri në maturim, të gatshëm për shitje dhe hua dhe të arkëtueshme.

- Aktivet financiare do të klasifikohen në njërin nga dy kategoritë në njohjen fillestare:
- Aktive financiare të matur me koston të amortizuar ose aktive financiare të matur më vlerën e drejtë.

Një aktiv financiar mund të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: aktivi mbahet brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukset monetare sipas termave kontraktuale; dhe, sipas termave kontraktuale rrjedhin flukse monetare në data të përcaktuara që janë pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar në fund të periudhës.

Fitimet ose humbjet nga rimatja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë njihen në fitim ose humbje, përveç rastit të një instrumenti investimi në kapital që nuk është mbajtur për tu tregtuar, për të cilin SNRF 9 parashikon një zgjedhje definitive në njohjen fillestare për të paraqitur të gjitha ndryshimet nga vlera e drejtë e investimit në të ardhura të tjera përmbledhëse. Zgjedhja është e disponueshme në bazë të çdo aksioni individual. Asnjë shumë e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse nuk mund të riklasifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme. BQK është duke përcaktuar ndikimkin që do të ketë ky standard në aktivitetet e saj.

- Rishikimi i SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për Palët e Lidhura* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2011 ose më pas). Rishikimi përjashton njësitë ekonomike të lidhura me qeverinë nga kërkesat për dhënie të informacioneve shpjeguese në lidhje me transaksionet dhe gjendjen në fund të periudhës për palët e lidhura, duke përfshirë angazhimet me (a) një qeveri e cila ka kontroll, kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi njësinë ekonomike raportuese; dhe (b) një njësi tjetër ekonomike e cila është palë e lidhur sepse e njëjta qeveri ka kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të dyja, njësinë ekonomike raportuese dhe njësinë tjetër. Standarti i rishikuar kërkon dhënie të informacioneve shpjeguese specifike nëse një njësi ekonomike përdor avantazhin e këtij përjashtimi.

Standarti i rishikuar gjithashtu zgjeron përkufizimin e palëve të lidhura e cila rezultoi në përfshirjen e marrëdhënieve të tjera, të tilla si, ortakët e aksionerit që ka kontrollin dhe njësitë ekonomike të kontrolluara ose në kontroll të përbashkët nga personeli drejtues kryesor. BQK është duke përcaktuar ndikimkin që do të ketë ky standard në aktivitetet e saj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

p) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

- Rishikimi i SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2009 ose më pas). Në standardin e rishikuar shprehja interes i pakicës është zëvendësuar me interes jo-kontrollues, dhe është përcaktuar si “kapitali në një filial që nuk i atribuohet në mënyrë direkte ose të tërthortë shoqërisë mëmë”. Standardi i rishikuar gjithashtu ndryshin kontabilizimin për interesat jo-kontrollues, humbjen e kontrollit në një filial, dhe alokimin e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse ndërmjet interesave kontrollues dhe jo-kontrollues. Rishikimi i SNK 27 nuk është relevant për aktivitetin e BQK-së.
- Rishikimi i SNK 32 *Instrumentet Financiarë: Paraqitja – Klasifikimi i të Drejtave* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Shkurt 2010 ose më pas). Rishikimi kërkon që të drejtat, opsionet ose garancitë për blerjen e një numri të caktuar të instrumentave të kapitalit të vetë shoqërisë për një shumë të caktuar në çfarëdo monedhe, të njihen si instrumenta kapitali nëse shoqëria ia ofron të drejtat, opsionet ose garancitë në mënyrë proporcionale të gjithë pronarëve ekzistues të së njëjtës kategori të instrumentave jo-derivativë të kapitalit të vet. Rishikimet e SNK 32 nuk janë relevante për aktivitetin e BQK-së.
- Rishikimi i SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja – Elementët e Mbrojtur të Pranueshëm* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2009 ose më pas). Standardi i rishikuar sqaron aplikimin e parimeve ekzistuese që përcaktojnë nëse rreziqe specifike ose pjesë të flukseve monetare janë të pranueshëm të përcaktohen në një marrëdhënie mbrojtje “hedging”. Në përzgjedhjen e një marrëdhënie mbrojtje rreziqet duhet të jenë të identifikueshëm në mënyrë individuale dhe të matshëm me besueshmëri; megjithatë inflacioni nuk mund të përzgjidhet, përveç në rrethana të kushtëzuara. Rishikimet e SNK 39 nuk janë relevante për aktivitetin e BQK-së sepse BQK nuk e aplikon kontabilitetin mbrojtës.
- SNRF 17, *Qeraja* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2010 ose më pas). SNRF 17 ka ndryshuar duke mos përfshirë paragrafin 14, sipas të cilit një qeraja e një toke me jetëgjatësi të papërcaktuar do të klasifikohet normalisht si qeradhënie operative nëse në fund të periudhës së qeradhënies titulli i pronësisë transferohet tek qeramarrësi. Sipas rishikimit, qeraja e një toke me një jetëgjatësi prej disa dekadash ose më shume mund të klasifikohet si qeradhënie financiare edhe nëse në fund të jetëgjatësisë së kontratës së qeradhënies titulli i pronësisë nuk transferohet tek qeramarrësi, për arsye se në të tilla marrëveshje të gjitha rreziqet dhe shpërblimet i transferohen qeramarrësit the vlera aktuale e vlerës së mbetur të aktivitetit të dhënë me qera konsiderohet e papërfillme. Rishikimet nuk janë relevante për aktivitetin e BQK-së.
- Rishikimi i KIRFN 14 *SNK 19 – Limiti i një Aktivi për Përfitime të Përcaktuara, Kërkesat Minimale për Financim dhe Bashkëveprimi i tyre* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2011 ose më pas). Rishikimi i KIRFN 14 adreson trajtimin kontabël për parapagimet e bëra kur ka një kërkesë për minimumin e financimeve (KMF). Sipas rishikimit, një njësi ekonomike është e detyruar që të njohë disa parapagime si aktive me kushtin që njësi ekonomike të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga parapagimi në formën e flukseve monetare të reduktuara në të ardhmen ndërkohë që do të kërkoheshin pagesa për financim. Rishikimet nuk janë relevante për aktivitetin e BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

p) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

- KIRFN 17 *Shpërndarja e Aktiveve jo-monetare Pronarëve* (efektive në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 15 Korrik 2009 ose më pas). Interpretimi aplikohet për shpërndarjen jo-reciproke të aktiveve jo-monetare ndaj pronarëve që veprojnë në kapacitetin e tyre si pronarë. Në përputhje me interpretimin, një detyrim për të paguar dividend duhet të njihet kur dividendi është autorizuar siç duhet dhe duhet të matet me vlerën e drejtë të aktiveve që do të shpërndahen. Vlera kontabël e dividendit të pagueshëm duhet të vlerësohet në çdo datë raportimi, dhe ndryshimet në vlerën kontabël të njihen në kapital si korigjim i vlerës për shpërndarje. Kur dividendi i pagueshëm shlyhet, diferenca (nëse ka) midis vlerës kontabël të aktiveve të shpërndara dhe vlerës kontabël të dividendëve të pagueshëm do të njihet në fitim ose humbje. Rishikimi nuk është relevant për aktivitetin e BQK-së.
- KIRFN 19 *Heqja e Detyrimeve Financiare me Instrumentat e Kapitalit* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2010 ose më pas). Interpretimi sqaron se instrumentat e kapitalit të emetuara për një kreditor për të hequr të gjithë ose pjesërisht detyrimin financiar për një 'borxh për kapitalin sëap' konsiderohen të paguara sipas SNK 39.41. Matja fillestare e instrumentave të kapitalit të emtuar për të hequr një detyrim financiar bëhet me vlerën e drejtë e këtyre instrumentave, përveç nëse vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri, dhe në këtë rast instrumenti i kapitalit duhet të matet për të reflektuar vlerën e drejtë të detyrimit financiar të hequr. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar (ose pjesë e detyrimit financiar) të hequr dhe matjes fillestare të instrumentit të kapitalit të emtuar duhet të njihet në fitim ose humbje. Rishikimi nuk është relevant për aktivitetin e BQK-së.

q) Informacionet krahasuese

Informacionet krahasuese janë prezantuar në vazhdueshmëri duke përdorur politikat kontabël të BQK-së.

4. Administrimi i Rrezikut Financiar

a) Të përgjithshme

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku operacional
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipëme si dhe objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tyre si dhe për administrimin e kapitalit të BQK-së. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

Struktura e administrimit të rrezikut

Krijimi dhe mbikëqyrje i strukturës së administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit drejtues të BQK-së. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht tek Bordi drejtues mbi veprimet e lidhura me administrimin e rrezikut. Komiteti ekzekutiv dhe Komiteti i investimeve janë të angazhuar në zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika implementohen më pas nga njësitë organizative përkatëse.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e ndeshura nga BQK-ja, për të vendosur limite dhe kontrole të përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, BQK-ja synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet e ndeshura nga BQK-ja. Komiteti i auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga drejtorati i auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr auditime të kontroleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe rastësore, rezultatet e të cilave, përmes Inspektorit të Përgjithshëm raportohen te Komiteti i auditimit.

b) Rreziku kreditimit

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një klient ose një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale të veta, dhe shkaktohet kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozitat në banka të tjera.

Administrimi i rrezikut kreditimit

i. Investimet dhe ekspozimi në banka të tjera

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut kreditimit duke investuar vetëm në letra me vlerë të emetuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të të cilave janë të vlerësuara në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut kreditimit. Duke pasur vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditimit

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2009 dhe 31 dhjetor 2008 paraqitet nga vlera e mbartur e parasë në arkë, e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe e depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referojuni shënimeve 7, 8, 9 dhe 10.

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është me vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikat e administrimit të rrezikut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut kreditit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja nuk do të jetë në gjendje të përmbushë në kohën e duhur obligimet e lidhura me detyrimet financiare.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet si në kushte normale ashu edhe në ato të papavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar të dëmtojë reputacionin e saj.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi drejtues. BQK-ja administron rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jorezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare në valutat përkatëse. Politikat e administrimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të përkeqësuar BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe teste të rregullta kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë pjesë e rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet ditore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i kalohen anëtarëve të Komitetit të investimeve nga Drejtorati i menaxhimit të mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare

	Shënimi	Vlera e mbartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit
31 dhjetor 2009					
<i>Detyrimet jo-derivative</i>					
Detyrime ndaj bankave vendase	15	233,246	233,246	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	124,786	124,786	-	-
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	665,187	540,084	50,024	75,079
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	130,847	130,847	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,019	2,019	-	-
		1,156,085	1,030,982	50,024	75,079
31 dhjetor 2008					
<i>Detyrimet jo-derivative</i>					
Detyrime ndaj bankave vendase	15	137,158	137,158	-	-
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	908,212	640,642	109,714	157,855
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	24,400	22,554	1,846	-
Detyrime të tjera vendase	19	1,978	1,978	-	-
		1,071,748	802,332	111,560	157,855

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (në vazhdim)

Tabela e mësipërme tregon rrjedhjet e parasë të paskontuara të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të herëshme të maturitetit të tyre kontraktual. Hyrjet / (daljet) nominale bruto të pasqyruara në tabelën e mëparshme përfaqësojnë rrjedhjet e parasë sipas maturitetit të paskontuar të detyrimeve financiare dhe angazhimeve. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK mban aktive likuide që përshfijnë para dhe equivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe të Kosovës

Kriza ekonomike dhe financiare botërore ka rezultuar, përveç të tjerave, në një nivel më të ulët të financimit të tregut kapital, nivel më të ulët të likuiditetit në sektorin bankar, ulje të normave të interesit nga bankat qendrore për të ndihmuar huamarrësit, injektive të kapitalit nga qeveritë, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri në tregun e aksioneve. Zhvillimet e mëtejme të pafavorshme që rezultojnë nga kriza mund të kenë ndikim negativ në pozicionin financiar dhe të likuiditetit të BQK-së.

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e ekuiteteve, normat e këmbimit dhe normat kreditore (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtura nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon përfitimin në lidhje me rrezikun.

Administrimi i rrezikut të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në masën që aktivet dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmimohen në kohë apo shuma të ndryshme. Aktivet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçimit të indekseve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e administrimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistente me strategjitë e veprimit të BQK-së.

Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht administrohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e riçimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portofoleve jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofolet jo të tregtueshme (në vazhdim)

	Shëni mi	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj
31 Dhjetor 2009					
Paraja e gatshme	7	21,806	21,806	-	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,899	34,899	-	-
Bono thesari	9	529,652	149,940	379,712	-
Depozita me bankat e huaja	10	487,529	412,270	50,208	25,051
Aktive me FMN	11	124,482	124,482	-	-
Gjithsej		1,198,368	743,397	429,920	25,051
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(233,246)	(233,246)	-	-
Detyrime ndaj FMN	16	(124,786)	(124,786)	-	-
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	17	(665,187)	(590,108)	(50,028)	(25,051)
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(130,847)	(130,847)	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	(2,019)	(2,019)	-	-
Gjithsej		(1,156,085)	(1,081,006)	(50,028)	(25,051)
Ndryshimi		42,283	(337,610)	379,892	-
31 Dhjetor 2008					
Paraja e gatshme	7	39,674	39,674	-	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	10,403	10,403	-	-
Bono thesari	9	541,019	175,559	335,881	29,579
Depozita me bankat e huaja	10	519,276	505,242	1,829	12,205
Gjithsej		1,110,372	730,878	337,710	41,784
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(137,158)	(137,158)	-	-
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	17	(908,212)	(750,357)	(157,855)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(24,400)	(24,400)	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	(1,978)	(1,978)	-	-
Gjithsej		(1,071,748)	(913,893)	(157,855)	-
Ndryshimi		38,624	(183,015)	179,855	41,784

Rreziku i përgjithshëm i normave të interesit jo të tregtueshme administrohet nga Drejtorati i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të administruar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Administrimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të hendekut të normave të interesit, kompletohet duke vëzhguar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standardë dhe jo-standardë të normave të interesit. Skenarët standardë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh baze (pb). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2009	Skenarë deri në 1 vit		Skenarë mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Rënie	100 bp Rritje	100 bp Rënie
Efeksi i parashikuar në fitim (humbje)	124	(124)	-	-

2008	Skenarë deri në 1 vit		Skenarë mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Rënie	100 bp Rritje	100 bp Rënie
Efeksi i parashikuar në fitim (humbje)	95	(95)	-	-

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/ valutore të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes transaksioneve me valutë të huaj. BQK-ja siguron se ekspozimi neto mbahet në një nivel të pranueshëm duke shitur dhe blerë kur është e nevojshme, me kursin e menjëhershëm (spot) për të rregulluar ç'balancimet afatshkurtra. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është si vijon:

31 Dhjetor 2009	EUR	SDR	Totali
Aktive			
Paraja e gatshme	21,806	-	21,806
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	34,899	-	34,899
Bono thesari	529,652	-	529,652
Depozita me bankat e huaja	487,529	-	487,529
Aktive me FMN	-	124,482	124,482
Aktive të tjera	351	-	351
Gjithsej	1,074,237	124,482	1,198,719
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave vendase	233,246	-	233,246
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	49,099	75,687	124,786
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	665,187	-	665,187
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	130,847	-	130,847
Detyrime të tjera vendase	2,019	-	2,019
Gjithsej	1,080,398	75,687	1,156,085
Pozicioni neto për valuta të huaja	(6,161)	48,795	42,634

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/ valutore të portofoleve jo të tregtueshme (në vazhdim)

	EUR	SDR	Gjithsej
31 Dhjetor 2008			
Aktive			
Paraja e gatshme	39,674	-	39,674
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	10,403	-	10,403
Bono thesari	541,019	-	541,019
Depozita me bankat e huaja	519,276	-	519,276
Aktive të tjera	406	-	406
Gjithsej	1,110,778	-	1,110,778
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave vendase	137,158	-	137,158
Detyrime ndaj insitucioneve qeveritare	908,212	-	908,212
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	24,400	-	24,400
Detyrime të tjera vendase	1,978	-	1,978
Gjithsej	1,071,748	-	1,071,748
Pozicioni neto për valuta të huaja	39,030	-	39,030

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BKQ-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përpos rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objektivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me administrimin efektiv të kostove.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit menaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për manaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për administrimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve kontingjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

e) Rreziku operacional (në vazhdim)

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program kontrollësh periodike të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm. Gjetjet e kontrolleve të Auditimit të brendshëm diskutohen me menaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

f) Administrimi i Kapitalit

Kapitali rregullator

Ligji nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, aprovuar më datë 5 qershor 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përcakton kërkesat e kapitalit të BQK-së. Sipas këtij ligji, kapitali i autorizuar i BQK-së është 30 milionë Euro. Sipas dispozitave të ligjit, llogaritë e kapitalit dhe rezervës së përgjithshme duhet të jenë të paktën pesë për qind e shumës së agreguar të balancave kreditore në të gjithë llogaritë e mbajtura në librat e BQK-së siç paraqitet në pasqyrat financiare të BQK-së për çdo vit financiar. Kapitali mund të rritet me vendim të Bordit drejtues të BQK-së dhe aprovim nga Qeveria. Kapitali i BQK-së nuk është subjekt i asnjë lloji kufizimi.

Asnjë reduktim i kapitalit nuk mund të realizohet, përveç rasteve të shpalljes së legjislacionit të ri nga Kuvendi. Kurdo që:

- në bilancin mujor pro forma të BQK-së, vlera e aktiveve bie nën shumën e detyrimeve dhe të kapitalit të autorizuar të paprekur; ose
- fitimi neto i BQK-së për cilindo vit financiar është i pamjaftueshëm për rritjen e kapitalit dhe rezervës së përgjithshme të BQK-së në një nivel të barabartë me pesë për qind të shumës së agreguar të balancave kreditore të të gjithë llogarive në librat e BQK-së të paraqitura në pasqyrat financiare të BQK-së për atë vit financiar

Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet që brenda një muaji nga publikimi i bilancit të tillë financiar, të bëjë një kontribut kapitali në vlerën e deficitit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

f) Administrimi i Kapitalit (në vazhdim)

Kapitali rregullator (në vazhdim)

Kapitali rregullator i BQK-së më 31 dhjetor është si më poshtë:

	Shën imi	2009	2008
Kapitali dhe Rezerva e Përgjithshme			
Kapitali	20	30,000	30,000
Rezerva të përgjithshme	21	11,203	3,736
Fitime të mbajtura		3,720	7,467
Gjithsej		44,923	41,203
Llogaritë e paraqitura në librat e BQK-së më 31 dhjetor			
Detyrimet ndaj bankave vendase	15	233,246	137,158
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	124,786	-
Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare	17	665,187	908,212
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	130,847	24,400
Detyrime të tjera vendase	19	1,745	1,695
Gjithsej		1,155,811	1,071,465
Kapitali/ Llogaritë e mbajtura në librat e BQK-së më 31 dhjetor		3.89%	3.85%
Përqindja sipas ligjit		5%	5%

‘Detyrime të tjera vendase’ të paraqitura në tabelën e mësipërme nuk përfshijnë balancat si ‘e ardhura e shtyrë e granteve’ ‘kreditorë të ndryshëm dhe detyrime të shtyra’ si dhe ‘llogaritë transitore’.

Sipas Ligjit nr. 03/L-074, e ardhura neto apo humbja neto e BQK-së llogaritet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

E ardhura neto alokohet çdo vit në një llogari të rezervave të përgjithshme derisa shuma e përgjithshme e llogarive të kapitalit dhe rezervave të barazojë pesë për qind të shumës së agreguar të balancave kreditore të të gjitha llogarive në librat e BQK-së të paraqitura në pasqyrat financiare të BQK-së për atë vit financiar.

Çdo balancë e të ardhurave neto, duhet t’i transferohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave si e ardhur në buxhet. Nëse ka një humbje neto, kjo duhet t’i zbritet rezervave të përgjithshme apo kapitalit, sipas radhës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti i BQK-së diskuton me Bordin drejtues zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencë dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 4).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Fonde të lejuara për humbje nga kreditë

Aktivitet e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitet, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi).

Përbërësi specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave menaxhmenti i BQK-së gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion. Çdo aktiv me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivitet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur aktivitet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

6. Aktivet dhe detyrimet financiare

Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimi	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale e mbartur	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2009						
Paraja e gatshme	7	21,806	-	-	21,806	21,806
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,899	-	-	34,899	34,899
Bono thesari	9	-	529,652	-	529,652	529,275
Depozita me bankat e huaja	10	487,529	-	-	487,529	487,529
Aktive me FMN	11	124,482	-	-	124,482	124,482
		668,716	529,652	-	1,198,368	1,197,991
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	233,246	233,246	233,246
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	124,786	124,786	124,786
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	665,187	665,187	665,187
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	130,847	130,847	130,847
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	1,745	1,745	1,745
		-	-	1,155,811	1,155,811	1,155,811
31 dhjetor 2008						
Paraja e gatshme	7	39,674	-	-	39,674	39,674
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	10,403	-	-	10,403	10,403
Bono thesari	9	-	541,019	-	541,019	541,759
Depozita me bankat e huaja	10	519,276	-	-	519,276	519,276
		569,353	541,019	-	1,110,372	1,111,112
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	137,158	137,158	137,158
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	908,212	908,212	908,212
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	24,400	24,400	24,400
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	1,695	1,695	1,695
		-	-	1,071,465	1,071,465	1,071,465

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme shprehet e gjitha në Euro.

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2009	2008
Deutsche Bundesbank	34,369	9,436
Raiffeisen Zentralbank	145	161
Svenska Handelsbanken	-	130
Commerzbank	381	676
Banque de France	4	-
Gjithsej	34,899	10,403

Të gjitha llogaritë rrjedhëse kanë më 29 dhjetor një vlerësim kreditor prej dhe mbi A-1/P-1, sipas vlerësimit të bërë në vitin 2009 (vlerësimet Standard & Poors/Moody's),.

9. Bono thesari

Bonot e thesarit janë letra të borxhit qeveritar nga vendet e Bashkimit Europian. Ato kanë maturitetet deri në dymbëdhjetë muaj dhe janë për t'u mbajtur deri në maturim. Të gjitha bonot janë të përcaktuara në Euro dhe kanë norma efektive interesi nga 0.199% në 1.490% (2008: 1.83% në 4.37%).

Bonot e thesarit lëshohen nga qeveritë e vendeve të Bashkimit Europian si më poshtë:

	2009	2008
Gjermani	99,924	69,537
Francë	164,952	84,929
Hollandë	99,929	54,904
Itali	-	67,128
Portugali	-	43,836
Belgjikë	164,847	220,685
Gjithsej	529,652	541,019

BQK-ja investon në bono thesari me një vlerësim minimal kreditor AA (vlerësimi Standard & Poor's).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

9. Bono thesari (në vazhdim)

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2009 përfshijnë një vlerë prej zero Euro (2008: 267,893 mijë Euro) e cila përfaqëson bono thesari të blera prej BQK-së për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të firmosur me Ministrinë, BQK-ja do luajë rolin e një menaxheri të investimeve për fondet e Ministrisë. Në janar 2010 palët kanë bërë disa ndryshime në Memorandumin e Mirëkuptimit, neni III – *Alokimi i rrezikut*. Bazuar në këtë ndryshim për investimet që kryhen sipas Memorandunit të Mirëkuptimit, të cilat janë në përputhje me dispozitat për menaxhimin e rrezikut sipas Politikës së Investimeve të BQK-së, rreziqet përkatëse do të mbarten nga BQK dhe këto investime do të rregjistrohen në llogaritë e BQK-së. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, BQK gjithashtu merr përsipër përgjegjësinë për funksionimin e duhur të Drejtoratit të Menaxhimit të Mjeteve si njësi e BQK-së, si dhe blerjen në kohë, shlyerjen, pagesën dhe regjistrimin kontabël për të gjitha shumat e investuara të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

10. Depozita me bankat huaja

Depozitat me bankat huaja janë të përbëra si më poshtë:

	2009	2008
Depozita		
Raiffeisen Zentralbank	56,500	29,700
Svenska Handelsbanken	-	166,200
ING Bank	-	21,735
Deutsche Bundesbank	-	50,300
KBC	48,835	41,571
Rabobank	10,003	96,579
Danske Bank	87,097	46,813
Commerzbank	4,100	65,700
Banque de France	150,824	-
Banque Centrale du Luxembourg	130,057	-
	487,416	518,598
Interes i përlllogaritur për depozita		
Raiffeisen Zentralbank	-	153
Svenska Handelsbanken	-	92
ING Bank	-	2
Deutsche Bundesbank	-	95
KBC	52	5
Rabobank	-	319
Danske Bank	2	6
Commerzbank	-	6
Banque de France	31	-
Banque Centrale du Luxembourg	28	-
	113	678
Total	487,529	519,276

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

10. Depozita me bankat huaja (në vazhdim)

Depozitat e vendosura me bankat e huaja janë të përcaktuara në Euro dhe fitojnë interes me normë efektive që varion nga 0.05% në 2.05% (2008: 1.41% në 5.00%) si dhe kanë maturitet fillestar nga 1 në 186 ditë (2008: nga 1 në 355 ditë). Të gjitha depozitat kanë më 29 dhjetor një vlerësim kreditor prej A-1/P-1, sipas vlerësimit të bërë në vitin 2009 (Standard & Poors/Moody's).

11. Aktive me FMN

	2009	2008
Kuota në FMN	64,205	-
Titujt SDR	60,253	-
Interesi i përlllogaritur	24	-
Totali	124,482	-

Aktivet e listuara më sipër lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor 2009. Në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në FMN, BQK-ja vepron si depozitar dhe agjent fiskal. Kjo është përputhje me Ligjin Nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin No. 03-L-152 për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kuota në FMN përfaqëson një kuotë të njëherëshme të regjistrimit që është përcaktuar në kohën e pranimit. Titujt SDR përfaqësojnë aktive të aprovuara nga Bordi i guvernatorëve të FMN-së sipas alokimeve SDR ndaj vendeve anëtare të FMN-së më 28 gusht dhe 9 shtator 2009.

Kuota në FMN – pozicioni i pjesës rezervë dhe titujt SDR bartin interes vjetor prej 0.22% - 0.31%.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

12. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

	Investimet në objektet me qira	Pajisjet	Kompjuterë	Automjete	Gjithsej
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2008	1,279	1,271	445	119	3,114
Blerjet	-	188	169	-	357
Daljet	-	-	(1)	(12)	(13)
Gjendja më 31 dhjetor 2008	1,279	1,459	613	107	3,458
Gjendja më 1 janar 2009	1,279	1,459	613	107	3,458
Blerjet	-	84	166	222	472
Daljet	-	-	-	(43)	(43)
Gjendja më 31 dhjetor 2009	1,279	1,543	779	286	3,887
Zhvlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2008	64	572	303	67	1,006
Zhvlerësimi i periudhës	64	203	94	17	378
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	(1)	(12)	(13)
Gjendja më 31 dhjetor 2008	128	775	396	72	1,371
Gjendja më 1 janar 2009	128	775	396	72	1,371
Zhvlerësimi i periudhës	64	217	127	36	444
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	(43)	(43)
Gjendja më 31 dhjetor 2009	192	992	523	65	1,772
Vlera neto					
Gjendja më 1 janar 2008	1,215	699	142	52	2,108
Gjendja më 31 dhjetor 2008	1,151	684	217	35	2,087
Gjendja më 31 dhjetor 2009	1,087	551	256	221	2,115

Investimet ne objektet me qira lidhen me përmirësime të sigurisë së zyrave të BQK-së. Sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-074, BQK, për qëllimet e veta të veprimtarisë, shfrytëzon dhe administron pronën dhe pajisjet, duke përfshirë këtu pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, që ndodhen në rrugën Garibaldi nr 33, Prishtinë, Kosovë.

Nuk ka aktive të bllokuara si kolaterale më 31 dhjetor 2009 (2008: asnjë).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

13. Aktive afatgjata jo materiale

Aktivitet afatgjata jo materiale përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike në zhvillim	Programe kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2008	-	1,017	1,017
Blerjet	25	19	44
Gjendja më 31 dhjetor 2008	25	1,036	1,061
Gjendja më 1 janar 2009	25	1,036	1,061
Blerjet	-	149	149
Gjendja më 31 dhjetor 2009	25	1,185	1,210
Amortizimi			
Gjendja më 1 janar 2008	-	895	895
Amortizimi për periudhën	-	80	80
Gjendja më 31 dhjetor 2008		975	975
Gjendja më 1 janar 2009	-	975	975
Amortizimi për periudhën	-	61	61
Gjendja më 31 dhjetor 2009	-	1,036	1,036
Vlera neto			
Gjendja më 1 janar 2008	-	122	122
Gjendja më 31 dhjetor 2008	25	61	86
Gjendja më 31 dhjetor 2009	25	174	174

14. Aktive të tjera

Aktivitet e tjera përbëhen si më poshtë:

	2009	2008
Të ardhura të përlogaritura-akruale nga tarifrat	333	357
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	18	49
Gjithsej	351	406

Të ardhura të përlogaritura-akruale nga tarifrat paraqesin vlerësimet për tarifrat nga ripërtëritja e licencave dhe tarifa të tjera nga institucionet financiare vendore për tremujorin e fundit.

15. Detyrime ndaj bankave vendase

Sipas Rregullës XVII të BQK-së, bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë të detyruara të mbajnë rezerva të likuiditetit në shumën prej 10% të depozitave të kualifikuara të klientëve të tyre. Së paku gjysma e kësaj rezerve duhet të mbahet në llogari në BQK.

BQK paguan interes për mjetet e bankave komerciale që mbahen në llogari te ajo deri në shumën e përcaktuar me minimumin e rezervave të detyrueshme prej 10%. Norma e interesit më 31 dhjetor 2009 ishte 0.10% (më 31 dhjetor 2008 ishte 1.25%).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

15. Detyrime ndaj bankave vendase (në vazhdim)

	2009	2008
ProCredit Bank Kosovë	54,138	25,117
Raiffeisen Bank Kosovë	53,005	23,875
NLB Prishtinë	18,697	7,699
Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë	2,396	1,132
Banka Ekonomike e Prishtinës	5,913	2,191
Banka për Biznes	5,578	2,025
Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë	3,354	352
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A	9,226	1,381
Totali i rezervës së kërkuar të likuiditetit	152,307	63,772
Shtesa në llogaritë rrjedhëse		
ProCredit Bank Kosovë	42,777	34,242
Raiffeisen Bank Kosovë	2,568	12,438
NLB Prishtinë	1,838	7,023
Banka Ekonomike e Prishtinës	8,096	1,520
Banka për Biznes	16,868	10,164
Banka Kreditore e Prishtinës në Likuidim	59	226
Banka Kombëtare Tregtare Prishtina Branch	2,518	4,852
Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë	130	1,179
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A	6,085	1,742
Totali i shtesave në llogaritë rrjedhëse	80,939	73,386
Totali i llogarive rrjedhëse	233,246	137,158

16. Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	2009	2008
Llogaria e letrave me vlerë e FMN-së	49,099	-
Pozicioni rezervë	15,409	-
Alokimi SDR	60,253	-
Interesi i përlllogaritur	25	-
Gjithsej	124,786	-

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

16. Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN (në vazhdim)

Vlerat e mësipërme lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor 2009. Llogaria e letrave me vlerë e FMN-së paraqet një letër premtimi për t'u paguar nga Qeveria e Kosovës me kërkesë të FMN-së.

Pozicioni rezervë korrespondon me pjesën në mjete rezervë të pagesës së Kuotës në FMN (shiko Shënimin 11), e cila është paguar nga Qeveria e Kosovës.

Alokimi SDR përfaqëson alokimet SDR ndaj vendeve anëtare të FMN-së të aprovuara nga Bordi i guvernatorëve i FMN-së më 28 gusht dhe 9 shtator 2009.

Lidhur me alokimin SDR bartet interes vjetor prej 0.22% - 0.31%.

17. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare përfshijnë llogaritë rrjedhëse si më poshtë:

Llogaritë rrjedhëse

	2009	2008
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	88,245	403,610
Agjencia e Privatizimit të Kosovës	451,041	498,425
Institucione të përkohshme	797	6,177
Gjithsej llogaritë rrjedhëse	540,083	908,212

Depozita me afat

	2009	2008
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	125,104	-
Gjithsej depozitat me afat	125,104	-
Gjithsej	665,187	908,212

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 dhjetor 2009 është 0.10% (31 dhjetor 2008: 1.25%).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

18. Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike

Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike përfshijnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat si më poshtë:

	2009	2008
Llogaritë rrjedhëse		
Kompanitë e sigurimeve	7,664	15,394
Korporatat e shërbimeve publike	506	1,535
Fondet e pensioneve	122,676	67
Të tjera	2	2
	130,847	16,998
Depozita me afat		
Kompanitë e sigurimeve	-	7,402
	-	7,402
Gjithsej	130,847	24,400

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 dhjetor 2009 është 0.10% (31 dhjetor 2008: 1.25%) dhe për depozitat me afat nuk është e aplikueshme (31 dhjetor 2008: 3.95% dhe 4.45%).

19. Detyrime të tjera vendase

	2009	2008
Detyrime të tjera ndaj qeverisë	1,210	1,162
Të ardhura të shtyra nga grantet	9	-
Detyrime ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës	496	495
Kreditorë të ndryshëm dhe detyrime të rrjedhura	265	283
Detyrime të tjera vendase	39	38
Gjithsej	2,019	1,978

Shuma e detyrimeve të tjera qeveritare përbëhet nga qiratë dhe nga gjobat nga institucionet financiare, të cilat janë arkëtuar nga BQK-ja.

Detyrimet ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës ka të bëjë me sa vijon. Pas themelimit BQK ka trashëguar disa shuma të parasë së gatshme në valuta të ndryshme nga ish Banka Popullore e Kosovës. Gjithashtu, në këtë shumë është i përfshirë edhe interesi i akumuluar që prej 5 janarit 2004. Paraja e gatshme së pari është konvertuar në DEM 872 mijë më 22 dhjetor 2000. Balanca e llogarisë me 1 janar 2002 është konvertuar në EUR 446 mijë. Balanca e kësaj llogarie më 31 dhjetor 2009 dhe 2008 përfshin shumën në fjalë bashkë me interesin e akumuluar deri në ato data.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

19. Detyrime të tjera vendase (në vazhdim)

Lëvizjet në të hyrat nga grantet janë si vijon:

	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Banka Botërore	Gjithsej
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 janar 2008	-	49	49
Grante të reja gjatë vitit	36	-	36
Të hyrat nga grantet për vitin	(36)	(49)	(85)
Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2008	-	-	-
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 janar 2009	-	-	-
Grante të reja gjatë vitit	33	-	33
Të hyrat nga grantet për vitin	(24)	-	(24)
Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2009	9	-	9

20. Kapitali

Bazuar në Rregulloren e UNMIK nr. 1999/20, kapitali fillestar i BQK-së ishte 5 milionë DEM (2.556 milionë Euro) dhe u deponua nga Autoriteti Qendror Fiskal më 31 mars 2000. Më 8 qershor 2004, bazuar në vendimin e Zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara (Shtylla e IV e UNMIK-ut), kapitali u rrit nga 2.556 milionë Euro në 10 milionë Euro.

Sipas Rregullores së UNMIK nr. 2006/47, më 15 qershor 2007, pasi është miratuar nga Bordi drejtues, 10 milionë Euro janë transferuar nga rezervat në kapitalin e BQK-së. Sipas Ligjit nr 03/L-074, më 29 korrik 2008, Bordi drejtues miratoi transferimin edhe të një tjetër shume prej 10 milionë Euro, prej rezervës në kapitalin themelor të BQK-së.

BQK-ja i raporton direkt Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kapitali i BQK-së nuk është subjekt i ndonjë kufizimi.

21. Rezerva të përgjithshme

Rezervat e përgjithshme u krijuan në përputhje me Rregulloren e UNMIK nr. 1999/20. Më vonë, i janë referuar rregulloreve zëvendësuese të UNMIK-ut.

Sot, niveli i rezervave të përgjithshme rregullohet me Ligjin nr 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Fitimi neto i çdo viti financiar, në pajtueshmëri me ligjin dhe me miratimin e Bordit drejtues, transferohet në rezerva të përgjithshme ose në llogarinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

22. Të ardhura nga interesi, neto

Të ardhurat nga interesi, neto përbëhen si më poshtë:

	2009	2008
Të ardhura nga interesi		
Nga investimet me kushte fikse	2,414	33,290
Nga bonot e thesarit	4,010	9,467
Nga llogaritë rrjedhëse	205	84
	6,629	42,841
Shpenzimet e interesit		
Në llogaritë rrjedhëse të entiteteve jo-bankare	1,780	22,011
Në llogaritë rrjedhëse të kualifikuara të bankave	360	3,066
Në depozitat me kushte fikse	360	8,986
	2,500	34,063
